

**KOMISIONI  
PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR**

Krijuar nga Kryeministri Edi Rama  
Drejtuar nga Dr. Arjan Gjonça

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR  
PËR REFORMIMIN  
E ARSIMIT TË LARTË DHE  
KËRKIMIT SHKENCOR**

Tiranë, Korrik 2014



Termet e Referencës, Anëtarësia e Komisionit, Procedura  
e Punës dhe Përmbajtja e Raportit

**KOMISIONI  
PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR**

Krijuar nga Kryeministri Edi Rama

Drejtuar nga Dr. Arjan Gjonça

RAPORTI PËRFUNDIMTAR

**PËR REFORMIMIN E ARSIMIT TË LARTË  
DHE KËRKIMIT SHKENCOR**

Tiranë, Korrik 2014

## PJESA I – KOMISIONI DHE REFORMA E ARSIMIT TË LARTË

### KREU 1 Termat e referencës, anëtarësia e komisionit, procedura e punës dhe përmbajtja e raportit

- 1.1. Termat e referencës së komisionit
- 1.2. Anëtarësia e komisionit
- 1.3. Procedura e punës së komisionit
- 1.4. Metodologjia e punës së komisionit
- 1.5. Shpjegimi i termave kryesorë

### KREU 2 Qëllimet dhe parimet e reformës

- 2.1 Qëllimet e raportit
- 2.2 Parimet bazë të Reformës së Arsimit të Lartë
- 2.3 Fazat e vënies në jetë sipas përparësive

### KREU 3 Gjendja e arsimit të lartë, situata, problematika dhe zhvillimi i sistemit

- 3.1 Arritje
- 3.2 Gjendja aktuale
- 3.3 Ndryshimet ligjore në arsimin e lartë
- 3.4 Problematika e sistemit të sotëm dhe e zhvillimit të tij

## PJESA II – NDRYSHIMET E REKOMANDUARA

### KREU 4 Organizimi i arsimit të lartë

- 4.1 Organizimi aktual i arsimit të lartë në Shqipëri
- 4.2 Problematika
- 4.3 Sugjerimet

### KREU 5 Organizimi dhe funksionimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë

- 5.1 Organizimi aktual i IAL-ve
- 5.2 Organizimi strukturor dhe vendimmarrja në IAL
- 5.3 Problematika
- 5.4 Sugjerimet

### KREU 6 Financimi i arsimit të lartë

- 6.1. Problematika
- 6.2. Sugjerime – Llojet e financimit
- 6.3. Sugjerime – Burimet e financimit
- 6.4. Sugjerime – Financimi në fazën e parë (3-5 vjet)
- 6.5. Sugjerime – Financimi në fazën e dytë (afatgjatë)

## KREU 7 Mësimdhënia

- 7.1. Cilësia e mësimdhënies
- 7.2. Ciklet e studimit
- 7.3. Programet e studimit
- 7.4. Problematika
- 7.5. Sugjerimet – Rishikimi i programeve të studimit
- 7.6. Sugjerimet – Rishikimi i standardeve
- 7.7. Sugjerimet – Rishikimi i aksesit në arsimin e lartë
- 7.8. Sugjerimet – Rishikimi i ngarkesës mësimore
- 7.9. Sugjerimet – Rishikimi i mësuesisë
- 7.10. Sugjerimet – Struktura për organizimin e programeve të studimit në IAL

## KREU 8 Kërkimi shkencor

- 8.1. Niveli dhe cilësia e punës kërkimore -shkencore
- 8.2. Problematika
- 8.3. Sugjerimet – Organizimi
- 8.4. Sugjerimet – Funksionimi
- 8.5. Sugjerimet – Financimi

## KREU 9 IAL me status të veçantë, drejtime formimi me natyrë të veçantë dhe përparësi kombëtare

- 9.1. Përshkrimi
- 9.2. Sugjerimet për IAL-të me status të veçantë - Organizimi
- 9.3. Sugjerimet për IAL-të me status të veçantë – Pranimi i studentëve
- 9.4. Sugjerimet për IAL-të me status të veçantë - Mësimdhënia
- 9.5. Sugjerimet për IAL-të me status të veçantë – Kërkimi shkencor/Veprimtaritë profesionale
- 9.6. Sugjerimet për IAL-të me status të veçantë - Financimi
- 9.7. IAL-të dhe zhvillimi rajonal

## KREU 10 Vënia në jetë e reformës

- 10.1. Rëndësia e vënies në jetë
- 10.2. Fazat e vënies në jetë
  - 10.2.1. Faza e parë – Afatmesme
  - 10.2.2. Faza e dytë – Afatgjatë

## PJESA III – E ARDHMJJA E SISTEMIT TË ARSIMIT TË LARTË

### KREU 11 E ardhmja e sistemit të njëzuar dhe të standardizuar të arsimit të lartë në Shqipëri

- Aneksi I - IAL-të/Degët me status të veçantë
- Aneksi II - Matrica e autonomisë
- Aneksi III - Matrica e vërejtjeve dhe e sugjerimeve të pasqyruara në raport
- Aneksi IV - Matrica e ndryshimeve ligjore sipas raportit për Ligjin nr. 9741, të 2007-ës.

## KREU I TERMAT E REFERENCËS, ANËTARËSIA E KOMISIONIT, PROCEDURA E PUNËS

### 1.1. TERMAT E REFERENCËS SË KOMISIONIT

**1.1.1.** Ky komision, i quajtur Komisioni për Reformën në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, u krijua me urdhër të Kryeministrit, në janar 2014.

**1.1.2.** Ky komision u krijua si një instrument i pavarur, i drejtuar dhe i përbërë nga studiues dhe ekspertë të arsimit të lartë, me qëllim kryesor hartimin e reformës së arsimit të lartë në Shqipëri.

**1.1.3.** Komisioni iu ngarkua dr. Arjan Gjonçës për ta krijuar dhe për ta drejtuar në periudhën janar - korrik 2014. Gjatë kësaj periudhe, komisioni është ngarkuar që të arrijë synimet e kërkuara nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Arsimit dhe e Sportit.

**1.1.4.** Objektivi kryesor i komisionit është të prodhojë të ashtuquajturin “White Paper”, një Raport Shkencor për Politikën e Arsimit të Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Shqipëri, për të përballuar zhvillimin afatshkurtër dhe afatgjatë të vendit në këtë fushë.

#### 1.1.5. PËRGATITJA E RAPORTIT KA KALUAR NË TRI FAZA:

**1.1.5.1.** Faza e parë është hartimi i “Green Paper”-it (Raporti i Parë), për t’u diskutuar nga të gjitha grupet e interesit dhe faktorët e arsimit të lartë dhe të shkencës në Shqipëri. Me daljen e raportit të parë, kjo fazë cilësohet e mbyllur. Në këtë fazë që ka zgjatur nga janari deri në prill 2014, është punuar për të prodhuar Raportin e Parë.

**1.1.5.2.** Faza e dytë përfshin diskutimin e Raportit të Parë me grupet e interesit dhe faktorët e arsimit të lartë në Shqipëri. Kjo fazë filloi me publikimin e Raportit të Parë dhe zgjati një muaj, deri në 6 Qershor 2014.

**1.1.5.3.** Faza e tretë është faza e hartimit të “White Paper”-it (Raportit Përfundimtar) dhe dorëzimi i tij pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit dhe Këshillit të Ministrave.

**1.1.6.** Objektivi kryesor i këtij komisioni është të hartojë projekt-propozimin e Reformës së Arsimit të Lartë dhe të Kërkimit Shkencor në Shqipëri, e materializuar kjo në të ashtuquajturën “White Paper”.

**1.1.7.** Një objektiv tjetër i këtij komisioni është edhe Hartimi i Procedurave për të vënë në jetë Reformën e Arsimit të Lartë dhe të Kërkimit Shkencor në Shqipëri; Aktorët e përfshirë; Institucionet e Arsimit të Lartë; Procedurat që duhet të ndiqen; Afatet kohore të vënies në jetë, të gjitha këto do të botohen në një material të hollësishëm, që do t’u shpërndahet të gjitha IAL-ve në vend.

**1.1.8.** Objektivi përfundimtar i këtij komisioni është të paraqesë pranë qeverisë propozimet për ndryshimin e Ligjit të Arsimit të Lartë dhe të Kërkimit Shkencor në Shqipëri.

**1.1.9.** Në këtë proces, komisioni duhet të përfundojë brenda afateve të detajuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave, tri raporte: Raportin e Parë “Green Paper” (projektin për diskutim) dhe Raportin Përfundimtar “White Paper” për Reformën e Arsimit të Lartë dhe të Kërkimit Shkencor për hartimin e ligjit. Komisioni duhet të përgatisë edhe Raportin e detajuar për zbatimin e reformës. Ky raport do të përgatitet në një fazë të dytë pas hartimit dhe miratimit të ligjit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

### 1.2. ANËTARËSIA E KOMISIONIT

1. Prof. As.Dr. Arjan Gjonça (Kryetar i Komisionit)  
London School of Economics and Political Science, UK
2. Prof. Dr. Besnik Aliaj  
Universiteti POLIS
3. Prof. Dr. Myftar Barbullushi  
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
4. Prof. As. Dr. Dhurata Bozo  
Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë

<sup>1</sup>Dr. Arjan Gjonça është prof. i assoc. në Departamentin e Politikave Sociale, në London School of Economics and Political Science.

5. Prof. Dr. Adrian Civici  
Universiteti Europian i Tiranës
6. Prof. As.Dr. Ervin Demo  
Universiteti i Tiranës
7. Prof. Dr. Edmond Hajdëri  
Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"
8. Prof. As. Dr. Artan Hoxha  
Unifersiteti i Tiranës
9. Prof. Dr. Anila Paparisto  
Universiteti i Tiranës
10. Dr. Elida Rapti  
Universiteti i Arteve
11. Prof. Dr. Aleksandër Xhuvani  
Universiteti Politeknik i Tiranës

### 1.3. PROCEDURA E PUNËS SË KOMISIONIT

Faza përgatitore për krijimin e komisionit

Puna për krijimin dhe funksionimin e Komisionit për Reformën në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor ka filluar që në nëntor të 2013-ës, pas diskutimeve mes qeverisë, kryeministrit të Shqipërisë dhe kryetarit të këtij komisioni, të cilit iu ngarkua detyra e ngritjes së komisionit. Gjatë kësaj periudhe, pas diskutimeve me të gjithë aktorët politikë, u ra dakort që komisioni i krijuar të kryente një proces të plotë politikbërjeje me të gjitha fazat dhe elementet e politikbërjes moderne.

Gjatë kësaj faze, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe të Sportit, u mbledh e gjithë baza e nevojshme materiale dhe statistikore për fillimin e punës së komisionit. Po gjatë kësaj periudhe u përcaktuan edhe termat e referencës të punës së komisionit. Komisioni u plotësua me akademikë të spikatur në fushat përkatëse në janar të 2014-ës, kur mbajti dhe mbledhjen e tij të parë.

#### Faza e punës për hartimin e Raportit të Parë

Komisioni për Reformën në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor është mbledhur 58 herë, gjatë periudhës janar-korrik 2014. Në punën e tij në këta muaj, komisioni ka marrë me qindra komente dhe materiale ndihmëse nga shumë institucione të arsimit të lartë në Shqipëri dhe departamente të ndryshme. Midis të tjerave, komisioni ka marrë një

numër të madh mesazhesh elektronike nga individë dhe institucione të arsimit të lartë.

Gjatë periudhës së hartimit të këtij raporti, komisioni ka komunikuar me drejtoritë e Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit, me Institutin e Statistikës (INSTAT), si dhe me departamente të ndryshme të qeverisë. Komisioni ka shfletuar një dokumentacion të gjerë ku përfshihen të gjitha ndryshimet legjislative në vite, studimet e bëra nga qeveritë e mëparshme, si dhe studimet e realizuara nga institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në këtë fazë, komisioni ka krijuar një pasqyrë të plotë të gjendjes së arsimit të lartë në Shqipëri dhe problematikës së saj. Aspekt tjetër i punës së komisionit ka qenë prurja e përvojave të ndryshme ndërkombëtare. Komisioni, përveç përvojës individuale të anëtarëve të tij, ka studiuar dhe ka diskutuar sisteme të ndryshme të arsimit të lartë në rajon, në Evropë dhe në vende të tjera.

Komisioni e ndërtoi punën e tij mbi bazën e grupeve të punës, të drejtuara nga anëtarët e tij, sipas ekspertizës së tyre përkatëse, të cilët kanë kryer dhe analiza të ndryshme të sistemit të arsimit të lartë, sipas detyrave. Çdo grup pune u mbështet nga një numër ekspertësh. Pas punës në grupe, materiali i punuar u diskutua në komision dhe më pas u miratua nga anëtarët e tij.

#### Faza e diskutimit me grupet e interesit

Pas përgatitjes së Raportit të Parë, Komisioni vendosi që të ketë një periudhë dy deri tre-mujore për diskutimin e Raportit të Parë me grupet e interesit. Raporti i Parë i Reformës për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor iu shpërnda të gjithë pedagogëve të IAL-ve në vend nëpërmjet komunikimit elektronik. U krijua një faqe interneti në emër të komisionit, ku janë marrë me qindra mesazhe elektronike nga kolegë dhe studentë në mbarë vendin. Dokumentacioni dhe takimet janë bërë publike në të mirë të transparencës së punës së komisionit.

Gjatë kësaj faze, komisioni organizoi takime me drejtues të IAL-ve, me personelin akademik të departamenteve të ndryshme dhe me studentë në të gjitha IAL-të në vend. Komisioni organizoi edhe takime të tjera me grupe interesi, si: shoqatat e biznesit dhe autoritetet lokale. Midis të tjerave, komisioni ka organizuar takime me Komisionin për Shkencën, i drejtuar nga prof. Paskal Milo, si dhe me anëtarët e ish- KALSH-it dhe KRUSH-

in. Gjithashtu, është organizuar një numër i madh intervistash me individë të shquar të jetës akademike në vend. Komisioni ka kërkuar edhe një opinion të zërtare nga një numër akademikësh të shquar në vend.

Përpos këtyre takimeve, komisioni ka sqaruar opinionin publik nëpërmjet diskutimeve publike mediatike, si ato të medias së shkruar, ashtu edhe ato të medias elektronike dhe televizive. Gjatë kësaj periudhe, nga të gjithë anëtarët e komisionit janë mbajtur me dhjetëra debate televizive, janë shkruar artikuj, si dhe janë zhvilluar diskutime publike. Periudha e diskutimit ishte nga 20 prill deri 6 qershor 2014. Kontributet e mbledhura u përfshinë në diskutimet e komisionit. Propozimet për të cilat u ra dakord, u përfshinë në Raportin Përfundimtar (White Paper). Një pjesë e sistemuar e këtyre vërejtjeve dhe sugjerimeve jepen edhe në një nga matricat në Aneksin III të këtij raporti.

### **Puna e komisionit është organizuar si vijon:**

Fillimisht u ra dakord për parimet bazë që do të drejtonin punën e komisionit. Në vazhdimësi u diskutuan dhe u miratuan qëllimet e kësaj reforme. Si të gjitha reformat, edhe kjo u përqendrua te mënyra e organizimit të arsimit të lartë në Shqipëri dhe të IAL-ve të tij. Pasi u analizuan problemet, duke marrë parasysh përvojat e vendeve të tjera, u bënë sugjerimet e nevojshme. Më tej, puna e komisionit u përqendrua te format dhe madhësia e financimit të arsimit të lartë. Për këtë pjesë të raportit janë bërë analiza dhe krahasime të shumta. Vëmendje e veçantë iu kushtua dy aspekteve të rëndësishme të arsimit të lartë: procesit të mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore. Sugjerimet e menduara dhe të diskutuara janë përfshirë në krerët VII dhe VIII të këtij raporti. Gjatë procesit u diskutua edhe nëse është e domosdoshme që Shqipëria të ketë një sistem të njësuar dhe të standardizuar të arsimit të lartë. Ky objektivi u la si qëllim afatgjatë i reformimit të arsimit të lartë në Shqipëri dhe idetë kryesore për të janë hartuar në kreun XI.

Minutat e takimeve janë arkivuar dhe do të bëhen publike me daljen e raportit përfundimtar: "White Paper".

### **1.4. METODOLOGJIA E PUNËS SË KOMISIONIT**

Në punën për hartimin e këtij raporti, komisioni ka ndjekur metodologjinë e ndryshme, të njohura në hartimin e politikave sociale.

Së pari, komisioni u bazua në analizën arkivore të dokumentacionit ekzistues për arsimin e lartë në Shqipëri. Për këtë u përdorën të gjitha burimet e mundshme të informacionit, nga arkivat e Ministrisë së Arsimit dhe të qeverisë, bibliotekat e ndryshme në vend dhe jashtë tij, si edhe burime të tjera arkivore elektronike. Kjo analizë kishte si qëllim dy aspekte: vlerësimin e situatës së arsimit të lartë në vend dhe problemet me zbatimin e ligjit për arsimin e lartë.

Së dyti, komisioni ka kryer intervista dhe biseda në grupe me aktorë të arsimit të lartë në vend, që nga vendimmarrësit e deri te studentët. Analiza e këtyre bisedave dhe intervistave është pasqyruar në hartimin e draftit përfundimtar të reformës dhe në Raportin e Detajuar të Zbatimit të Reformës.

Së treti, komisioni ka kryer analiza statistikore të dhënave dytësore të arsimit të lartë në vend, të grumbulluara nga burime të ndryshme, si nga INSTAT-i, Banka Botërore, MAS-i dhe institucione vendëse dhe ndërkombëtare, që kanë prodhuar të dhëna për arsimin e lartë në Shqipëri. Këto analiza janë bërë kryesisht për të kuptuar gjendjen e arsimit të lartë në vend, si dhe për të kuptuar dhe për të projektuar gjendjen financiare të arsimit të lartë në Shqipëri.

Së katërti, komisioni ka bërë një analizë të literaturës bashkëkohore ndërkombëtare, kryesisht të asaj që lidhet me arsimin e lartë në Evropë dhe veçanërisht në Britaninë e Madhe. Kjo analizë e literaturës ka pasur për qëllim të identifikojë praktikën e mira, të cilat mund të zbatohen në Shqipëri, për t'i dhënë zgjidhje problematikës së evidentuar. Rezultatet e kësaj analize janë pasqyruar në të gjithë krerët e Raportit Përfundimtar, si dhe në Raportin e Detajuar për Zbatimin e Reformës.

Puna e komisionit u krye në grupe pune, të drejtuara nga anëtarët e komisionit, me ndihmën e ekipeve teknike që janë marrë me një pjesë të grumbullimit, të analizës dhe të hartimit të të dhënave të raporteve.

### **1.5. SHPJEGIMI I TERMAVE KRYESORË:**

**1.5.1** Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) janë persona juridikë, publikë ose privatë, që gëzojnë pavarësi ligjore nga shteti, të drejtat dhe detyrimet e të cilëve përcaktohen në aktin e krijimit të tyre, dhe ofrojnë arsimim, kualifikim profesional dhe kërkim shkencor, pas maturës shtetërore, organizimi dhe funksionimi i të cilave bëhet në pajtim me ligjin për arsimin e lartë dhe legjislativonin në fuqi;

**1.5.2** Hapësira Evropiane e Arsimit të Lartë (HEAL) ka kuptimin e përcaktuar në Deklaratën e ministrave evropianë të arsimit të lartë në Bolonjë (1999);

**1.5.3** ECTS (Sistemi Evropian i Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve) është mjete që ndihmon hartimin, përshkrimin dhe organizimin e programeve të studimit dhe dhënien e kualifikimeve të arsimit të lartë. Përdorimi i sistemit ECTS rrit transparencën e programeve të studimit dhe kualifikimeve universitare dhe lehtëson njohjen e studimeve dhe të diplomave.

**1.5.4** Akreditimi është procesi që vlerëson, njeh dhe garanton se një institucion i arsimit të lartë dhe programet e tij plotësojnë standardet e cilësisë të pranuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

**1.5.5** Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është një proces i vazhdueshëm i vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë së programeve të studimit dhe të performancës akademike të institucionit, që kryhet nga vetë IAL-të, me synim garantimin dhe përmirësimin e cilësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet evropiane dhe udhëzimet për sistemet e sigurimit të brendshëm të cilësisë në arsimin e lartë.

**1.5.6** Bursa përbëhet nga tarifa e shkollimit dhe mbulimi i kostove minimale vjetore të jetesës gjatë periudhës së studimit.

**1.5.7** Tarifa e Shkollimit është pagesa që studenti kryen për regjistrimin në një program studimi.

**1.5.8** Granti i Mësimdhënies është fondi që u jepet IAL-ve publike për procesin e mësimdhënies, mbi bazën e një formule që merr parasysh numrin e studentëve, numrin e pedagogëve, kuotat e akorduara të mësimdhënies, si dhe tregues të tjerë të logjistikës së një IAL-je.

**1.5.9** Granti Kërkimor është fondi që mund të jepet për individë ose për grupe të kërkimit, që bëjnë pjesë në një ose disa IAL.

**1.5.10** Letra e Prioriteteve është dokumenti që përcakton strukturën e shpenzimit të fondit publik për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, e hartuar nga Qeveria në përputhje me përparësitë e vendit.

**1.5.11** Sondazhi Kombëtar i Studentëve mundëson tërheqjen e perceptimeve dhe të mendimit të studentëve në vlerësimin e institucioneve ku studiojnë.

**1.5.12** Pedagog quhet çdo person, pavarësisht nga titulli/gradat që jep mësim në institucionet e arsimit të lartë.

**1.5.13** Bordi Administrativ është organi kolegjal përgjegjës për administrimin dhe zhvillimin strategjik të institucionit të arsimit të lartë, i cili krijohet dhe përtërihet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë dhe statutin e IAL-së.

**1.5.14** Asambleja e Personelit Akademik përbëhet nga i gjithë personeli akademik i punësuar me kohë të plotë i njësisë kryesore në IAL.

**1.5.15** Komisionet e Përhershme janë komisione që ngrihen pranë fakultetit apo universitetit me anëtarë nga Asambleja e Personelit Akademik, por, sipas natyrës specifike të komisionit, në përbërje mund të kenë edhe studentë apo anëtarë të personelit administrativ. Anëtarët vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Asambleja e Personelit Akademik. Komisionet, në një pjesë të madhe, kryejnë funksionet që dikur kryheshin nga Këshilli i Fakultetit.

**1.5.16** Komisionet “Ad-Hoc” janë komisione që krijohen për një qëllim të caktuar dhe konkretisht për përzgjedhjen e kandidatëve që aplikojnë për një post të caktuar brenda një IAL-je. Ato mbarojnë së funksionuari pas përzgjedhjes së kandidatit. Zakonisht përbëhen nga 5 anëtarë.

**1.5.17** Sistemi “Part-Time” nënkupton kryerjen e studimeve me kohë të pjesëshme, kohëzgjatja e të cilave nuk është më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes së studimeve me kohë të plotë, duke garantuar të njëjtën cilësi formimi.

**1.5.18** Autonomia Universitare lidhet me pavarësinë e IAL-ve në marrjen e vendimeve për drejtimin, organizimin dhe funksionimin e tyre, e shprehur në 4 forma kryesore: autonomi financiare, autonomi akademike, autonomi organizative, autonomi e personelit.



## KREU II QËLLIMET DHE PARIMET E REFORMËS

### 2.1. QËLLIMET E RAPORTIT

**2.1.1.** Arsimi i Lartë në Shqipëri, ashtu si në vendet e zhvilluara, konsiderohet një shërbim publik dhe e mirë publike, pavarësisht nga forma e pronësisë. Për rrjedhojë, një nga qëllimet kryesore të kësaj reforme është të ruajë parimet bazë të këtij arsimit, të tilla si:

- cilësi sipas standardeve të HEAL-së;
- mundësi të barabarta, pa diskriminim dhe mbështetje për shtresat në nevojë;
- konkurrencë e lirë mes institucioneve të arsimit të lartë, personelit akademik dhe studentëve;
- mundësi për të gjithë mbi bazën e meritës;
- mbështetje të përparësive strategjike të zhvillimit të vendit nëpërmjet kërkimit shkencor.

**2.1.2.** Qëllimi i çdo reforme është të përmirësojë treguesit e fushës ku ajo do të veprojë dhe, në mënyrë të veçantë, ata të matjes së procesit në “dalje”. Në rastin e Reformës së Arsimit të Lartë dhe të Kërkimit Shkencor, reformimi ka si qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë në dy drejtimet kryesore: mësimdhënie dhe punë kërkimore-shkencore.

**2.1.3.** Arsimi i lartë duhet t’u përgjigjet, t’u përshtatet dhe t’u paraprijë ndryshimeve në tregun e punës dhe në zhvillimin e vendit. Qëllimi i kësaj reforme është të krijojë premisat për një arsim të lartë cilësor, që t’u përgjigjet nevojave të tregut të punës, si dhe drejtimeve të zhvillimit strategjik të vendit.

**2.1.4.** Është shumë e rëndësishme të mendojmë për një sistem të njëjësuar dhe të standardizuar të arsimit të lartë në Shqipëri, ku të krijohen mundësitë për një arsim të lartë, të bashkëmatshëm dhe konkurrues me “tregjet” rajonale dhe ato evropiane. Krijimi i një sistemi të njëjësuar mbetet qëllimi afatgjatë i kësaj reforme.

**2.1.5.** Një nga qëllimet e reformës arsimore është të vendosë arsimin e lartë mbi baza financiare të qëndrueshme për t’u bërë ballë ndryshimeve dhe cikleve ekonomike. Në këtë prizëm, larmia e financimit dhe autonomia institucionale e IAL-ve

janë shumë të rëndësishme për maksimalizimin e të gjitha burimeve të financimit të arsimit të lartë që ekzistojnë në shoqëri.

**2.1.6.** Një tjetër qëllim i reformës është të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të brendshëm (brenda IAL-ve) dhe të jashtëm të kontrollit, në mënyrë që të sigurojë standarde evropiane për sistemin e arsimit të lartë.

**2.1.7.** Reforma synon krijimin e institucioneve të pavarura të arsimit të lartë që t’u bëjnë ballë kohës dhe ndryshimeve të ekonomisë dhe tregut.

**2.1.8.** Krijimi i mekanizmave për rritjen e përgjegjshmërisë ndaj shoqërisë dhe në shërbim të interesit publik.

### 2.2 PARIMET BAZË TË REFORMËS SË ARSIMIT TË LARTË

**2.2.1.** Parimet bazë iu nënshtruan një procesi të gjerë diskutimi me IAL-të publike dhe jopublike, me grupet e interesit dhe me aktorët shoqërorë. Ato u miratuan nga Komisioni i Reformës dhe janë mbajtur parasysh në të gjitha fazat e punës së këtij komisioni.

Reforma udhëhiqet nga pashmangshmëria e rritjes së aftësive vepruese të IAL-ve publike për një konkurrencë më të mirë brenda vetes dhe në treg, si dhe nga masa për t’u dhënë fund njëherë e mirë abuzimeve si në IAL-të publike ashtu dhe në ato jopublike.

**2.2.2.** Arsimi i lartë në Shqipëri është dhe duhet të jetë SHËRBBIM DHE E MIRË PUBLIKE dhe, si i tillë, kërkon në mënyrë të vazhdueshme financim dhe vëmendjen e institucioneve të shtetit.

**2.2.3.** Arsimi i lartë duhet të bazohet mbi parimin e MUNDËSIVE TË BARABARTA.

Shteti e ka detyrim ligjor të ndihmojë për shkollim studentët që plotësojnë kriteret, por e kanë të pamundur financimin e studimeve të tyre, në përputhje me kapacitetet, mundësitë e financimit publik dhe përparësitë e zhvillimit të vendit.

**2.2.4.** Arsimit i lartë në Shqipëri duhet të zhvillohet dhe të jetë konkurrues në rajon dhe më gjerë, prandaj në themel të tij duhet të qëndrojë KONKURRENCA midis institucioneve dhe individëve.

**2.2.5.** Një parim tjetër shumë i rëndësishëm për arsimin e lartë është RRITJA E AUTONOMISË së institucioneve të arsimit të lartë në të katër fushat e kësaj autonomie: në atë financiare; organizative; akademike dhe atë të personelit.

**2.2.6.** Sistemi i arsimit të lartë duhet të INTEGROJË MËSIMDHËNIEN dhe KËRKIMIN SHKENCOR. Është shumë e rëndësishme që në këto dy drejtime të mos matet dhe të mos vlerësohet vetëm puna e çdo individi në jetën akademike, por edhe që studentët të mësohen nga akademikë që kanë kontribuar në shkencë dhe në jetën shoqërore të vendit. Standardi i mësimdhënies nuk rritet vetëm nga mësimdhënës të mirë, por edhe nga studiues të mirë.

**2.2.7.** Të gjitha institucionet e arsimit të lartë publik janë TË BARABARTA PËR FINANCIM nga fondet publike (parimi i konkurrencës). Kjo realizohet mbi bazën e vlerësimeve të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore. Qeveria bën dallim vetëm për përparësitë strategjike të vendit.

**2.2.8.** Disa programe studimi dhe disa nga institucionet e arsimit të lartë duhet të gëzojnë status "TË VEÇANTË", për arsye se: janë përparësi kombëtare ose nuk mund të zbatohen të njëjtat rregulla të konkurrencës si në IAL-të e tjera.

**2.2.9.** Financimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë bëhet në bazë të PERFORMANCËS së tyre me anë të modeleve/formulave që marrin parasysh:

- Mësimdhënien
- Punën shkencore
- Zhvillimin

**2.2.10.** Qeveria/Ministria e Arsimit dhe e Sportit përcaktojnë çdo vit PËRPARËSITË për arsimin e lartë, pra, se sa fonde do të shkojnë dhe cilat fusha kanë përparësi (Letra e Prioriteteve, ku çdo qeveri pasqyron politikat e saj), por jo mënyrën se si do të përdoren këto fonde nga IAL -të.

**2.2.11.** Shpërndarja e fondeve publike për IAL-të bëhet përmes AGJENCISË KOMBËTARE TË FINANCIIMIT (AKF). Në shpërndarjen e fondeve publike, AKF-ja udhëhiqet nga parimet e:

- Barazisë
- Transparencës
- Performancës.

**2.2.12.** Për të synuar drejt një SISTEMI TË NJËSUAR DHE TË STANDARDIZUAR të arsimit të lartë në Shqipëri, IAL-të duhet të jenë:

- të pavarura në veprimtaritë e tyre mësimdhënëse dhe në kërkimin shkencor,
- të miradministruara, të përgjegjshme dhe transparente.

Financimi nga shteti nuk duhet të ndikojë kursesi mbi autonominë e këtyre institucioneve për vetëqeverisjen e tyre. Në vijim të kësaj, shteti duhet të rrisë, nëpërmjet auditimeve periodike, ndërgjegjësimin dhe përgjegjshmërinë e këtyre institucioneve për të qenë më efektive.

**2.2.13.** Në kushtet kur financimi i arsimit të lartë nga fondet publike është një çështje komplekse, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për vende të zhvilluara, është e domosdoshme futja e një PAGESE REFERENCË (TARIFË) për çdo student/vit akademik, ku qeveria përcakton KUFIRIN MINIMAL (DYSHEME) dhe MAKSIMAL (TAVAN) të tarifës, dhe ku çdo universitet vendos tarifën e tij brenda këtyre kufijve. Tarifa dysheme vendoset për të tria ciklet e studimit, ndërsa tarifa tavan vendoset vetëm për ciklin e parë të studimeve Bachelor.

- Shtresat në nevojë financohen nga shteti me fond të veçantë (bursa sociale), sipas kriterëve dhe kushteve përkatëse.
- Studentët e ekselencës financohen nga shteti, pavarësisht nga statusi i tyre ekonomik.
- Tarifa referencë për ciklin e parë të studimeve vendoset për programet e studimit, në përputhje me specifikat përkatëse (shkencat humane; shkencat e natyrës, inxhinierike dhe mjekësore; artet dhe sportet, e të tjera).
- Për ciklin e dytë dhe të tretë të studimit, qeveria nuk përcakton tarifë tavan, por vetëm tarifë dysheme për të shmangur rastet abuzive të vendosjes së tarifave që nuk mund të garantojnë cilësi.

**2.2.14.** Universitetet publike kanë STATUS JOFITIMPRURËS për procesin e mësimdhënies, por mund të zhvillojnë edhe veprimtari ekonomike fitimprurëse për aktivitetet e tjera jashtë mësimdhënies. Në këtë kuadër, ato mund të themelojnë organizma fitimprurës, me kusht që fitimet t'i përdorin në funksion të objektivave të zhvillimit të IAL-së.

## 2.3 FAZAT E VËNIES NË JETË SIPAS PËRPARËSIVE

**2.3.1.** Zbatimi i Reformës së Arsimit të Lartë ka një rëndësi po aq të madhe sa edhe hartimi i saj. Monitorimi i zbatimit të reformës merr një rëndësi të veçantë, sidomos në kushtet kur janë evidentuar moszbatime apo edhe shkelje të ligjit.

**2.3.2.** Vënia në jetë e Reformës së Arsimit të Lartë, e detajuar në kreun X, është menduar të kalojë në tri faza:

**2.3.2.1.** Faza e parë (0) është faza e hartimit të dokumentit strategjik të reformës dhe përgatitjes së ligjit. Kjo fazë ka filluar në janar 2014 dhe do të mbarojë në korrik 2014.

**2.3.2.2.** Faza e dytë (1). Zbatimi afatmesëm i reformës përfshin periudhën 2014-2017. Kjo fazë është menduar të zgjasë të paktën 3 vjet.

**2.3.2.3.** Faza e tretë (2), është faza e standardizimit të hapësirës shqiptare të arsimit të lartë, që synon njësimin dhe standardizimin e sistemit të arsimit të lartë, si dhe integrimin e sistemit të arsimit të lartë në hapësirën evropiane.

## KREU III GJENDJA E ARSIMIT TË LARTË SITUATA, PROBLEMATIKA DHE ZHVILLIMI I SISTEMIT

### 3.1. ARRITJE

Në vitin 1990, Shqipëria kishte vetëm 14 000 studentë dhe një numër të kufizuar kapacitetesh. Përzgjedhja e studentëve dhe e stafëve akademike bëhej mbi bazën e meritës dhe të asaj që njihesh si “biografia” e personit dhe e studentit. Kështu që, shoqëria shqiptare, në mënyrë masive, ndjeu dëshirën dhe kërkoi mundësinë dhe të drejtën e munguar ose të kufizuar për të ndjekur arsimin e lartë, gjë që shpjegon një ‘trysni’ të gjerë shoqërore për kryerjen e studimeve të larta pas ‘90-ës. Kjo çoi në zgjerimin e kapaciteteve pritëse të institucioneve shtetërore të arsimit të lartë, në hapjen e disa universiteteve të reja, në shndërrimin e instituteve të larta në universitete, në dhënien e mundësive të lehtësuara shtresave të ish-të përndjekurve politikë që dikur kishin qenë të privuar nga kjo e drejtë etj. Por kjo nuk u shoqërua paralelisht me rritjen e financimit për të siguruar cilësi, infrastrukturën e nevojshme, mbështetjen e kërkimit shkencor etj. Pas vitit 2000, trysnia masivizuese u bë shumë më e prekshme dhe solli lindjen e sistemit privat, krahas rritjes së përvitshme të pranimeve në sistemin publik. Ndryshimi thelbësor sasior ndodhi pas vitit 2005, kur kapacitetet pranuese u zgjeruan së tepërmi, duke e rritur numrin e studentëve nga 52 000 në atë vit dhe në rreth 165 000 në vitin 2013. Është për t’u theksuar se ky ndryshim sasior nuk u shoqërua gjithmonë me një ndryshim cilësor, pra, me një rritje të cilësisë së arsimit të lartë.

Megjithatë, në sfondin e këtyre rritjeve sasiore, sistemi ynë i arsimit të lartë përjetoi disa arritje cilësore të paimagjinueshme në kushte të tjera. Kualifikimet e personelit akademik në shkallë të gjerë, përmes studimeve të pjeshme ose të plota pranë universiteteve perëndimore, falë programeve ndërkombëtare ose kombëtare, por edhe falë përpjekjeve individuale të pedagogëve dhe specialistëve shqiptarë, sollën një cilësi tjetër në auditorët shqiptarë. Integrimi në sistemin universitar shqiptar publik dhe privat, sidomos pas vitit 2000, i studentëve shqiptarë që kishin përfunduar studimet në vendet perëndimore, krijoi një dinamikë të re në auditorët shqiptarë.

Hyrja e Shqipërisë në Procesin e Bolonjës, në vitin 2003, solli ristrukturimin dhe përditësimin e cikleve

dhe programeve të studimit dhe të përmbajtjes së kurseve të studimit. Ngritja e APAAL-së dhe procesi i licensimit dhe i akreditimit të programeve ekzistuese ose të reja sipas standardeve të Procesit të Bolonjës krijoi një praktikë vetëpërmirësuese në shkallë të gjerë të IAL-ve, duke përfshirë edhe sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Po ashtu, futja e maturës shtetërore pas vitit 2006, solli standardizimin e pranimeve në universitete.

Përfshirja e sektorit privat pas vitit 2000, solli një përvojë të mirë menaxhuese në sektorin e arsimit të lartë, që nuk kishte ekzistuar më parë në Shqipëri. Praktikant e reja menaxheriale që futi sektori privat, ushtruan një ndikim të rëndësishëm në procesin rregullator të arsimit të lartë, si dhe në përhapjen e këtyre praktikave edhe në IAL-të shtetërore. Sot, me gjithë problemet e mëdha, hapësira e arsimit të lartë në Shqipëri, ofron një mundësi për këdo, është e gjallë dhe dinamike dhe ka krijuar në shoqëri një ndikim të gjerë.

Rrugëtimi historik i këtyre ndryshimeve paraqitet në figurën 3.1.

### 3.2. GJENDJA AKTUALE

Në vitet e tranzicionit shoqëror dhe ekonomik, arsimit të lartë në Shqipëri ka pësuar një masivizim të jashtëzakonshëm për kapacitetet që ka dhe mundësitë që ofron. Ky masivizim, ndoshta i rëndësishëm si politikë arsimore<sup>2</sup>, nuk u bë i ndarë në faza, duke i studiuar ato. Ky faktor çoi deri diku edhe në rënien, ndonjëherë drastike, të cilësisë, në vend që të sillte përmirësimin e pritshëm të saj. Aktualisht, sistemi shqiptar i arsimit të lartë paraqet konfigurimin e mëposhtëm:

Gjithsej 59 institucione të arsimit të lartë, 15 publike dhe 44 jopublike. Ndër to, 19 gëzojnë statusin universitet (12 publike dhe 7 jopublike), 5 statusin kolegji (të gjithë jopublikë), 26 shkolla të larta (të gjitha jopublike), 8 akademi (2 publike dhe 6 jopublike), 1 institut (publik, qendër ndëruniversitare) dhe 17 filiale (5 të IAL-ve publike dhe 12 të IAL-ve jopublike).


Numri i programeve të ofruara është gjithsej 1560, nga të cilat 700 të ofruara nga IAL-të publike dhe

<sup>2</sup>Është e rëndësishme të përmendim këtu që Shqipëria sot ka numrin më të ulët të studentëve në arsimin e lartë në rajon, numër ky që duhet të rritet në të ardhmen e afërt, por pa prekur cilësinë dhe standardet.

pak më shumë nga IAL-të jopublike. Të ndara sipas nivelit të studimit, janë: rreth 650 programe Bachelor, rreth 250 Master Profesional, rreth 350 Master Shkencor dhe rreth 100 programe të ciklit të tretë, Doktoratë dhe specializime afatgjata.

**Figura 3.1.** Numri i IAL-ve për një milionë banorë në 2014-ën – Shqipëria dhe një grup vendesh evropiane

Burimi: Të dhënat për IAL-të janë grumbulluar nga Banka Botërore dhe UNESCO-ja, ndërsa ato të popullsisë nga UN "Population Prospects."



Por, nga pikëpamja e numrit të studentëve sipas standardeve ndërkombëtare /1000 banorë, edhe pse ka shumë IAL, sipas treguesve të UNESCO-s dhe të Bankës Botërore, Shqipëria mbetet ende pas vendeve të tjera për numrin e të rinjve të moshës përkatëse që hyjnë në arsimin e lartë dhe për numrin e plotë të studentëve në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë. (shtu tabelë për numrin e studentëve për 1000 banorë)

Siç tregojnë edhe të dhënat ndërkombëtare, Shqipëria ka një numër shumë të madh të IAL-ve për 1000 banorë (shiko figurën 3.1) në krahasim me vende të tjera të zhvilluara. Në Shqipëri ka rreth 20 IAL për një milion banorë, gati tetë herë më shumë se vende si Britania e Madhe, që e ka arsimin e lartë të ndërkombëtarizuar dhe ka një përqindje shumë të madhe të studentëve të huaj. Në kushtet

e një vendi me 2.8 milionë banorë dhe të një ekonomie që investon, deri më sot, jo më shumë se 40 milionë euro ose 0.5% (0.4-0.6%) të PBB-së së saj në arsimin e lartë, numri i IAL-ve në nivel kombëtar mbetet, krahasimisht, mjaft i lartë.

Gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, por në veçanti nga viti 2005 deri sot, është vënë re një rritje dhe zgjerim i shpejtë eksponencial i sistemit të arsimit të lartë në të gjithë përbërësit e tij, si në sistemin publik dhe në atë jopublik (shiko tabelën 3.1.). Kësaj rritjeje i shërbeu ndjeshëm edhe hapja e riaktivizimi i sistemit të studimeve me kohë të pjeshme (i pezulluar në vitin 2001), madje dhe në fushat e studimeve të zbatuara, teknike, mjekësore etj., që përfshihen në profesionet e rregulluara.

**Tabela 3.1.** Numri i studentëve sipas statusit të universitetit dhe kohës së studimit (Numër Absolut)

Institucionet e arsimit të lartë	2004-5	2005-6	2006-7	2007-8	2008-9	2009-10	2010-11	2011-12
IAL publik dhe jopublik	63257	74747	86863	90606	93139	122326	134877	160839
IAL publik	62274	73031	81102	81100	79795	98917	107523	126257
Me kohë të plotë	42202	50567	58916	62289	61343	79615	88439	99241
Me kohë të pjeshme	19616	21898	21820	18119	17772	18218	18441	26655
Edukim në distancë	456	566	366	692	680	1084	643	361
IAL privat	983	1716	5761	9506	13344	23409	27354	34582
Me kohë të plotë	983	1716	5761	9506	13344	22894	26784	34219
Me kohë të pjeshme	0	0	0	0	0	515	570	363
(në %)								
Institucionet e arsimit të lartë	2004-5	2005-6	2006-7	2007-8	2008-9	2009-10	2010-11	2011-12
IAL publik dhe jopublik	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
IAL publik	98.4	97.7	93.4	89.5	85.7	80.9	79.7	78.5
Me kohë të plotë	67.8	69.2	72.6	76.8	76.9	80.5	82.3	78.6
Me kohë të pjeshme	31.5	30.0	26.9	22.3	22.3	18.4	17.2	21.1
Edukim në distancë	0.7	0.8	0.5	0.9	0.9	1.1	0.6	0.3
IAL privat	1.6	2.3	6.6	10.5	14.3	19.1	20.3	21.5
Me kohë të plotë	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	97.8	97.9	99.0
Me kohë të pjeshme	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	2.2	2.1	1.0

<sup>3</sup>Të dhënat për IAL-të janë grumbulluar nga Banka Botërore dhe UNESCO-ja, ndërsa ato të popullsisë nga UN Population Prospects.

Nga të dhënat e tabelës 3.1 duket qartë se pjesa më e madhe e studentëve në vend studiojnë në universitetet publike (78.5%). Vlen të veçojmë dy të dhëna të rëndësishme. E para, numri i studentëve në IAL-të jopublike ka pësuar një rritje shumë të shpejtë, veçanërisht në 3-4 vitet e fundit. Më e rëndësishmja është se ka pasur një zgjerim të rëndësishëm të studimeve me kohë të pjesshme në universitetet publike, ku sot studiojnë rreth 21.5% e gjithë numrit të studentëve në IAL-të publike. Këto dy zgjerime të papërputhura me standardet e cilësisë të publikuara nga APAAL-i, kanë sjellë masivizim, deri diku të shoqëruar me rënien e cilësisë së formimit.

Zhvillimi shumë i shpejtë i sistemit nuk u shoqërua paralelisht me zgjerimin dhe ngritjen e mekanizmave të kontrollit dhe plotësimin e kuadrit normativ, duke ndikuar negativisht në cilësinë e sistemit. Në këto vite, programet e profilizuara dhe ato profesionale humbën peshën e tyre specifike në larinë e programeve të fushave, si: Infermiera, Ekonomia e Menaxhimi, Drejtësia, Shkencat Sociale etj. Po ashtu u ul niveli i kontrollit dhe rregullimit edhe mbi fushat e profesioneve të rregulluara, si: Mjekësia, Stomatologjia, Farmacia etj.

Shqipëria investon në arsimin e lartë disa herë më pak edhe se fqinjët e saj. Ky investim është edhe më i pabashkëmatshëm, kur krahasimet bëhen me vendet më të zhvilluara të Evropës. Buxheti i shtetit sot jep rreth 38 milionë euro për të mbështetur mbi 126 000 studentë në IAL-të publike. Kësaj shume mund t'i shtohen afërsisht edhe 20 milionë euro të tjera nga të ardhurat dytësore, të siguruara nga vetë IAL-të, gjë që e çon shifrën në rreth 460 euro për student në sektorin publik.

Këtij investimi mund t'i shtohen edhe rreth 35-45 milionë euro nga pagesat e studentëve në sistemin jopublik (rreth 34,500 studentë me një pagesë mesatare 1000-1250 euro).

Buxheti për arsimin nuk ka qenë kurrë më i lartë se 3% e PBB-së, duke u lëkundur në intervalet 2.2-2.8%/PBB. Ndërkohë, objektivi i domosdoshëm, i sugjeruar nga UNESCO-ja, UNDP-ja, Objektivat e Mijëvjeçarit, OECD-ja, BE-ja etj., është të paktën niveli 5% i PBB-së (çka nënkupton dyfishin e asaj që Shqipëria akordon aktualisht). Vendet e zhvilluara perëndimore, në kuadrin e OECD-së, e financojnë arsimin e tyre universitar në nivelet 5-8% të PBB-së, nga i cili 1-3% e PBB-së shkon drejtpërsëdrejti për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Aktualisht, Shqipëria shpenzon për arsimin e lartë 0.4 – 0.6% të PBB-së, si shumë e përbashkët e IAL-ve publike dhe atyre jopublike.

Shqipëria shpenzon sot rreth 500-600 euro/student, ndërkohë që asaj i duhen të paktën 4-5 herë më shumë për t'u barazuar me Rumaninë dhe Bullgarinë, ose 8-10 herë më shumë për t'u afruar me vende, si Portugalia e Spanja. Duke marrë parasysh kushtet dhe mundësitë tona aktuale, Shqipëria duhet të synojë të paktën shifrat 1500-2000 euro/student ose, e thënë ndryshe, një buxhet prej 250-350 milionë euro për 161 500 studentët e saj. Për buxhetin e shtetit, një shumë e tillë është sfida e madhe e viteve në vijim.

### 3.3. NDRYSHIMET LIGJORE NË ARSIMIN E LARTË

Qysh prej vitit 1990, arsimi i lartë ka kaluar në disa faza domethënëse ndryshimi që kanë pasur ndikim si pozitiv, ashtu edhe negativ në zhvillimin e tij.

Periudha: 1990-1994, karakterizohet nga vitet e hapjes së universiteteve, pas viteve të ndryshimit, ku shteti mbizotëronte dhe autonomia universitare nuk ishte në një stad domethënës. Statusin “universitet” e gëzonin fillimisht vetëm dy universitete, të cilat i pasoi edhe Universiteti Politeknik, pas ndarjes nga Universiteti i Tiranës.

Po ashtu, në Tiranë ekzistonin tri akademi (e Arteve, e Sporteve dhe ajo Ushtarake). Në tri rajone (në Shkodër, në Elbasan dhe në Gjirokastrë) funksiononin ende Institutet Pedagogjike që formonin mësues, ndërkohë që në Korçë funksiononte prej vitesh Instituti i Lartë Bujqësor. Gjatë kësaj periudhe, kërkimi shkencor realizohej pjesërisht në universitete apo në institutet e sistemit të Akademisë së Shkencave dhe në institute në varësi të instituteve qendrorë me vendndodhje në Tiranë dhe në rrethe të tjera.

Në vitet 1992-'93, me Vendim të Ministrisë së Arsimit, Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë Tiranës, përkatësisht të Elbasanit, të Shkodrës, të Gjirokastrës dhe të Korçës, u shndërruan në universitete. Më tej, në vitin 1994, u hap edhe Universiteti Teknologjik në Vlorë. Ndryshimi i statusit të këtyre institucioneve në universitete ishte një vendim politik, që nuk iu nënshtrua asnjë procesi të vërtetë vlerësimi, mbështetur mbi standarde akademike. Ky vendim ishte hapi i parë drejt fashitjes së identitetit dhe traditës së këtyre institucioneve dhe drejt zgjerimit që pasoi më tej në profilet e tyre programore.

Që nga ky çast, këto IAL zgjeruan ofertën e tyre akademike me programe në fusha të ndryshme akademike, pa ndonjë dallim të dukshëm. Kjo shënon dhe fazën e parë drejt largimit nga profilizimi, i domosdoshëm në kushtet e një

ekonomie tregu dhe të një shndërrimi rrënjësor të strukturës së ekonomisë në vend.

Vitet 1994-'99 u karakterizuan nga zgjerimi i mëtejshëm i sistemit dhe sidomos nga zgjerimi i profileve të universiteteve në rrafsh kombëtar, duke humbur kështu në mënyrë graduale identitetin dhe profilin e tyre specifik. Në këtë kohë, sistemi privat ende nuk kishte filluar të ushtronte trysni mbi sistemin publik, zbrazëti të cilën, si nga pikëpamja e shumëllojshmërisë akademike, ashtu dhe nga pranimet e studentëve, e plotësonte sistemi publik që rritej dhe zgjerohej, por duke mos ndjekur domosdoshmërisht zhvillimin ekonomik të vendit dhe kërkesën për profesione të caktuara.

Në vitin 1998, sistemi i arsimit të lartë në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës përbëhej nga njëmbëdhjetë (11) Institucione të Arsimit të Lartë, nga të cilat tetë (8) universitete (3 në Tiranë, 5 në rrethe të tjera) dhe 3 shkolla të larta në Tiranë (Akademia e Arteve, Shkolla e Lartë e Infermierisë dhe Instituti i Kulturës Fizike).

Ligji i ri për Arsimin e Lartë, në vitin 1999, erdhi si një domosdoshmëri për të lejuar dhe për të rregulluar zhvillimin e sistemit të arsimit të lartë dhe të gjithë përbërësve të tij, veçanërisht në kushtet e domosdoshmërisë të përditësimit të tij me elemente dhe mekanizma të rinj, që impononte Procesin e Bolonjës.

Përmes këtij ligji sanksionohet qartë, për herë të parë, autonomia universitare e shprehur kryesisht në skemën dhe në mënyrën e zgjedhjeve të autoriteteve dhe të organeve drejtuese, në vendimarrjen akademike, në qeverisjen dhe në menaxhimin financiar.

Në aspektin akademik futen konceptet e kurrikulave të organizuara, konceptet bazë të Procesit të Bolonjës, sistemi evropian i krediteve universitare (ECTS) në kurrikulat e studimeve universitare dhe bëhen përpjekje për të integruar kërkimin shkencor që zhvillohej në universitete, me atë të instituteve kërkimore, kryesisht të Akademisë së Shkencave. Kjo gjë synonte edhe zbutjen e ndërsjellë të dallimeve në kapacitetet mësimdhënëse dhe kërkimore midis personelit akademik të universiteteve dhe atij kërkimor të instituteve.

Në kuadrin e mekanizmave të Procesit të Bolonjës, në këtë ligj sanksionohet për herë të parë Sistemi i Sigurimit të Cilësisë.

Për herë të parë konceptohet dhe hapet rruga për futjen e arsimit të lartë privat në sistem dhe

përfshirja e arsimimit policor dhe ushtarak në sistemin e arsimit të lartë.

Vitet 1999-2007 shënuan vitet e riprojektimit të sistemit, të përshtatjes së institucioneve dhe kurrikulave sipas Procesit të Bolonjës, dhe hapjes së institucioneve të para jopublike të arsimit të lartë.

Në vitin 2001, Shqipëria nënshkruan Marrëveshjen e Lisbonës për njohjen e diplomave dhe fillimin e sistemit të njohjes së diplomave të huaja në vend sipas kriterëve dhe standardeve evropiane, të parashikuara në kuadrin e Procesit të Bolonjës. Po këtë vit, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës urdhëron zbatimin e sistemit ECTS (European Credits Transfer Sistem) në të gjitha kurrikulat e IAL-ve në Shqipëri.

Gjatë vitit 2003, Shqipëria hyn zyrtarisht në Procesin e Bolonjës. Ky vit shënon fillimin e organizuar të rishikimit dhe të përshtatjes së kurrikulave të arsimit të lartë sipas këtij sistemi, konceptimin e ECTS-së dhe zbatimin e tyre. Ky ishte dhe është një proces i vështirë, ende i papërfunduar, veçanërisht në aspektin e harmonizimit të kurrikulave, sipas cikleve dhe profileve universitare në rang kombëtar dhe evropian.

Gjatë kësaj periudhe, duke filluar që nga 2002-shi, u licencuan institucionet e para private. Deri në vitin 2005 funksiononin vetëm 5 IAL private, pothuajse të gjitha të specializuara (New York, Marubi, Luarasi, Zoja e Këshillit të Mirë dhe Fakulteti i Stomatologjisë i UFO-s).

Theksojmë se, në këto vite, nuk kishte një kuadër ligjor të plotë, gjithëmbulues dhe me standarde të plota për procesin e licencimit të institucioneve jopublike, megjithatë, procesi ishte deri diku i përgjegjshëm dhe i kujdesshëm e, për pasojë, gradual. Institucionet e hapura gjatë kësaj kohe drejtoheshin kryesisht nga figura akademike.

Ato u hapën në kuadrin e marrëveshjeve të mirëpeshuara për cilësi dhe në fusha profesionale e plotësuese, që mbuloreshin më me vështirësi nga institucionet shtetërore. Këto IAL jopublike u hapën si plotësuese të IAL-ve publike. Procesin ishte i mirëkontrolluar nga MASH-i, ndërkohë që Sistemi i Akreditimit ishte ende në hapat e parë të krijimit dhe të funksionimit.

Gjatë kësaj periudhe (2005-2006), APAAL-ja ndërmori procesin e parë të vlerësimit dhe të analizës së programeve dhe të institucioneve ekzistuese të arsimit të lartë, edhe pse ky proces

nuk vijoi me një vendimmarrje apo me ndikim në politikat pasuese të arsimit të lartë. Në këtë periudhë, rishikimi, riorganizimi i programeve ekzistuese dhe hapja e programeve të reja në përputhje me parimet e Procesit të Bolonjës, si dhe hapja e institucioneve jopublike u kryen në frymën e një bashkëpunimi të frytshëm ndërmjet MASH-it dhe Agjencisë së Akreditimit (sot APAAL), përfshirë këtu dhe njohjen e diplomave me komisione të përbashkëta.

Pranimet pa kritere (si në drejtim të kuotave, por edhe të standardit – notës mesatare të fituar gjatë studimeve parauniversitare) në institucionet jopublike dhe zgjerimi i mëtejshëm i sistemit me kohë të pjesshme ishin dy faktorët kryesorë që ulën ndjeshëm cilësinë e pranimeve në hyrje dhe të diplomimeve në dalje.

Gjatë viteve 2000-2005 kishte vetëm 5 IAL jopublike, ndërkohë që në 2005-2009-ën u hapën 34 institucione jopublike të reja dhe një institucion publik, ndërsa në periudhën 2009-2013, dy IAL publike dhe 10 jopublike.

Edhe nismat e hapjes së IAL-ve publike me një identitet të veçantë gjeografik, si p.sh., UAMD-Durrës, apo me programe studimi të posaçme dhe krijuese për sistemin shqiptar (si p.sh. FASTIP-i në Universitetin e Durrësit), me kalimin e kohës e humbën profilizimin, duke arritur që ato vetë, të krijuara si institucione me drejtim të rëndësishëm të profilizuar dhe rajonal, të hapnin filiale në rrethe të tjera.

Sot, arsimit i lartë profesional është rrudhur në mënyrë të ndjeshme, edhe pse në Kuadrin Shqiptar të Kualifikimeve ai figuron dhe referohet si nivel. Tani janë 2 institucione jopublike që ofrojnë arsimin profesional me 4 programe studimi, ndërsa në arsimin publik janë 3 IAL me 10 programe gjithsej.

Sistemi i Sigurimit të Cilësisë, i konceptuar në ligj që në vitin 1999, me krijimin e Agjencisë së Akreditimit në vitin 2001, mori zhvillim veçanërisht pas vitit 2003, me ngritjen e Këshillit të Akreditimit. Hartimi i procedurave dhe kritereve të vlerësimit dhe formësimi i këtij sistemi ishte relativisht i ngadalshëm, në krahasim me rritjen dhe zgjerimin e shpejtë të IAL-ve dhe të programeve të studimit.

Proceset e vlerësimit dhe të akreditimit filluan të merrnin rëndësi kur një pjesë e mirë e institucioneve dhe e programeve në sistemin jopublik ishin licencuar. Ndërkohë, nën kompetencën dhe kontrollin e MASH-it, sistemi publik, nën mbrojtjen

nga shteti, nuk e merrte parasysh rëndësinë e tij. Deri në vitin 2009, sistemi u zgjerua nën përgjegjësinë e plotë të MASH-it, ndërkohë trysnia mbi akreditimin u zhvendos mbi Agjencinë dhe Këshillin e Akreditimit pas ngritjes së tyre. Kjo gjë bëri që, nëse deri në vitin 2009-2010 të krijoheshin një numër i madh i IAL-ve jopublike (11), në vitet 2010-2013 të vijohej me zgjerimin dhe shtrirjen e IAL-ve jopublike ekzistuese dhe të akreditimit të tyre, me dhe pa respektim të rreptë të kritereve e standardeve.

Me gjithë përpjekjet për të vlerësuar dhe për të garantuar cilësinë, edhe përmes angazhimit të ekspertëve dhe të anëtarëve të huaj në Këshillin e Akreditimit, nuk u arrit të pengohej akreditimi jashtë standardeve. Kjo gjë solli gjendjen e sotme, ku cilësia ka pësuar rënie, si pasojë e masivizimit nga njëra anë dhe abuzimit me respektimin e standardeve nga ana tjetër. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës në këtë periudhë, si institucioni përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe ndërmarrjen e politikave të nevojshme në funksion të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, ka luajtur vetëm një rol vëzhgues ndaj detyrimeve të parashikuara në ligjin e arsimit të lartë.

### **3.4. PROBLEMATIKA E SISTEMIT TË SOTËM DHE E ZHVILLIMIT TË TIJ**

Në këtë seksion paraqiten disa nga problemet e përgjithshme të gjetura në sistem. Detajimi i tyre bëhet në çdo kre sipas organizimit të këtij raporti.

**3.4.1** Në strukturë nuk ka pasur dhe nuk ka ende një strategji të qartë të zhvillimit dhe as një model të arsimit tonë të lartë. Në të kundërt, sistemi karakterizohet nga një numër i madh rregullimesh ligjore dhe nënligjore.

#### **3.4.2. ECURIA E ARSIMIT TË LARTË KARAKTERIZOHET NGA:**

- Një zhvillim i deformuar dhe i paharmonizuar mirë mes sistemit publik dhe atij jopublik të arsimit të lartë, i shprehur në numrin shumë të madh të IAL-ve, në shpërndarjen e programeve të studimit dhe në atë të studentëve.
- Orientimi dhe pranimi i studentëve në IAL, nëpërmjet sistemit aktual të Maturës Shtetërore, ka nxjerrë në pah edhe mospërputhje mes preferencës dhe fushës së studimeve të larta që kryhen nga studenti.



**3.4.3.** Në IAL-të vihen re dallime të mëdha në numër studentësh apo programesh të ofruara midis vetë institucioneve. Sot ka institucione dhe programe që kanë numër minimal studentësh. Kjo sjell pamundësi financiare për mbulimin e kostove dhe sigurimin e standardeve minimale të mësimdhënies, pa folur për kërkim shkencor apo veprimtari të tjera.

**3.4.4.** Sistemi jopublik i arsimit të lartë paraqitet i fragmentuar, me IAL jopublike të copëzuara pa një profil të vetin, me shumë programe studimi në të gjitha ciklet, por që kanë një numër të vogël studentësh. Sot, 44 IAL jopublike mbajnë afërsisht 20% të numrit të përgjithshëm të studentëve në rang vendi. Në shumicën e këtyre IAL-ve, cilësia është e ulët dhe kontrolli i saj nga organet kompetente nuk është as i plotë dhe as i thellë.

**3.4.5.** Edhe akordimi i statusit të universitetit nuk është bërë gjithmonë në përputhje me plotësimin e standardeve akademike dhe institucionale për këtë status. Kjo vihet re në të dy sektorët, privat dhe publik. Ndërkohë, institucionet e arsimit të lartë me statusin akademi, shkola të larta e kolegje janë të kufizuara në numër.

**3.4.6.** Ka filiale të hapura pa kriter dhe jashtë logjikës ekonomike e institucionale që krijojnë konkurrencë të padobishme, madje brenda vetë IAL-ve publike.

**3.4.7.** Cilësia e IAL-ve dhe e programeve të studimit në sistemin publik nuk i është nënshtruar ende procesit të vlerësimit të jashtëm dhe të akreditimit, duke ndikuar edhe në sistemin e IAL-ve jopublike.

**3.4.8.** Në sistemin e arsimit të lartë, sot ka një shumëllojshmëri të madhe të ofertës akademike, pa kriter dhe politika strategjike planifikimi, si dhe e papërligjur për madhësinë e sektorit, popullatën dhe kërkesën e tregut shqiptar.

**3.4.9.** Në llojin e ofertës akademike, mbizotëron dukshëm arsimimi i lartë universitar mbi atë profesional. Arsimimi profesional jouniversitar zë një peshë thuajse të papërfillshme në shkallë vendi, si përsa i përket numrit e llojeve të programeve të studimit të ofruara (as 1% të programeve gjithsej), ashtu dhe të numrit të studentëve në këtë sistem (rreth 0.1%).

**3.4.10.** Pranimi në IAL karakterizohet nga politika dhe skema të kontrolluara nga MAS-i në sistemin publik (të paktën për programet e preferuara), por thuajse pa kriter në sektorin jopublik, madje edhe

për fushat e veçanta të rregulluara (BE) dhe sipas niveleve e cikleve të studimit (Master Profesional, Master i Shkencave dhe Doktoratë).

**3.4.11.** Kurrikulat e studimeve të larta janë të pabarmonizuara në nivel kombëtar për të njëjtat programe sipas emërimit, llojit dhe niveleve apo titujve të studimit. Kjo është e vërtetë edhe për programet që testohen pas diplomimit me Provimin e Shtetit.

**3.4.12.** Sistemi me kohë të pjeshme ("part-time") është zgjeruar pa kriter të mirëpërcaktuara, duke zënë një peshë të rëndësishme në sistemin e arsimit (nga dytësor që ka qenë në të kaluarën dhe siç vazhdon të jetë në vendet e zhvilluara) dhe në mospërputhje me qëllimin për të cilin ekziston, si mundësi alternative për ata që janë në marrëdhënie pune.

**3.4.13.** Zgjerimi i paarsyeshëm i sistemit të studimeve me kohë të pjeshme si në sistemin publik ashtu edhe në atë privat të arsimit të lartë, ka prekur edhe programet specifike të studimit, me përbërës të rëndësishëm teknik, kërkimor, praktik, profesional, madje dhe ato të profesioneve të rregulluara.

**3.4.14.** Kërkimi shkencor, si përbërës kyç i rëndësishëm për institucionet e arsimit të lartë me statusin universitet, është në nivel më të ulët, krahasuar me universitetet evropiane. Kjo problematikë është më e theksuar në universitetet jashtë Tiranës dhe në shumicën e IAL-ve jopublike. Për pasojë, sot IAL-të shqiptare kanë një fizionomi kryesisht mësimdhënëse dhe pak kërkimore.


**3.4.15.** Sistemi i Brendshëm dhe i Jashtëm i Sigurimit të Cilësisë është karakterizuar nga probleme dhe vështirësi që lidhen si me shkallën e ulët të njohjes dhe interesimit të vetë IAL-ve për cilësinë e brendshme, ashtu edhe me mungesën e kontrollit të jashtëm. Ky proces nuk u ndihmua as nga ndryshimet e vazhdueshme ligjore, kriteret e standardet (shpeshherë të paqarta e vështirësisht të lexueshme), të cilat kërkonin adoptime të shpeshta të IAL-ve dhe vetë institucioneve të sigurimit të cilësisë jashtë tyre. Këtyre faktorëve u shtohet dhe mungesa e ndarjes së qartë të fushës së veprimtarisë dhe kompetencave për sigurimin e cilësisë midis vetë IAL-ve, institucioneve të vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit dhe atyre vendimmarrëse, si MAS-i dhe KM-ja.

**3.4.16.** Si përfundim, në gjendjen e tanishme të sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri, procesi i masivizimit është bërë një fakt i pakthyeshëm, por që deri tani mbart edhe efekte negative. Referuar standardeve sasiore ndërkombëtare, Shqipëria është ende larg treguesve të numrit të studentëve për grupmoshën dhe numrin e studentëve për 1000 banorë. Prandaj qëllimi i kësaj reforme është ndërtimi i një sistemi cilësor, duke u dhënë mundësinë për të ndjekur studimet e larta një numri maksimal studentësh, por duke u garantuar njëkohësisht atyre edhe standardin e duhur. Në këtë kuptim nevojitet të rikonceptohet roli i strukturave shtetërore, duke e lejuar sistemin e arsimit të lartë të funksionojë lirshëm dhe duke shkuar drejt përqendrimit të tij në 4 funksione kryesore:

- **MBËSHTETJE E PËRPARËSIVE**, ndërtimi i politikave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në përputhje me përparësitë e zhvillimit të vendit.
- **FINANCUESI KRYESOR**, shteti duhet të vazhdojë të jetë financuesi kryesor i arsimit publik të lartë në vend.
- **MBËSHTETJE E SHTRËSAVE NË NEVOJË**, për të garantuar mundësinë e ndjekjes së studimeve të larta sipas meritës dhe jo sipas gjendjes financiare.
- **GARANTIMI I STANDARDIT TË CILËSISË** në çdo element të sistemit, pra roli rregullator i shtetit në arsimin e lartë.

Figura 3.1. Projekzioni i Reformave të Arsimit të Lartë në Shqipëri

### PROJEKSIONI I REFORMAVE TË AL NË SHQIPËRI



## KREU 4 ORGANIZIMI I ARSIMIT TË LARTË

### 4.1 ORGANIZIMI AKTUAL I ARSIMIT TË LARTË NË SHQIPËRI

Arsimi i lartë në Shqipëri ofrohet dhe zhvillohet në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) Publike dhe Jopublike, në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë dhe me Ligjin për Arsimin e Lartë. Në grupimin e parë bëjnë pjesë IAL-të me financim të drejtpërdrejtë nga fondet publike, ndërsa në grupimin e dytë bëjnë pjesë dy tipe të IAL-ve: jofitimprurëse dhe fitimprurëse, të cilat nuk përfitojnë financim nga fondet publike. Të gjitha IAL-të e mësipërme menaxhohen dhe funksionojnë mbi bazën e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe atij për ndërmarrjet jopublike e fondacionet në Shqipëri. Mënyra se si organizohen IAL-të në Shqipëri detajohet në kreun 5.

Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS) është institucioni përgjegjës, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, për realizimin e programit politik qeverisës në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor, si dhe për sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standardeve nga institucionet publike dhe jopublike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Ajo kontrollon zbatimin e ligjshmërisë dhe përdorimin e fondeve publike në institucionet publike të arsimit të lartë, si dhe zbatimin e ligjshmërisë në institucionet jopublike të arsimit të lartë.

Në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, institucionet qendrore publike që merren me mbarëvajtjen dhe mbikëqyrjen e arsimit të lartë, janë:

- Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, njësi përbërëse e MAS-it;
- Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), agjenci varësie e MAS-it, dhe Këshilli i Akreditimit (KA), organ kolegjal që kryen veprimtarinë e vet pranë APAAL-së;
  - Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), agjenci varësie e MAS-it;
- Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës (KALSH), organ këshillimor i MAS-it dhe i Këshillit të Ministrave për politikën e zhvillimit të arsimit të lartë dhe të shkencës;
- Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë (KVTA), organ kolegjal i kryesuar nga Ministri i Arsimit dhe i Sportit.

Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës pranë MAS-it, është njësi bazë që harton strategjitë dhe politikën për zhvillimin e arsimit të lartë me objektiva specifike, të realizueshëm, të matshëm dhe strategjikë, për përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulave dhe të cilësisë së tyre, në bazë të legjislacionit dhe të standardeve në fuqi, si dhe në përputhje me Procesin e Bolonjës.

Drejtoria harton planet e monitorimit për zbatimin e kurrikulave dhe për vlerësimin e cilësisë së tyre, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Vlerëson veprimtarinë kërkimore-shkencore në vend, zhvillimin dhe përsosjen e vazhdueshme të legjislacionit për shkencën drejt modeleve bashkëkohore të organizimit, bashkëpunimit nëpërmjet zbatimit në projekte kombëtare e ndërkombëtare, me synim përfundimtar integrimin në Hapësirën e Kërkimit Shkencor Evropian.

Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) është agjencia e ngarkuar për vlerësimin e cilësisë dhe akreditimin institucional dhe të programeve të studimit të reja dhe ekzistuese, si dhe përmes mekanizmave të tjerë, me sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, të programeve të studimit të të gjitha cikleve dhe llojeve dhe të Institucioneve të Arsimit të Lartë në vend. Pranë APAAL-së funksionon Këshilli i Akreditimit, i cili, në bazë të vlerësimit dhe të rezultateve të tij, i sugjeron Ministrisë vendimin e hapjes së programeve të reja ose akreditimin e programeve apo institucioneve ekzistuese. Vendimi merret nën përgjegjësinë e Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit. Në procesin e vlerësimit angazhohen edhe ekspertë të jashtëm dhe të huaj sipas fushave akademike. APAAL-ja ka si mision dhe objektiv kryesor vlerësimin e cilësisë në arsimin e lartë, në bashkëpunim me Ministrinë dhe krijimin e kulturës së brendshme të cilësisë, në bashkëpunim edhe me vetë Institucionet e Arsimit të Lartë në vend.

Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) është një institucion i posaçëm që ka një funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit dhe organizimit të Provimeve të Maturës dhe të Shtetit. Ka në varësi disa drejtori.

Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës (KALSH) është organ këshillimor i Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit dhe i Këshillit të Ministrave për politikat e zhvillimit në arsimin e lartë dhe në shkencë. Ky organ ka një varësi të dyfishtë sipas legjislacionit ekzistues.

KALSH-i ka për mision të japë mendime e propozime për:

- strategjitë e zhvillimit të arsimit të lartë si në lëmin e mësimdhënies, ashtu edhe në atë të veprimtarisë kërkimore-shkencore;
- drejtimet kryesore të zhvillimit të arsimit të lartë;
- projektbuxhetin e parashikuar për arsimin e lartë dhe shkencën dhe metodologjinë e shpërndarjes së tij;
- standardet për vlerësimin dhe akreditimin e IAL-ve dhe të programeve të studimeve;
- kriteret për dhënien e titujve dhe gradave shkencore, së bashku me Komisionin e Vlerësimit të Titujve Akademikë;
- çështje të tjera të veçanta, të kërkuara nga Ministri i Arsimit dhe i Sportit.

Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë (KVTA). Ky organ kolegjal ka këto detyra kryesore:

- të vlerësojë propozimet e IAL-ve dhe të marrë vendim për dhënien e titullit akademik "Profesor";
- të kryejë njohjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë të gradave shkencore ose titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë, sipas procedurave, të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe të Sportit;
- të përcaktojë kriteret e dhënies së titujve akademikë dhe të gradave shkencore në bashkëpunim me KALSH-in; t'u rekomandojë institucioneve të arsimit të lartë organizimin e studimeve të doktoratës dhe promovimin për titujt akademikë;
- të vlerësojë, me kërkesë të Ministrit të Arsimit dhe të Sportit, zbatimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor nga institucionet e arsimit të lartë dhe, kur vëren shkelje të kuadrit ligjor dhe nënligjor, propozon masat përkatëse;
- të dërgojë përfaqësuesit e vet për të mbikëqyrur procedurat për mbrojtjen e doktoratave, si dhe për shqyrtimin e titujve akademikë, të cilat zhvillohen nga institucionet e arsimit të lartë në mbledhjet (seancat) e hapura.

Konferenca e Rektorëve është organ kolegjal i pavarur i autoriteteve drejtuese të institucioneve

publike dhe jopublike të arsimit të lartë. Kryen veprimtari të koordinimit dhe zhvillimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor dhe shpreh opinionet për probleme të zhvillimit të institucioneve të arsimit të lartë, si dhe për rastet të tjera të parashikuara në ligj.

## 4.2 PROBLEMATIKA

4.2.1. Nga një analizë e thellë dhe e hollësishme e funksionimit, e drejtimit, e organizimit dhe e akreditimit të IAL-ve, si dhe nga vlerësimet e bëra në vite nga institucionet vendëse dhe të huaja (MAS, BB, UNICEF, UNDP) rezulton se sistemi i arsimit të lartë në Shqipëri paraqet një sërë problematikash komplekse, si edhe nuk u përgjigjet plotësisht nevojave aktuale dhe të ardhshme të zhvillimit të vendit, si për sa u përket aspekteve të mësimdhënies, ashtu edhe atyre të punës kërkimore-shkencore.

4.2.2. Vlerësimet e sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri tregojnë se ai mbart problematika në disa aspekte, në nivele të ndryshme. Këto problematika në disa raste nuk e kanë lejuar sistemin të formojë profesionistë që të mund t'u përgjigjen kërkesave të kohës dhe tregut të punës.

4.2.3. Ndër problemet më të rëndësishme është mungesa e ndërthurjes së mësimdhënies me punën kërkimore-shkencore. Tregues i drejtpërdrejtë i kësaj anomalie është ekzistenca e dy ligjeve të ndara për Arsimin e Lartë dhe për Shkencën, që pasqyrohet në të gjithë organizimin e arsimit të lartë në vend.

4.2.4. Vihen re edhe moszbatime apo zbatime të gabuara të ligjit aktual të arsimit të lartë, pavarësisht nga problematikat që ai paraqet në vetvete, si nga institucionet qendrore qeverisëse edhe nga IAL-të. Kjo ndodh për arsye të ndryshme që lidhen si me faktorin njerëzor, ashtu edhe me mungesën e mekanizmave të vlerësimit dhe të kontrollit në çdo hallkë të sistemit. Raportimet vjetore nga ana e IAL-ve nuk janë gjithnjë transparente dhe here pas here u mungon analiza reale e gjendjes së tyre në çdo nivel, që nga cilësia e mësimdhënies deri te standardi i punës kërkimore-shkencore. Llogaridhënia në disa raste është në nivel minimal.

4.2.5. Zhvillimet e vrullshme të sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri kanë sjellë mbivendosje të ofertës akademike të IAL-ve dhe mungesë të përshtatjes më të mirë të rezultateve të të mësuarit me nevojat e tregut.

4.2.6. Një mangësi tjetër e sistemit është edhe centralizimi i theksuar dhe vertikal i vendimmarrjes.

Kjo shkaktohet edhe nga mungesa e autonomisë dhe e paanshmërisë së plotë në marrjen e vendimeve prej agjencive dhe këshillave kombëtarë të përmendur më sipër.

**4.2.7.** Një tjetër problem i sistemit është ndërhyrja me akte nënligjore e Këshillit të Ministrave dhe e MAS-it, të cilat, herë pas here, nuk e kanë ndihmuar zhvillimin e qëndrueshëm të arsimit të lartë, dhe në jo pak raste kanë cënuar edhe atë autonomi të garantuar me ligj për IAL-të.

### 4.3 SUGJERIMET

**4.3.1.** Për t'u dhënë zgjidhje problematikave të nxjerra në pah në këtë raport propozohet një strukturë e re organizative e njësuar për institucionet e arsimit të lartë, e cila do të rrisë efikasitetin dhe autonominë institucionale të tyre. Në sugjerimet e mëposhtme janë mbajtur parasysh parime të rëndësishme të menaxhimit universitar dhe përvojat më të mira ndërkombëtare. Kështu, parimet e organizimit të sistemit të arsimit të lartë mund të përmbliidhen si vijon:

- Qeveria është përgjegjëse për garantimin e standardeve në të gjithë sistemin e arsimit të lartë në RSH, pavarësisht nga forma e pronësisë, origjina e themelimit, apo specifika të tjera, bazuar në Kushtetutë.
- Autonomia e plotë shprehet në 4 format e saj: akademike, financiare, organizative dhe e personelit.
- Qeveria, përmes organizmave të pavarur, vendës ose të huaj, është përgjegjëse për licencimin, akreditimin dhe renditjen e IAL-ve dhe të programeve të studimit sipas cilësisë që ato ofrojnë, në funksion të transparencës ndaj studentëve, publikut dhe shoqërisë, dhe si premisë për shpërndarjen e fondeve publike.
- Qeveria, përmes organizmave të pavarur, vendës ose të huaj, vlerëson cilësinë e veprimtarisë kërkimore-shkencore në IAL, si kusht themelor për shpërndarjen e fondit publik për kërkimin shkencor dhe inovacionin.
- Qeveria, përmes përcaktimit të përparësive të zhvillimit dhe të interesave strategjike të vendit, vë në dispozicion fonde publike për mbështetjen e programeve të caktuara të studimit ose fushave të kërkimit shkencor.
- Qeveria vë në dispozicion fonde publike, për të garantuar mundësinë e ndjekjes së studimeve të larta sipas meritës, pavarësisht nga mundësitë financiare të individëve.
- Qeveria krijon mekanizmat dhe monitoron përgjegjshmërinë e funksionimit të IAL-ve, përmes

organizmave vendës ose të huaj, duke shërbyer si rregullator i sistemit të arsimit të lartë.

**4.3.2.** Në mënyrë të përmbledhur, sugjerimet për strukturën e re të sistemit të menaxhimit të arsimit të lartë, për të rritur efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e tyre, mbështeten në këto elemente:

- vendosja e konkurrencës në themel të financimit;
- eliminimi i burokracisë dhe rritja e efektivitetit të funksionimit të tyre;
- krijimi i mekanizmave të kontrollit dhe të llogaridhënies;
- garantimi i autonomisë institucionale të IAL-ve.

**4.3.3.** Propozimet e bëra mbajnë parasysh uljen e kostos së kalimit nga skema e vjetër tek e reja, duke transformuar disa nga institucionet ekzistuese, por edhe duke krijuar institucione të reja dhe të pavarura.

### AKF – AGJENCIA KOMBËTARE E FINANCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË (DHE SHKENCËS).

**4.3.4.** Ky është një institucion i ri në menaxhimin e sistemit të arsimit të lartë. Ai është përgjegjës për shpërndarjen e fondeve publike sipas politikave qeverisëse.

**4.3.5.** Ky institucion, i drejtuar dhe i organizuar nga një bord akademikësh dhe menaxherësh, ka pavarësi në vendimarrjen e tij. Anëtarët e bordit emërohen nga MAS-i pas propozimeve të bëra nga IAL-të në vend. Në përbërje të bordit, midis anëtarëve të tjerë, ka edhe përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, si dhe nga Ministria e Financave. Sugjerohet që bordi drejtues të jetë KALSH-i.

**4.3.6.** Qëllimi i kësaj agjencie është që të shpërndajë fondet publike në drejtim të katër veprimtarive të rëndësishme:

1. Grantit të Mësimdhënies (“Core Grant”)
  - a. Fondi për mbështetjen e institucionit garanton funksionimin e IAL-ve publike;
  - b. Fondi i mbështetjes - Bursat e studimit për:
    - studentë të shkëlqyer;
    - studentë në programet prioritare të studimit;
    - studentë në pamundësi financiare (bursat sociale).
2. Punës kërkimore - shkencore (pjesa logjistike);
3. Zhvillimit;
4. Mbështetjes së skemës së kredive studentore.

**4.3.7.** Mënyra e financimit dhe skema që ndiqet nga kjo agjenci për financimin e IAL-ve, është dhënë e detajuar në kreun 6, të financimit të arsimit të lartë. Financimi kryesor i punës kërkimore-shkencore bëhet nga Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, mbi bazën e projekteve të fituara nëpërmjet aplikimit individual apo në grup.

**4.3.8.** AKF-ja është përgjegjëse, gjithashtu, për të propozuar kriteret dhe formulat mbi të cilat bëhet shpërndarja e fondeve publike për arsimin e lartë. Çdo vit, Ministria e Arsimit dhe e Sportit shpall Letrën e Prioriteteve, në bazë të së cilës realizohet shpërndarja e fondeve publike, sipas drejtimeve kryesore.

**4.3.9.** Puna e kësaj agjencie mbështetet në katër parime të rëndësishme:

- I.** Konkurrenca e lirë (zgjedhje e gjerë për studentët);
- II.** Mundësi të barabarta (pa pasur parasysh të ardhurat);
- III.** Ekselencia në mësimdhënie dhe punë kërkimore-shkencore;
- IV.** Përparësitë kombëtare të zhvillimit.

## **AKKSH – AGJENCIA KOMBËTARE PËR KËRKIMIN SHKENCOR.**

**4.3.10.** Kjo agjenci nuk është institucion i ri, por është në të vërtetë një evoluim i Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI). Ajo ka autonomi të theksuar në ushtrimin e veprimtarisë së saj, si edhe AKF-ja. Bordi është organi më i lartë vendimmarrës dhe ka në përbërjen e tij, përveç anëtarëve akademikë të propozuar nga IAL-të dhe të emëruar nga MAS-i, edhe përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit, të Ministrisë së Inovacionit dhe të Ministrisë së Financave. Sugjerohet që Bordi i AKKSh-së të mos ketë më shumë se 7 anëtarë. Agjencia drejtohet nga drejtori ekzekutiv, i cili propozohet nga Ministri i Arsimit dhe i Sportit dhe miratohet nga bordi.

**4.3.11.** Ndër përgjegjësitë e kësaj agjencie është dhe identifikimi i fushave parësore në kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin.

**4.3.12.** AKKSH-i ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për organizimin e procesit të vlerësimit dhe renditjen e punës kërkimore shkencore të IAL-ve për çdo departament. Ky ushtrim, që është shumë i rëndësishëm për shpërndarjen e investimeve për punë kërkimore-shkencore nga AKF-ja, bëhet në mënyrë të rregullt çdo 4 vjet. Çdo akademik duhet të paraqesë tri nga punimet e tij shkencore

pranë saj. Puna kërkimore-shkencore vlerësohet mbi bazën e një sistemi pikësh nga komisione të disiplinave përkatëse. Këto komisione në fazën e parë të vënies në jetë të reformës mund të përbëhen edhe nga akademikë të huaj. Vlerësimi i çdo individi kryhet në nivel departamenti dhe kështu bëhet vlerësimi mbi bazën e departamentit, dhe mbi të realizohet renditja e IAL-ve. Pasi bën këtë vlerësim publik, kjo agjenci ia komunikon AKF-së vlerësimin dhe renditjen 4-vjeçare të IAL-ve.

**4.3.13.** Qëllimi kryesor i kësaj agjencie është që, nëpërmjet instrumenteve të saj, të shpërndajë fondet e punës kërkimore-shkencore mbi bazë aplikimi. Fondet shpërndahen mbi fusha të gjera studimi të njohura ndërkombëtarisht (subject-areas, subject categories).

**4.3.14.** Kjo agjenci miraton përmes konkurrimit edhe fonde për studimet e doktoratës. Ajo nuk u heq mundësinë IAL-ve të përfitojnë fonde të tjera për këto studime edhe prej grantit të AKF-së. Kuotat e pranimit në programet e doktoratës, të përcaktuara në bazë të standardeve për çdo program, mund të jenë më të mëdha se numri i atyre që përfitojnë financim. Në këtë rast, IAL-të kanë të drejtë të aplikojnë tarifën e plotë sipas kostove.

**4.3.15.** Kjo agjenci mund të administrojë edhe fonde të tjera joqeveritare (fonde të dhuruara nga organizma ndërkombëtarë, nga biznesi e të tjera).

## **AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË - ASCAL**

**4.3.16.** Agjencia aktuale, APAAL, nën një emërtim të rishikuar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ASCAL, duhet të zgjerojë fushën e saj të veprimtarisë dhe të kompetencave me mekanizma të rinj dhe më efektivë, veçanërisht në monitorimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të çdo njësie të IAL-ve dhe të bëhet pjesë e rrjetit evropian të agjencive (ENQA). ASCAL-i është një institucion i MAS-it, me pavarësi reale në drejtim të procedurave, operativitetit, raporteve të vlerësimit dhe menaxhimit financiar, duke synuar që në të ardhmen të ketë edhe pavarësi statutoare dhe financiare si edhe shumë agjenci simotra të rrjetit të ENQA-së. Sugjerohet që drejtori i ASCAL-it të propozohet nga Ministri dhe të emërohet nga Kryeministri.

**4.3.17.** Rezultatet e vlerësimit nuk duhet të ndikohen nga asnjë palë jashtë procesit teknik dhe përmbajtësor të vlerësimit, dhe nevojitet

të shoqërohen me hartimin e kriterëve dhe standardeve të qarta e lehtësisht të lexueshme nga vendimmarrësit, studentët dhe publiku i gjerë. Sipas kësaj fryme ndahen plotësisht nga njëri-tjetri proceset e:

- Licencimit, që bëhet nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit
- Akreditimit, që bëhet nga ASCAL-i
- Renditjes, që bëhet nga një agjenci kombëtare ose ndërkombëtare e përzgjedhur nga Qeveria.

**4.3.18.** Këshilli (Bordi) i Akreditimit, në koherencë me rezultatet e vlerësimit, merr në mënyrë objektive, të paanshme, të pandikuar dhe periodike, vendimin përfundimtar në lidhje me akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve që ato ofrojnë. Bordi i Akreditimit sugjerohet të përbëhet nga ekspertë vendës dhe të huaj. Bordi i Akreditimit funksionon si ent më vete nga ASCAL-i. Detyrat e Agjencisë duhet të ndahen prej detyrave të Bordit të Akreditimit. Bordi i Akreditimit sugjerohet të mbajë këtë emërtim, sepse nuk këshillon, por merr vendime për akreditim.

**4.3.19.** Sistemi i Sigurimit të Cilësisë duhet të sanksionojë qartë se vepron në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me ekspertizë të huaj dhe agjenci homologe jashtë vendit, pjesë të ENQA-së. Komisioni sugjeron që të forcohen kriteret e vlerësimit të cilësisë në sferën e mësimdhënies sipas direktivave dhe udhëzimeve të Bashkimit Evropian.

**4.3.20.** Përveç vlerësimit të parë dhe periodik, ASCAL-i duhet të ketë detyra dhe përgjegjësi të shtuara në procesin e vlerësimit të mësimdhënies, si një nga shtyllat kryesore të cilësisë, e lidhur drejtpërdrejt me studentin, dhe monitorimin e saj të vazhdueshëm në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Njësitë e Sistemit të Sigurimit të Cilësisë brenda IAL-ve duhet të fillojnë procesin e vlerësimit të mësimdhënies, bazuar edhe në rezultatet e tyre në dalje ("outcome oriented") dhe të mësimnxënies, mbështetur në rezultatet e të mësuarit. Ato duhet të rrisin, gjithashtu, dukshmërinë publike dhe të sigurojnë informimin e studentëve, në mënyrë që t'i ndihmojë ata për përzgjedhjen e studimeve të tyre të ardhshme.

**4.3.21.** Si pjesë e vlerësimit të mësimdhënies, kjo agjenci duhet të bëjë edhe vlerësimin e programeve të studimit dhe të diplomave të lëshuara nga çdo IAL. Pasi bën këto vlerësime, agjencia duhet të hartojë raportet e vlerësimit për çdo IAL. Raportet

duhet të publikohen dhe të jenë transparente për të gjithë publikun, e në veçanti për studentët e ardhshëm.

**4.3.22.** Një tjetër detyrë e rëndësishme e kësaj agjencie është të hartojë direktivat ("guidelines") për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të propozojë një dokument të rëndësishëm - Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë në Shqipëri, i cili dërgohet në MAS dhe miratohet me VKM.

**4.3.23.** Puna e kësaj agjencie mbështetet në komisionet e zgjedhura dhe të pavarura që bëjnë këto vlerësime, në të cilët përfshihen personalitete nga të gjitha IAL-të, por edhe nga shoqëria civile dhe studentët.

**4.3.24.** Një tjetër detyrim i kësaj agjencie është të organizojë vrojtimet trevjeçare të studentëve (Sondazhi Kombëtar i Studentëve) për cilësinë e mësimdhënies, si dhe t'i bëjë ato publike në kuadër të transparencës dhe informimit të publikut.

## **AKAU – AGJENCIA KOMBËTARE E APLIKIMIT UNIVERSITAR**

**4.3.25.** Ky institucion është një ide e re në kushtet e Shqipërisë, por me rëndësi shumë të madhe, pasi do të reformojë hyrjen në arsimin e lartë, duke përmirësuar standardin e rekrutimit të studentëve.

**4.3.26.** Është agjenci varësie e MAS-it .

**4.3.27.** AKAU do të ketë katër funksione kryesore:

- Organizimin e aplikimit studentor;
- Matrikullimin;
- Provimin e shtetit për profesionet e rregulluara;
- Menaxhimin e bazës së të dhënave universitare.

**4.3.28.** Detyra kryesore e kësaj agjencie është organizimi i aplikimit universitar për çdo kandidat dhe çdo institucion, publik apo jopublik, pasi Ministria u ka miratuar të gjitha IAL-ve kuotat, sipas kriterëve. Kjo agjenci nuk merr vendimin për përzgjedhjen e studentit, pasi kjo është kompetencë e drejtpërdrejtë e çdo IAL-je.

Procedura e aplikimit është si më poshtë: Çdo kandidat duhet të dërgojë formën e aplikimit, nëntë (6) muaj përpara se të mbarojë shkollën e mesme (jo më larg se mesi i dhjetorit të vitit paraardhës), ku të ketë përcaktuar pesë zgjedhjet e tij të lira. Brenda dy muajsh kjo agjenci verifikon të dhënat e çdo aplikanti dhe ua kalon aplikimin studentor për vendimmarrje IAL-ve të zgjedhura



nga vetë kandidati. Brenda dy muajsh nga marrja e aplikimeve, IAL-të duhet të bëjnë ofertat studentore (jo më larg se muaji mars i të njëjtit vit akademik). IAL-ve që duan të aplikojnë kriterin e konkursit (pas ofertës së bërë), u jepet mundësia që ta organizojnë atë në periudhën midis fundit të maturës shtetërore dhe fillimit të vitit akademik. Çdo IAL, sipas kriterëve të veta, menaxhon procesin e pranimit të kandidatëve dhe ua komunikon atyre ofertën e bërë.

**4.3.29.** Numri minimal i pikëve që duhet të fitojë kandidati për të pasur të drejtë të aplikojë për të ndjekur studimet në ciklin e parë (Bachelor) përcaktohet me VKM. Nga ana tjetër, çdo IAL ka të drejtë të caktojë kriteret e veta shtesë. Për ciklin e dytë të studimeve (Master), agjencia bën vetëm organizimin e aplikimit për efekt matricullimi dhe transparence.

Kjo agjenci ka për detyrë të bëjë transparente notat mesatare të pranimeve të studentëve në ciklin e parë edhe të dytë për çdo IAL. Komisioni sugjeron që në fazën e dytë të vënies në jetë të reformës, të aplikohet një kriter minimal edhe për pranimet në programet e ciklit të dytë, Master i Shkencave.

**4.3.30.** Agjencia kryen edhe kontrollin e të dhënave të deklaruara, si dhe të procedurave të ndjekura nga aplikantët.

**4.3.31.** Procedurat e ndjekura nga kjo agjenci për pranimet në IAL funksionojnë mbi bazën e parimeve të barazisë, konkurrencës së lirë dhe të së drejtës së zgjedhjes së çdo individ që dëshiron të studiojë.

**4.3.32.** Agjencia ka për detyrë, gjithashtu, të krijojë një bazë të dhënash, të plotë për çdo

IAL, për programet e studimit dhe diplomat apo certifikatat që lëshohen; të vërë në dispozicion të publikut informacionet e nevojshme për të bërë transparencën lidhur me procedurat e ndjekura për pranimet, diplomimet etj.

**4.3.33.** Kjo agjenci është përgjegjëse edhe për krijimin e një baze të dhënash kombëtare të të diplomuarve dhe të studentëve që po ndjekin universitetet publike dhe jopublike. Agjencia u jep mundësi në kohë reale IAL-ve për të hedhur të gjitha të dhënat e studentëve dhe të karrierës së tyre shkollore, duke u ofruar atyre mundësinë e printimit të certifikatave të notave në çdo çast kohor.

**4.3.34.** IAL-të, sipas detyrimeve ligjore, duhet të mbajnë të përditësuar bazën e të dhënave, e krijuar me të dhënat e studentëve dhe të karrierës së tyre shkollore, përfshi edhe të dhënat për pedagogët e angazhuar në mësimdhënie në IAL-në përkatëse.


Kjo garanton vërtetësinë e të dhënave duke eliminuar dhënien e diplomave të pamërituara dhe falsifikimin e notave. Gjithashtu, sigurohet një panoramë e përgjithshme në çdo çast kohor e studentëve dhe pedagogëve, duke mundësuar kështu edhe monitorimin e standardeve akademike të mësimdhënies. Veç kësaj, monitorohet pjesëmarrja në projekte dhe në kërkimin shkencor të personelit akademik, duke i ofruar AKKSH-së një bazë të dhënash për vlerësimin e kërkimit shkencor dhe financimin e tij.

**4.3.35.** Ky raport nuk analizon të gjitha organet këshilluese apo vendimmarrëse në sistemin e arsimit e lartë në Shqipëri, dhe fakti që nuk janë përmendur, nuk do të thotë që do të pushojnë së ekzistuari apo që nuk duhet t'i nënshtrohen një analize të plotë në një fazë të dytë.<sup>4</sup>

<sup>4</sup>Organizmat e tjerë institucionalë në varësi të MAS-it do të shihen në një fazë të dytë të punës së Komisionit për Reformën në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor.

Figura 4.1. Skema institucionale e propozuar për organizimin e arsimit të lartë në Shqipëri

SKEMA INSTITUCIONALE E PROPOZUAR PER ORGANIZIMIN E ARSIMIT TE LARTE NE SHQIPERI



## KREU 5

# ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

### 5.1. ORGANIZIMI AKTUAL I IAL-VE

Problemet e hasuara në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri, sipas raporteve të ndryshme të hartuara nga specialistë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, janë të natyrave të ndryshme, të cilat janë adresuar edhe nga politika qeverisëse të mëparshme, duke pasur si pikësynim rritjen e autonomisë institucionale të IAL-ve në Shqipëri.

Fillimisht, në këtë kre paraqitet shkurtimisht struktura e përgjithshme e IAL-ve dhe vendimmarrja në to, më pas analizohen problemet që vihen re në organizimin e brendshëm të IAL-ve, për të përfunduar me sugjerimet dhe ndryshimet e rekomanduara nga komisioni.

### 5.2. ORGANIZIMI STRUKTUROR DHE VENDIMMARRJA NË IAL

IAL-ja është e organizuar në këto njësi përbërëse organizative:

- Njësi kryesore (fakultetet, institutet e kërkimit dhe të zhvillimit, kolegjet profesionale dhe filialet),
- Njësi bazë (departamentet dhe qendrat e kërkimit dhe të zhvillimit)
- Njësi ndihmëse (laboratorët, stacionet eksperimentale, njësitë didaktike, bibliotekat dhe njësi të tjera, që realizojnë studime, projekte dhe shërbime).

IAL-ja drejtohet nga organe vendimmarrëse kolegjinale, si: Senati, Këshilli i Administrimit, Këshilli i Fakultetit dhe autoritete drejtuese ekzekutive, si: Rektori, Dekani, Përgjegjësi i departamentit. Anëtarët e Senatit dhe të Këshillit të Fakultetit zgjidhen nga i gjithë stafi. Në këto organe, personeli joakademik (që nënkupton personelin ndihmës akademik dhe atë administrativ) dhe studentët përfaqësohen përkatësisht me 5% dhe 15%. Po ashtu, dhe autoritetet drejtuese zgjidhen nga i gjithë personeli përkatës, ku votat e personelit joakademik dhe të studentëve vlejnjë përkatësisht 5% dhe 20% të numrit të përgjithshëm të votave.

Në rastet e qendrave ndëruniversitare, autoritetet drejtuese përzgjidhen me konkurs të hapur. Senati kryesohet nga rektori, ndërsa Këshilli i Fakultetit

nga dekani. Këshilli i Administrimit përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur nga personeli akademik i fakulteteve, të cilët kanë të paktën gradën shkencore “Doktor”, nga përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit dhe nga një përfaqësues i studentëve. Këshilli i Administrimit kryesohet nga kryetari, i cili zgjidhet nga anëtarët e tij me dy të tretat e votave. Ai ka detyrë mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarive të IAL-së, që lidhen me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të pronave të tij. Organet dhe autoritetet drejtuese në IAL zgjidhen për një mandat 4-vjeçar dhe nuk mund të rizgjidhen për më shumë se dy mandate radhazi në të njëjtin funksion.

Drejtuesi më i lartë i një institucioni të arsimit të lartë është Rektori, i cili është autoriteti drejtues dhe përfaqësues i këtij institucioni. Emërimi i rektorit të zgjedhur/drejtorit të qendrës ndëruniversitare nuk është kompetencë e Ministrit, por e Presidentit të vendit. Shkarkimi propozohet nga Ministri i Arsimit dhe i Sportit dhe miratohet nga Presidenti. Emërimi i dekanit të zgjedhur bëhet nga rektori dhe shkarkimi i tij nga Ministri i Arsimit dhe i Sportit, me propozim të rektorit të IAL-së. Kancelari i institucionit është përgjegjës për drejtimin e përditshëm të institucionit, për zbatimin e buxhetit, për kontrollin dhe zbatimin e veprimtarisë financiare, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë. Kandidatura e kancelarit përzgjidhet nga Këshilli i Administrimit dhe i paraqitet për miratim ministrit nga rektori. Në IAL janë parashikuar dhe autoritete të tjera drejtuese, si: zv.rektorët, zv.dekanët dhe kancelarët e njësisive kryesore.

### 5.3. PROBLEMATIKA

**5.3.1** Një nga problemet kryesore të hasura në menaxhimin e IAL-ve në Shqipëri është mungesa e ndërveprimit, në nivelin e duhur, të strukturës akademike me atë menaxheriale. Ky organizim i brendshëm ka sjellë pasoja jopozitive për funksionimin institucional të IAL-ve, siç janë:

- mungesa e përgjegjësisë së drejtpërdrejtë për suksesin dhe dështimin e një IAL-je;
- rritja e ngarkesës akademike në krahasim me IAL-të e rajonit dhe të kontinentit, dhe ngarkesa me detyra të vështira menaxheriale e personelit

akademik drejtues të IAL-ve;

- mungesa e autonomisë së plotë;
- mungesa e fleksibilitetit për të sjellë studentë dhe fonde në IAL;
- ngurtësimi i funksionimit të IAL-ve si rezultat i mungesës së menaxhimit të mirë të burimeve dhe të mundësive të veta, e të tjera.

**5.3.2.** Një tjetër problem që haset në institucionet e arsimit të lartë, është mënyra dhe formula e organizimit të zgjedhjeve në këto institucione. Zgjedhjet përfshijnë jo vetëm personelin akademik, por edhe atë joakademik, si edhe komunitetin studentor, mbi bazën e një përqindjeje të caktuar. Drejtuesit akademikë të institucionit nuk ka pse të zgjidhen nga një komunitet kaq i gjerë individësh, ku jo të gjithë kanë interesin dhe njohjen e duhur akademike.

**5.3.3.** Një tjetër problem është mungesa e ekuilibrit mes autonomisë së IAL-ve dhe mekanizmave efektivë të kontrollit, në këtë rast nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, për zbatimin e ligjit dhe përdorimin e kësaj autonomie. Në disa raste vërehet një mungesë transparence dhe llogoridhënieje në IAL.

**5.3.4.** Në kuadër të kësaj autonomie nuk është shumë e qartë se cili është organi përgjegjës për mosfunksionimin e institucionit të arsimit të lartë. Futja e Këshillave të Administrimit është një risi, por detyrat dhe përgjegjësitë e tyre duhet të jenë më të qarta dhe më përfshirëse në drejtim të funksionimit të IAL-së.

**5.3.5.** Personeli akademik, si rrjedhojë e mosmbështetjes financiare nga IAL-të publike, ka synuar burime alternative financiare nëpërmjet shumëpunësimit. Kjo praktikë, në disa raste, rezulton problematike dhe ka efekt të drejtëpërdrejtë në cilësinë e veprimtarisë akademike pranë IAL-së ku ai punon me kohë të plotë. Gjithashtu, ka krijuar një gjendje të ngurtësuar në drejtim të punës kërkimore-shkencore, që pasqyrohet në rënien e cilësisë së mësimdhënies.

**5.3.6.** Problem i hasur gjatë analizave dhe i shprehur nga shumë anëtarë të personelit akademik është mënyra dhe kriteret e promovimit të personelit akademik. Në radhë të parë, miratimi për titujt akademikë vazhdon të bëhet nga një organizëm rudimentar i centralizuar pranë Ministrisë. Kjo sjell probleme, qoftë në drejtim të administrimit të procesit, por edhe në drejtim të kriterëve të promovimeve.

**5.3.7.** Organizimit strukturor të IAL-ve i mungojnë edhe instrumentet për kryerjen dhe nxitjen e punës kërkimore-shkencore në çdo nivel, në departament,

në fakultet apo në IAL. Kësaj i shtohet edhe mungesa e instituteve apo qendrave të kërkimit shkencor brenda fakulteteve apo universiteteve, të cilat, ose janë të pakta në numër, ose, në të shumtën e rasteve, nuk ekzistojnë.

## 5.4. SUGJERIMET

### Autonomia Universitare

**5.4.1.** Një nga drejtimet më të rëndësishme të zhvillimit të arsimit të lartë në Evropë e më gjërë është rritja e autonomisë universitare. Kjo është theksuar në të gjitha deklaratat e organizmave evropianë për arsimin e lartë, nga Deklarata e Salamankës (2001), ajo e Gracit (2003) e deri tek ajo e Lisbonës (2007), në të cilën u përcaktuan qartë edhe fushat e kësaj autonomie. Në organizimin e institucioneve të arsimit të lartë në vend, si edhe të të gjitha hallkave të arsimit të lartë është synuar forcimi i autonomisë së IAL-ve në të gjitha drejtimet.

- Autonomia akademike, IAL-të të vendosin vetë për kurrikulat, fushat e kërkimit, metodat e mësimdhënies, si dhe për programet e mësimdhënies;
- Autonomia financiare, të diversifikohet mënyra e financimit të IAL-ve; autonomi në administrimin e të ardhurave, si dhe një autonomi e kontrolluar në vendosjen e tarifave të studimit, brenda një tarife tavan;
- Autonomia organizative, në organizimin e strukturave të IAL-ve dhe statutit të tyre, zgjedhjen e organeve dhe autoriteteve drejtuese të IAL-ve, në hartimin e kontratave financiare nga vetë IAL-të;
- Autonomia e personelit, IAL-të janë përgjegjëse për zgjedhjen dhe punësimin e personelit të tyre, promovimin akademik të personelit dhe caktimin e pagave.

### Dispozita të Përgjithshme

**5.4.2** Në institucionet e arsimit të lartë duhet të ndahet qartë përgjegjësia financiare nga ajo akademike, të cilat të kontrollohen në mënyrë të koordinuar. Kështu, drejtuesit akademikë nuk duhet të kenë përgjegjësi financiare dhe organizmat akademikë të universitetit nuk merren me menaxhimin financiar të tij.

**5.4.3.** Për këtë është e domosdoshme që çdo IAL të ketë një sistem qeverisjeve që bazohet në parimet e kontrollit dhe të ekuilibrit mes qeverisjes akademike (senat, rektor, dekan dhe departament)

dhe asaj financiare-administrative (bord administrativ, administrator i IAL-së, administrator i fakultetit, administrator departamentesh). Për anën organizative, shih skemën 5.1. Këto dy funksione koordinohen përkatësisht nga Senati dhe Bordi Administrativ.

**5.4.4.** Skema e zgjedhjeve propozohet të ndryshojë. Parimi kryesor i zgjedhjeve është që drejtuesit të zgjidhen nga grupe që kanë njohuri të drejtpërdrejta mbi kompetencat dhe rolin e tyre. Në rastin e senatit apo të rektorit, në zgjedhje duhet të marrë pjesë vetëm personeli akademik me kohë të plotë i IAL-së. Studentët do të kenë një përfaqësim më të gjërë në vendimmarrjen e IAL-së, i cili detajohet në seksionin e organizimit studentor në këtë kapitull.

**5.4.5.** Në qendër të vendimmarrjes akademike është Asambleja e Personelit Akademik (i gjithë personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore). Ky organizëm është shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e vendimmarrjes demokratike dhe meritokratike në njësinë kryesore. Asambleja e Personelit Akademik merr përgjegjësitë e Këshillit të Fakultetit (në rastin e fakultetit) dhe një pjesë të tyre i delegon në disa komisione të përhershme, të ngritura në nivel fakulteti. Komisioni sugjeron që Këshilli të Fakultetit nuk duhet të funksionojë më. Kjo formulë synon të rrisë efikasitetin e punës së çdo njësie të IAL-së dhe të zgjerojë bazën e vendimmarrjes nga personeli akademik. Ky organizëm është përgjegjësi kryesor për vendimmarrjen akademike të universitetit, që nga zgjedhja e anëtarëve të komisioneve të përhershme deri te zgjedhja e senatit dhe e dekanit. Asnjë vendim i rëndësishëm akademik në IAL nuk mund të merret jashtë këtij forumi (shih skemën 5.1).

## Departamenti

**5.4.6.** Departamenti merr më shumë kompetenca që lidhen me procesin e pranimit të studentëve, procesin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, por edhe në drejtim të karrierës për fitimin e gradës shkencore “Doktor i shkencave”. Departamenti krijon strukturat e brendshme të tij për menaxhimin e këtij procesi. Në fushën e pranimit të studentëve në programet e doktoratës dhe të mbrojtjes së gradës shkencore, departamenti merr disa nga kompetencat e Këshillit të Profesorëve, i cili sugjerohet të mos funksionojë më.

**5.4.7.** Si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe e punës kërkimore-shkencore, departamenti është përgjegjësi kryesor për llojet e studimeve që

organizon në të gjitha ciklet e studimit, për kurrikulat e studimeve, si dhe propozon numrin e programeve që duhet të organizojë dhe numrin e studentëve për çdo program. Në rastet e programeve të përbashkëta duhet të caktohet departamenti kryesor përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit.

**5.4.8.** Departamenti mundet të ndërtohet edhe në bazën e grupeve të kërkimit dhe të mësimdhënies në përputhje me fokusin dhe misionin që ai i ka vendosur vetes. Departamenti nuk mund të jetë i tillë pa program studimi mësimor dhe kërkim shkencor. Të dy këto procese akademike, të mishëruara te çdo akademik, organizohen në nivel departamenti.

**5.4.8.** Departamenti duhet të menaxhojë fondet bazë të kërkimit shkencor, që shkojnë në departament nga burime të tjera. Departamenti duhet të ketë lirinë për të zhvilluar veprimtari për dhënien e shërbimeve për të tretë, sipas rregullave të përcaktuara, dhe të krijojë të ardhura nga kjo veprimtari, të cilat të riinvestohen në të mirë të veprimtarisë akademike të institucionit.

**5.4.9.** Departamenti përcakton kriteret dhe numrin e pranimeve në IAL për të gjitha ciklet dhe programet e studimit që mbulon.

**5.4.10.** Departamenti/Qendra ka në përbërje të paktën 7 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë. Të punësuarit në departament mund të angazhohen edhe në qendra studimore e kërkimore të IAL-së, por nuk mund të llogariten më shumë se një herë brenda IAL-së.

**5.4.11.** Departamenti zgjedh drejtuesin e departamentit nga radhët e tij. Ky i fundit duhet të mbajë titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar” dhe gradën “Doktor”, në qoftë se nuk ka konkurrencë. Drejtuesi i departamentit zgjidhet me mandat 4-vjeçar dhe nuk duhet të shërbejë në më shumë se dy mandate.

**5.4.12.** Sugjerojmë krijimin e postit të administratorit të departamentit, i cili do të merret me nevojat administrative dhe menaxheriale të departamentit, duke lehtësuar punën e drejtuesit akademik të departamentit. Ai mund të ketë nën varësi (sipas nevojave) një numër anëtarësh të personelit administrativ. Një administrator mund të mbulojë më shumë se një departament. IAL-të vendosin, në varësi të madhësisë dhe të financave të tyre, numrin e administratorëve të departamenteve, si dhe përcaktojnë rolin dhe detyrat e administratorit të departamentit sipas nevojave të tyre.

**5.4.13.** Dekani është drejtuesi i njësisë kryesore akademike, i cili koordinon veprimtarinë e njësisë. Kopetencat e dekanit përfaqësohen në ligj dhe në aktet nënligjore të IAL-ve.

## Senati

**5.4.14.** Organi akademik vendimmarrës më i lartë është Senati, i cili zgjidhet nga Asambleja e Personelit Akademik e njësisë kryesore me votim të përgjithshëm. Anëtarët e Senatit vetëkandidojnë për zgjedhje dhe duhet të jenë pedagogë me titull “Profesor” ose “Profesor i asociuar”. Ata shërbejnë për një periudhë 4-vjeçare. Përfaqësimi në Senat do të vazhdojë të bëhet në bazë fakulteti, sipas praktikës së deritanishme. Numri i anëtarëve të Senatit mund të përcaktohet edhe në raport me numrin e personelit akademik të IAL-së.

**5.4.15.** Senati mbulon dhe miraton të gjitha çështjet akademike të IAL-së. Ai drejtohet nga rektori, i cili raporton në senat në mënyrë periodike.

**5.4.16.** Rektori është autoriteti më i lartë akademik i një IAL-je. Detyrat dhe kompetencat e tij përcaktohen me ligj dhe me aktet e brendshme të çdo IAL-je.

**5.4.17.** Rektori zgjidhet nga Asambletë e Personelit Akademik të njësisë kryesore dhe duhet të jetë anëtar i personelit akademik të IAL-së. Rektori dhe zëvendësrektorët duhet të jenë pedagogë me titull “Profesor” për rektorin dhe “Profesor” ose “Profesor i asociuar” për zëvendësrektorin. Rektori nuk mund të shërbejë në më shumë se dy mandate.

**5.4.18.** I njëjti sistem zgjedhjeje zbatohet për zgjedhjen e dekanëve, të cilët zgjidhen nga Asambleja e Personelit Akademik e fakultetit përkatës.

## Bordi Administrativ

**5.4.19.** Organi përgjegjës për performancën financiare të çdo IAL-je është Bordi Administrativ (aktualisht Këshilli i Administrimit). Për të rritur përgjegjshmërinë dhe mirëmenaxhimin e IAL-ve publike dhe financimin publik në këto institucione propozohet krijimi i kompetencave të qarta të Bordit Administrativ. Në drejtim të aspektit menaxherial, komisioni sugjeron:

- Në përbërjen e Bordit Administrativ të çdo IAL-je të jenë shtatë anëtarë.
- Nëse IAL-ja siguron vetë më shumë se 50% të të

ardhurave, atëherë formula e përbërjes së Bordit do të jetë: katër nga shtatë anëtarët propozohen nga vetë IAL-ja; dy propozohen nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit dhe një propozohet nga autoriteti lokal.

- Nëse IAL-ja siguron vetë më pak se 50% të të ardhurave, atëherë formula ndryshon: dy anëtarë propozohen nga vetë IAL-ja, katër propozohen nga MAS-i dhe një propozohet nga autoriteti lokal.
- Në të dy rastet e mësipërme, zgjedhja e anëtarëve të Bordit bëhet nga Senati, sipas propozimeve të IAL-së për anëtarët e tij, MAS-it dhe autoritetit lokal për anëtarët e tyre.
- Individët që propozohen për anëtarë të Bordit nga tre organizmat e sipërpërmendur, nuk janë domosdoshmërisht punonjës të tyre. Ata përzgjidhen për kontributin e tyre të shquar në shoqëri. Anëtarët e Bordit mund të zgjidhen nga fusha të ndryshme të jetës.
- Rektori, dekanët dhe administratori i IAL-së nuk mund të jenë anëtarë me të drejta të plota të Bordit, por marrin pjesë në mbledhjet e tij pa të drejtë vote.
- Bordi është organ mbikqyrës, por jo drejtues. Ka të drejtë firme dhe mbikëqyr dhe miraton strategjinë e zhvillimit dhe anën financiare të IAL-së.
- Anëtarët e Bordit janë të punësuar me kohë të pjesshme. Bordi duhet të mbledhet të paktën një herë në muaj. Mbledhjet, takimet dhe pagesat e anëtarëve duhet të jenë të qartësuara në statutet e vetë IAL-ve.
- Anëtarët e Bordit shkarkohen vetëm për arsye objektive. Propozimi për shkarkim bëhet nga vetë Bordi dhe miratohet nga Senati. Një shembull i këtij funksionimi është dhe Bordi i Bankës së Shqipërisë.
- Auditimi financiar vjetor i IAL-ve, në funksion të rritjes së transparencës dhe të përgjegjshmërisë ndaj publikut, propozohet të kryhet nga kompani të mëdha audituese ndërkombëtare.
- Bordi zgjedh administratorin e IAL-së pas një procesi përzgjedhës nga Senati. Ky i fundit krijon një komision që shqyrton përputhshmërinë e kualifikimeve dhe përvojave të kandidatëve me kriteret e vendosura nga Bordi. Senati i propozon Bordit Administrativ një listë të shkurtër me kandidatët e përzgjedhur, mbi bazën e së cilës Bordi organizon intervistat dhe procedurat të lidhura me zgjedhjen dhe emërimin e administratorit.
- Kriteret që duhet të përmbushë administratori hartohen nga Bordi i IAL-së. Kriteret bazë të përzgjedhjes së administratorit janë si më poshtë:
- Formimi akademik: të paktën të ketë diplomën “Master i Shkencave”;

- Përvojë e provuar administrimi (si në sipërmarrje jopublike apo shtetërore), të paktën 3-vjeçare.
- Bordi emëron dhe shkarkon administratorin.
  - Rekomandohet që mandati i anëtarëve të Bordit të ketë kohëzgjatje 1 vit më shumë se mandati i rektorit dhe i senatit, për të garantuar vazhdimësinë institucionale.

**5.4.20.** Detyra kryesore e Bordit Administrativ është sigurimi i mbarëvajtjes dhe i funksionimit sa më të mirë të IAL-së. Anëtarët e Bordit miratojnë strategjinë e zhvillimit të institucionit. Ata:

- janë përgjegjës për garantimin e politikave të stabilitetit/rritjes institucionale, në përputhje me burimet e financimit dhe qëndrueshmërinë financiare afatmesme dhe afatgjatë të IAL-së.
- mbajnë përgjegjësi ligjore për dështimin financiar dhe mospërmbushjen e misionit të IAL-së. Janë përfaqësues të balancuar të interesit publik.

**5.4.21.** Bordi ushtron mbikëqyrje/kontroll të rregullt për zbatimin e misionit dhe të politikës financiare që zbërthehen në plane 1-vjeçare akademike dhe financiare. Është detyra e administratorit të hartojë dhe të paraqesë pranë Bordit Administrativ raportet financiare vjetore. Pas miratimit, këto raporte duhet të bëhen publike. Është detyrë e rektorit t'i paraqesë Bordit Administrativ planet akademike afatmesme dhe afatgjata, të hartuara nga departamentet dhe të miratuara nga Senati.

**5.4.22.** Bordi Administrativ është përgjegjës për organizimin e përzgjedhjes dhe punësimin e administratorëve të të gjitha niveleve dhe personelit administrativ. Ky i fundit është në varësi të administratorit të IAL-së. Të gjitha këto emërimë bëhen me konkurs, të zhvilluar nga komisione “ad-hoc”.

## **Komisionet e Përhershme**

**5.4.23.** Një risi në funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë është futja e Komisioneve të Përhershme me funksione specifike të caktuara. Ndër funksionet kryesore mund të përmendim: promovimin e personelit akademik; çështjet e studentëve; çështjet e etikës së kërkimit shkencor; bursat dhe aplikimin e mundësive të barabarta etj. Çdo komision përbëhet nga jo më shumë se shtatë anëtarë. Anëtarët e komisioneve vetëkandidojnë nga personeli akademik dhe votohen nga Asambleja e Personelit Akademik. Komisionet kanë mandat të kufizuar trevjeçar.

**5.4.24.** Anëtarësimi në këto komisione duhet të shihet si kontribut qytetar (i ashtuquajtur “good

citizenship”) i çdo akademiku, është detyrim në faza të ndryshme të karrierës akademike dhe, si i tillë, është i rëndësishëm për promovimin e personelit akademik. Vlera e shtuar e këtyre komisioneve është se i shpërndajnë detyrimet organizative në të gjithë personelin akademik, duke rritur përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e tyre ndaj institucionit.

## **Punësimi/Rekrutimi i personelit**

**5.4.25.** Sugjerohet të ndalohet punësimi me kohë të plotë në më shumë se një institucion të arsimit të lartë dhe në çfarëdolloj veprimtarie akademike të paautorizuar jashtë institucionit, gjatë kohës normale të punës.

**5.4.26.** Angazhimi i personelit akademik në institucione të tjera të arsimit të lartë duhet të mbështetet me marrëveshje ndër-institucionale dhe të mos lejohet angazhimi me kohë të pjeshme në më shumë se një institucion tjetër njëkohësisht.

**5.4.27.** Çdo IAL duhet të mbulojë të paktën dy të tretat e ngarkesës akademike me personel akademik me kohë të plotë. Përjashtohen rastet e programeve të përbashkëta (midis dy IAL-ve).

**5.4.28.** Pjesëmarrja në projekte, konsulenca, botime dhe shërbime, që realizohet në kuadër të institucionit, nuk duhet të konsiderohet si dypunësim brenda institucionit, por duhet të njihet e të vlerësohet prej këtij të fundit si mjet për zhvillimin institucional. Në rastin e dhënies së kontributit, ai duhet njohur dhe shpërblyer nga institucioni në bazë të punës së bërë, të kontributit personal dhe të cilësisë së rezultatit të arritur nga anëtarë i personelit.

**5.4.29.** Rekrutimi i personelit të ri bëhet sipas nevojës së departamentit në përputhje me standardet. Këto emërimë e kanë pikënisjen te departamenti dhe emërimi bëhet nga një komision “ad hoc”. Si parim, komisioni duhet të përbëhet nga pesë anëtarë: Kryetari i Komisionit të rekrutimit – një profesor i caktuar nga rektori; një profesor jashtë departamentit (i caktuar nga dekani); tre anëtarë nga departamenti, mundësisht njëri profesor (caktohen nga asambleja e departamentit). Përzgjedhja e kandidatit duhet të ndjekë dy faza: një intervistë dhe një paraqitje të punës kërkimore-shkencore pranë departamentit. Ky i fundit i jep komisionit “ad hoc” të rekrutimit gjykimin e tij për paraqitjen e kandidatit. Komisioni sugjeron që shpallja e vendeve të lira në shtyp të jetë detyrim ligjor. Detajet e çdo rekrutimi të ri duhet të shpallen në të paktën një gazetë kombëtare. Procedurat

e rekrutimit duhet të jenë transparente dhe të pasqyrohen në statutet e çdo IAL-je në vend.

**5.4.30.** Për personelin ndihmës akademik (si për shembull, laborantët) ndiqen të njëjtat procedura si për personelin akademik.

**5.4.31.** IAL-ve publike duhet t'u jepet e drejta që për një pjesë të produktit të tyre kërkimor-shkencor të kryejnë veprimtari ekonomike, pra të kenë të drejtë të sigurojnë të ardhura për institucionin e tyre nga puna kërkimore-shkencore e personelit akademik, patentat etj., ose shërbimet që mund të ofrojë institucioni. Në këtë kuadër, çdo IAL mban një përqindje të projekteve (si "overheads" p.sh. 10%) dhe pjesa tjetër i shpërndahet personelit akademik në fjalë, të cilët mund ta marrin këtë shumë si të ardhur të drejtpërdrejtë mbi rrogën.

Për të njëjtat veprimtari, edhe IAL-të jopublike me status sh.p.k. inkurajohen të përafrohen me misionin publik për shërbimet dytësore.

## Organizimi studentor

**5.4.32.** Organizimi studentor duhet të marrë një rëndësi të veçantë për çdo IAL. IAL-ja është përgjegjës për krijimin e kushteve të nevojshme logjistike dhe financiare për organizimin e studentëve.

**5.4.33.** Studentët duhet të përfaqësohen në një numër të caktuar Komisionesh të Përhershme brenda IAL-së që merren me çështjet e tyre të drejtpërdrejta. Sipas natyrës së komisionit, studentët mund të kenë deri në një të tretën e anëtarësisë.

**5.4.34.** Komisioni sugjeron futjen e mbledhjes së përbashkët të personelit akademik dhe të studentëve në nivel departamenti. Në këto mbledhje trajtohen çështjet e studentëve për çdo program. Çdo program përfaqësohet me dy studentë.

**5.4.35.** Rekomandohet që çdo program studimi të zhvillojë në fund të vitit pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies. Ky pyetësor është një tregues i rëndësishëm i cilësisë së mësimdhënies dhe shërben si referencë për matjen e performancës së departamentit.

**5.4.36.** Komisioni, gjithashtu, sugjeron që ASCAL-i të organizojë çdo tre vjet vrojtimin studentor për çdo IAL/Departament, i cili bëhet publik dhe merret parasysh në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies së çdo IAL-je.

## Titujt dhe gradat e personelit akademik

**5.4.37.** Vlerësimi dhe promovimi i personelit akademik duhet të kalojë në kompetencë të plotë të vetë IAL-ve. Për këtë është e domosdoshme të përcaktohen drejt kriteret kombëtare të promovimit të personelit akademik dhe Këshilli i Ministrave ka për detyrë të hartojë, dhe MAS të mbikëqyrë zbatimin e këtyre kriterëve, si dhe të bëjë regjistrimin e titujve dhe të gradave. Senati, me anë të Komisionit të Përhershëm të Promovimit, menaxhon procesin e dhënies së titujve akademikë. Senati përzgjedh nga personeli akademik me titull "Profesor" i IAL-së anëtarët e këtij komisioni që ka mandat dyvjeçar, ndryshe nga komisionet e tjera të përhershme. Në dhënien e titujve, Senati merr përsipër disa nga kompetencat e Këshillit të Profesorëve. MAS ka për detyrë të hartojë dhe menaxhojë regjistrin kombëtar të titujve.

**5.4.38.** Kriteret që duhet të përmbushë një IAL për të pasur të drejtën e dhënies së titujve janë:

- të ketë ushtruar veprimtarinë e tij akademik pa ndërprerje, për jo më pak se 10 vjet nga krijimi;
- të jetë domosdoshmërisht i akredituar nga ASCAL-i;
- të ketë jo më pak se 18 profesorë të punësuar me kohë të plotë;
- të ofrojë programe studimi të doktoratës në fushat e studimit ku mund të japë tituj akademikë.

**5.4.38.** Personeli akademik i punësuar në IAL-të që nuk përmbushin kriteret e mësipërme, i drejtohen një IAL-je tjetër që i plotëson kriteret.

**5.4.39.** Personi që do të promovohet, paraqet kërkesën pranë dekanit, i cili ia kalon dosjen departamentit. Ky i fundit, me mekanizmat e tij vlerësues, vendos mbështetjen apo jo të promovimit. Dosja me vlerësimin e departamentit i përcillet dekanit i cili, pasi ka verifikuar procedurat, ia përcjell senatit. Ky i fundit ia kalon dosjen Komisionit të Përhershëm të Promovimit të Titujve Akademikë. Ky komision, sipas përvojës aktuale, krijon jurinë, e cila merr vendimin profesional dhe ia kalon komisionit. Vendimi i kalohet Senatit për miratim përfundimtar.

**5.4.40.** Së pari, është e rëndësishme të rikonceptohet struktura e titujve akademikë në Shqipëri. Struktura e titujve dhe e kategorive të personelit akademik sot përmban disa hallka të përziera nga sisteme të ndryshme. Komisioni sugjeron thjeshtëzimin e titujve dhe kategorive të personelit akademik.



**5.4.41.** Komisioni sugjeron që sistemi të thjeshtëzohet në tre tituj, Lektor, Profesor i Asociuar dhe Profesor.

- Çdo pedagog mund të punësohet me kontratë të përhershme vetëm si lektor.
- Çdo lektor i punësuar me kontratë të përhershme duhet të ketë fituar gradën “Doktor i Shkencave” përpara punësimit.
- Duhet të hiqet titulli “Docent” për prurjet e reja.
- Promovimi nga “Lektor” në “Profesor i Asociuar” duhet të bëhet pas një periudhe jo më pak se 5-vjeçare dhe sipas rregullave të brendshme të çdo IAL-je. Periudha është e njëjtë edhe për promovimin nga titulli “Profesor i Asociuar” në titullin “Profesor”.
- Kriteret bazë për çdo shkallë promovimi duhet të mbështeten në cilësinë e:
- Punës kërkimore shkencore (të paktën 3 artikuj me faktor impakti për titullin “Prof. As., dhe të paktën 4 për titullin “Profesor”)
- Mësimdhënies (cilësia e mësimdhënies)
- Kontributit institucional

**5.4.42.** IAL-të aplikojnë edhe forma të tjera punësimi si ato të kërkuesit shkencor në disa nivele, asistentlektorit dhe të tjera. Këto pozicione janë me kontrata të përkohshme.

Sugjerime - Struktura e propozuar për institucionet e arsimit të lartë

**5.4.43.** Duke pasur parasysh organizimin ekzistues të IAL-ve në vend, traditën ekzistuese, si dhe përvojat më të mira ndërkombëtare, komisioni sugjeron këta tipa të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri:

I. Universiteti – i strukturuar me të paktën 3 njësi kryesore (3 fakultete ose 2 fakultete dhe 1 institut). Instituti ka të njëjtën strukturë si fakulteti. Në rastin kur IAL-ja ka institut, ky i fundit duhet të ketë

personelin e tij me kohë të plotë. Çdo fakultet duhet të ketë të paktën 3 njësi bazë/departamente (ose 2 departamente dhe 1 qendër kërkimore). Çdo departament/qendër kërkimore duhet të ketë të paktën 7 anëtarë me kohë të plotë, midis të cilëve 3 me grada e tituj. Universiteti ka të drejtë të organizojnë studimet në të tri ciklet e studimit dhe studime profesionale 1- ose 2-vjeçare (studime postsekondare, 60-120 kredite), cikli i parë, diplomë “Bachelor” (të paktën 3 vjet, 180 kredite); cikli i dytë i studimeve, diplomë Master Profesional 1-vjeçar 60 kredite, Master i Shkencave 2-vjeçar 120 kredite dhe Master i Shkencave i Integruar, me kohëzgjatje 5-6-vjeçare dhe 300-360 kredite; cikli i tretë, studimet e doktoratës 3-5-vjeçare, specializime afatgjata me kohëzgjatje të paktën 2-vjeçare dhe të paktën 120 kredite dhe Master Ekzekutiv 1-2 vjeçar, 60-120 kredite.

**II.** Kolegji Universitar – i strukturuar me të paktën 2 fakultete me të njëjtën strukturë. Këto IAL ofrojnë programe studimi në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë, si dhe në formimin profesional.


**III.** Akademia – e strukturuar me 1 fakultet me të njëjtën strukturë si ajo e fakulteteve në përbërje të universiteteve. Këto IAL mund të ofrojnë programe studimi në të tri ciklet e studimit, në fushën përkatëse të kompetencës.

**IV.** Kolegji Profesional – i strukturuar me të paktën dy departamente ofron shkollim profesional 1-2-vjeçar me të drejtën e lëshimit të një Diplome Profesionale.

**5.4.44.** Standardet akademike të IAL-ve janë të njëjta si për ato jopublike edhe ato publike. Sugjerohet që edhe struktura e organizimit të jetë e ngjashme, me përjashtim të rasteve kur këto institucione janë në partneritet me institucione të mirënjohura ndërkombëtare dhe ligji parashikon dispozita të veçanta. Procedurat e emërimit, të menaxhimit dhe të financimit përcaktohen nga vetë institucioni, sipas natyrës së tij.

Figura 5.1. Koncepti i ndarjes dhe i balancës së pushteteve në IAL

## KONCEPTI I NDARJES DHE BALANCËS SË PUSHTETEVE NË IAL



Në analizën e financimit të arsimit të lartë është shumë e rëndësishme të kemi parasysh disa premisa të rëndësishme. Premisa e parë në financimin e arsimit të lartë është që arsimi i lartë është shumë pak i financuar dhe qeveria duhet të shtojë financimin e arsimit të lartë si parakusht i suksesit në këtë drejtim. Premisa e dytë për ndryshimin e sistemit tonë universitar, gjithnjë nën këndvështrimin e mundësive financiare që ka aktualisht ky sistem, është pamundësia e shtetit/buxhetit në periudhën afatmesme për të financuar dhe për të mbështetur arsimin e lartë në nivelet që kërkojnë standardet bashkëkohore të cilësisë. Për rrjedhojë, përveç rritjes së vazhdueshme të financimit shtetëror, duhen gjetur edhe rrugë e mundësi alternative për krijimin e të ardhurave, por duke zbatuar politika sociale.

Aktualisht, buxheti i shtetit ka në dispozicion rreth 38 milionë euro për të mbështetur mbi 126 000 studentë në universitetet shtetërore (kësaj shume mund t'i shtohen afërsisht edhe 20 milionë euro të tjera nga të ardhurat dytësore, të siguruar nga vetë universitetet), pra, afërsisht 460 euro për student në sektorin shtetëror. Sektori privat me rreth 34 500 studentë dhe tarifë shkollimi rreth 1000-1500 euro/student, i shton sistemit rreth 20-25 milionë euro. Ndërkohë që vendet me zhvillim modest të BE-së, si Rumania dhe Bullgaria, kanë kuota financimi rreth 2700-2900 euro/student, pa folur për vende, si Britania e Madhe, Franca etj. që janë në kuotat 10000-11500 euro/student, Zvicra 15700 euro/student, Suedia 15210 euro/student, SHBA-ja 22000 euro/student.

Në Shqipëri, prej vitit 1992, me pak përjashtime, buxheti për arsimin në përgjithësi nuk ka qenë më i lartë se 3% e PBB-së duke u luhatur në intervalet 2.2-2.8% e PBB-së, ose 10-15% të gjithë shpenzimeve të buxhetit. Duhet theksuar se këto shifra i referohen arsimit në përgjithësi (në të gjitha nivelet) dhe jo vetëm atij universitar. Vendet e zhvilluara perëndimore në kuadrin e OECD-së e financojnë arsimin e tyre në nivelet 5 - 8% të PBB-së, nga i cili 1 - 3% e PBB-së shkon drejtpërdrejt për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Shqipëria, aktualisht, shpenzon 0.4 – 0.6% të PBB-së. Kjo shifër duhet të rritet në vitet në vazhdim si premisë e suksesit të vendit në arsimimin e lartë të

popullsisë. Komisioni sugjeron që kjo shifër duhet të paktën të dyfishohet në periudhën afatmesme të zbatimit të reformës.

Premisa e tretë që kërkon reformimin e sistemit arsimor, ka të bëjë me rënien e cilësisë së mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore që, midis të tjerave, ka ardhur si rezultat i një masivizimi të universiteteve, duke ulur në disa raste cilësinë e diplomave. Aktualisht, Shqipëria ka rreth 161 500 studentë, numër ky që (në qoftë se nuk reformohet sistemi) ka prirje të rritet (në 5 vitet e ardhshme ky numër mund të shkojë deri në 175-180 000 studentë), dhe 1350 programe studimi që zhvillohen në 59 IAL të vendit (44 jopublike – megjithëse një pjesë e tyre janë formale - dhe 15 publike). Kjo rritje shkon në kah të kundërt me rritjen e investimit apo të standardit në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor. Pothuajse të gjitha standardet e një mësimdhënieje cilësore, e kërkimit shkencor real e eficient, mjediset e laboratorët, bibliotekat, tekstet mësimore e botimet akademike etj., shfaqin mangësi, kryesisht si pasojë e mungesës së financimeve të domosdoshme.

### 6.1. PROBLEMATIKA

**6.1.1.** Nga gjendja problematike aktuale financiare e institucioneve të arsimit të lartë në vend nxirren tri përfundime:

- i.** Niveli i ulët i financimit të arsimit të lartë në Shqipëri në krahasim me të gjitha vendet e Evropës, përfshi fqinjët tanë të afërt që kanë pasur një fazë të ngjashme tranzicioni;
- ii.** Mundësitë e kufizuara të IAL-ve për të krijuar të ardhura alternative për të mbështetur rritjen e standardeve dhe të cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.
- iii.** Mungesa e një mekanizmi financiar që krijon nxitje të brendshme për rritjen e cilësisë, si dhe rritjen e eficiencës së menaxhimit financiar.

**6.1.2.** Krahas detyrimit të shtetit, për të rritur financimin e arsimit të lartë duke e çuar atë drejt standardeve bashkëkohore, është e rëndësishme gjetja e alternativave mbështetëse për financimin e IAL-ve.

**6.1.3.** Reforma e Arsimit të lartë nuk mund të garantohet pa reformuar vetë sistemin e financimit dhe pa rritur efektivitetin dhe autonominë institucionale. Krijimi i hapësirave dhe i mekanizmave nxitës për rritjen e investimeve paralele me ato të shtetit duhet të vihet në jetë në të njëjtën kohë me rritjen e autonomisë së Institucioneve të Arsimit të Lartë.

**6.1.4.** Komisioni e sheh reformën me dy faza të zhvillimit dhe të realizimit të saj: në zgjidhjet afatmesme dhe ato afatgjata. Zgjidhjet afatmesme janë ato që do të shëndoshin institucionet e arsimit të lartë dhe do të përmirësojnë gjendjen e tyre në drejtim të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, të menaxhimit drejt autonomisë nga shteti, si dhe të rritjes së mundësive financiare. Në zgjidhjet afatgjata është projektuar një model më i mirë i financimit dhe zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri, bazuar në: (i) përvojat më të mira ndërkombëtare; (ii) sigurimin e cilësisë së arsimit të lartë dhe maksimizimin e financimit për IAL-të në vend; (iii) traditën e zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri.

**6.1.5.** Skema e re e financimit (në fazën e parë) do të zgjeronte autonominë financiare në universitet publike, në mënyrë që ato të shëndoshen financiarisht dhe të krijohen kushtet për të hyrë në fazën e dytë zhvillimore.

## **6.2. SUGJERIMET - LLOJET E FINANCIMIT**

**6.2.1.** Mënyra e financimit të arsimit të lartë duhet të kthehet në një instrument, i cili i vendos universitetet në lëvizje për zhvillim të mëtejshëm dhe profilizim të tyre sipas përparësive të përcaktuara nga universiteti, por edhe nga zhvillimi strategjik i vendit.

**6.2.2.** Parimet mbi të cilat duhet të mbështetet financimi i arsimit të lartë nga buxheti i shtetit, janë:

- i.** Konkurrenca e lirë
- ii.** Mundësitë e barabarta
- iii.** Mbështetja e interesave prioritare strategjike të vendit
- iv.** Shpërndarja e fondeve mbi standardet e cilësisë për:
  - mësimdhënien,
  - kërkimin-shkencor
  - inovacionin/zhvillimin.

**6.2.3.** Për të përmbushur detyrimin për një arsim të lartë që të nxisë rritjen e standardit në tri aspektet

kryesore (mësimdhënien, punën kërkimore-shkencore dhe inovacionin/zhvillimin), propozohet që edhe investimi nga buxheti i shtetit në arsim të ndahet në këto tri fusha. Raportet midis përbërësve të financimit përcaktohen sipas përparësive të qeverisë.

**6.2.4.** Granti i Politikave të Zhvillimit të Arsimit të Lartë.

Ky grant është shumë i rëndësishëm për zhvillimin afatgjatë të vendit dhe jepet vetëm për IAL-të publike.

**6.2.4.1.** MAS-i, në bazë të politikave të saj, përcakton përparësitë për këtë grant dhe e shpërndan atë mbi bazën e aplikimit apo të përparësive strategjike të zhvillimit të vendit.

**6.2.4.2.** MAS-i përcakton përparësitë dhe termat e shpërndarjes së këtij granti ("guidelines"). Gjithashtu, MAS-i përcakton edhe mënyrën e shpërndarjes dhe formën e aplikimit.

**6.2.4.3.** Masa e financimit ndryshon mbi bazën e përparësive të çdo qeverie.

**6.2.4.4.** Shpërndarjen e këtij granti e bën Agjencia Kombëtare e Financimit (AKF) mbi bazën e kritereve që përcaktohen nga: a) përparësitë e qeverisë dhe b) kapacitetet zhvillimore të çdo IAL-je.

**6.2.4.5** Ky grant jepet edhe për mbështetjen e logjistikës/infrastrukturës mësimore- shkencore.

**6.2.4.6** Ky grant mbështetet mbi performancën akademike të IAL-ve, e cila merr parasysh cilësinë e mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore. Ajo varet nga madhësia e universiteteve dhe u jepet vetëm institucioneve publike të arsimit të lartë. Në këtë vlerësim është shumë e rëndësishme renditja e IAL-ve, e cila, midis të tjerave, mbështetet në faktorin e impaktit të botimeve, në citimet e bëra për çdo botim, në konferencat ndërkombëtare, si dhe në impaktin e punës shkencore të çdo departamenti në: a) Shkencë dhe b) Shoqëri (politikëbërje).

Kjo bëhet me anë të raportimit të çdo departamenti/IAL-je dhe vlerësimeve të komisioneve përkatëse pranë AKKSH-së.

Shpërndarja e këtij granti bëhet edhe mbi renditjen që realizon AKKSH-ja për departamentet e IAL-ve publike.

### 6.2.5. Granti i Mësimdhënies.

**6.2.5.1.** Ky grant përbën pjesën kryesore të mbështetjes nga shteti për arsimin e lartë dhe mbulon të paktën 60% të financimit shtetëror në arsimin e lartë.

**6.2.5.2.** Ky grant përbëhet nga:

- Fondi institucional
- Fondi i mbështetjes studentore

**6.2.5.2.1.** Fondi institucional. Fondi institucional u jepet IAL-ve publike, i përlogaritur në bazë të numrit të studentëve që ndjekin ciklin e parë të studimeve, drejtimin e programeve studimore, si edhe numrit të personelit akademik. Ky fond garanton funksionim bazë të IAL-ve publike.

Formula që përdoret, merr parasysh numrin e plotë të studentëve të ciklit të parë të pranuar në vitin paraardhës; treguesit e rëndësishëm të raportit student/pedagog; cilësinë e diplomave të lëshuara; logjistikën e vlerësuar të mësimdhënies.

**6.2.5.2.2.** Fondi i mbështetjes studentore. Ky fond është i përbërë nga tre zëra financimi: bursat e studimit për studentët e shkëlqyer, bursat për studentët më të mirë në programet parësore të studimit, si edhe bursat sociale:

- Bursat e studimit për studentët e shkëlqyer u jepen studentëve me rezultatet më të larta në nivel kombëtar, pavarësisht nga programi i studimit dhe IAL-së publike ose jopublike, të përzgjedhur prej tyre.
- Bursat për studentët në programet parësore u jepen studentëve që zgjedhin programet parësore në IAL-të publike. Sipas rastit, bursat mund të përfitohen nga të gjithë studentët e një programi parësor ose nga studentët më të mirë që zgjedhin programin, pavarësisht se në shkallë kombëtare nuk klasifikohen si studentë të shkëlqyer.
- Bursat sociale u jepen të gjithë studentëve që përmbushin kriteret e kategorisë “në nevojë” dhe janë shpallur fitues në IAL-të publike.

### 6.2.6. Granti i Punës Kërkimore-Shkencore.

Ky grant është shumë i rëndësishëm për të nxitur punën kërkimore-shkencore dhe ka munguar deri diku në sistemin e arsimit të lartë në vend.

**6.2.6.1.** Ky grant është i hapur për të gjithë IAL-të në vend. Jepet për punën shkencore (përfshi doktoratat), ku përfitojnë si IAL-të publike edhe ato jopublike.

**6.2.6.2.** Shpërndarja e fondeve bëhet nga AKKSH-ja mbi bazë merite/aplikimi dhe renditjes (“rankim”-i) që u bëhet IAL-ve publike dhe jopublike nga AKKSH-ja.

**6.2.6.3.** Renditja duhet të bëhet një herë në katër vjet. Vlerësimi dhe shpërndarja e fondit bëhet vetëm për institucionet e akredituara.

## 6.3. SUGJERIMET - BURIMET E FINANCIMIT

**6.3.1.** Në këtë këndvështrim, komisioni sugjeron që format e financimit në të ardhmen të diversifikohen, por është e domosdoshme që të rritet ndjeshëm dhe në mënyrë progresive edhe mbështetja financiare nga shteti. Këto forma të përfshijnë:

**6.3.1.1.** Financimin e drejtpërdrejtë nga buxheti i shtetit (në formë granti), siç u përmend edhe më lart.

**6.3.1.2.** Të ardhurat nga veprimtari ekonomike fitimprurëse. IAL-të publike duhet të krijojnë të ardhura nga produktet e tyre akademike dhe infrastrukturore; puna shkencore; patentat; botimet; përdorimi i laboratorëve e të tjera.

**6.3.1.3.** Donacionet e ndryshme. Kjo formë deri më sot nuk njihet në sektorin publik dhe, si e tillë, duhet të rregullohet me ligj për të ardhmen.

**6.3.1.4.** Kontributi i biznesit dhe i autoriteteve lokale. Një nga problemet e arsimit të lartë te ne është dhe lidhja e dobët e tij me tregun e punës. Orientimi në të ardhmen i arsimit të lartë duhet të bëhet drejt tregut të punës. Në këtë këndvështrim, edhe biznesi lokal dhe qeverisja vendore mund të jenë kontribues në financimin e arsimit të lartë rajonal. Në rastin e përfshirjes së sektorit privat në financim ose donacione për arsimin e lartë, sugjerohet të krijohen lehtësi fiskale stimuluese.

**6.3.1.5.** Tarifat e studentëve. Deri tani këto tarifa kanë qenë minimale dhe, si të tilla, nuk përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të të ardhurave të IAL-ve publike. Në të ardhmen, komisioni vlerëson si të pashmangshme rritjen e kontributit të tarifave të nivelit Bachelor në buxhetin e IAL-ve. Shteti për këtë nivel studimi është i detyruar të vendosë një tarifë tavan, bazuar në studimet e detajuara të tregut, mbi bazën e mundësisë së çdo familjeje për të përballuar të ardhurat e arsimit të lartë.

Tarifat e studimeve në IAL-të publike përcaktohen prej tyre. Niveli maksimal i tarifave të studimeve për programet e ciklit të parë caktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Qeveria, gjithashtu, duhet të nxitë mobilizimin e financave nga burime alternative, si nga projektet evropiane të kërkimit dhe të inovacionit dhe bashkëpunimet dypalëshe. Kjo do të rrisë edhe bashkëpunimin ndërkombëtar të institucioneve tona.

Qeveria, gjithashtu, duhet ta shohë si parësore dhënien e shërbimeve dhe konsulencave institucioneve të arsimit të lartë, dhe këto duhet të kenë përparësi në krahasim me organizmat e tjerë në treg.

#### **6.4. SUGJERIMET – FINANCIMI NË FAZËN E PARË (3-5 VJET):**

**6.4.1.** Në këtë fazë, shteti, si financuesi kryesor, synon të mbështesë përparësitë e tij, si dhe të “shëndoshë” sistemin e arsimit të lartë publik për t’u përgatitur për fazën e dytë, zhvillimin afatgjatë të arsimit të lartë.

**6.4.2.** Në këtë fazë kërkohet një ndryshim i rëndësishëm strukturor në mënyrën e organizimit dhe financimit të arsimit të lartë, që duhet të synojë realizimin e disa qëllimeve dhe objektivave thelbësore:

**6.4.2.1.** Arsimi i lartë si shërbim publik dhe e mirë publike është sektor ku shteti/qeveria garanton me politika të posaçme cilësi dhe standarde të larta të ofrimit të tij;

**6.4.2.2.** Arsimi i lartë është i hapur ndaj financimeve të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta, që vijnë nga burime të ndryshme, si: buxheti i shtetit, studentët, pushteti lokal, donacione, biznesi, të ardhura nga shërbime specifike, projekte zhvillimi etj.;

**6.4.2.3.** Autonomia e IAL-ve publike zgjerohet në masë të rëndësishme edhe në çështjet financiare e menaxheriale;

**6.4.2.4.** IAL-të përcaktojnë çmimin e realizimit të studimeve që ato ofrojnë, numrin e pedagogëve, pagat, laboratorët, investimet thelbësore për një shërbim cilësor;

**6.4.2.5.** Shteti përcakton kufijtë minimalë (për të dy sektorët, publik dhe jopublik) dhe maksimalë (vetëm për sektorin publik) të tarifave studentore (mbi bazën e kostove të studimit).

**6.4.3.** Në këtë fazë, IAL-të publike nxiten që të aplikojnë për fonde të tjera si për punën kërkimore-shkencore, ashtu edhe për projekte ndërkombëtare. Gjithashtu, rritet fleksibiliteti dhe

lehtësimi i procedurave për krijimin e të ardhurave nga burime të tjera (puna kërkimore-shkencore e personelit akademik, bashkëpunimi me sektorin privat dhe qeverisjen vendore).

**6.4.4.** Shteti, në kuadrin e politikave dhe objektivave të tij, synon të financojë:

**6.4.4.1.** studentët fitues, të cilët klasifikohen në nevojë (bursat sociale),

**6.4.4.2.** studentët e talentuar (bursat e ekselencës),

**6.4.4.3.** studentët në programet e studimit, që klasifikohen me rëndësi kombëtare dhe prioritare nga qeveria.

**6.4.4.4.** programet e studimit ku mungon kërkesa, por që janë të domosdoshme për ekonominë e vendit, kulturën dhe sportin (në përputhje me strategjitë e zhvillimit të vendit);

**6.4.4.5.** programet studimore specifike dhe parësore.

**6.4.4.6.** në lidhje me ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve universitare, qeveria mund të mbështesë me bursa e financime të plota apo të pjesshme një pjesë të programeve, kryesisht në ato drejtime që korrespondojnë me përparësitë, objektivat strategjikë dhe politikat themelore të zhvillimit të vendit.

**6.4.4.7.** skema e financimit duhet të parashikojë përfshirjen e kredisë studentore si mundësi për mbështetjen e studimeve. Kredia studentore duhet të jetë e hapur për të gjithë ata, të cilët janë regjistruar në të gjitha ciklet e studimit.

**6.4.5.** Skema e re e financimit do të nxitë konkurrencën e brendshme në IAL. Departamentet me performancë më të lartë kërkimore-shkencore, cilësi më të lartë të diplomave marrin më shumë financim në krahasim me departamentet e tjera.

**6.4.6.** Për drejtimet e studimit me natyrë të veçantë përcaktohet mbështetje financiare jo vetëm nga MAS-i, por edhe nga ministritë e tjera të linjës të lidhura me specifikat e këtyre IAL-ve.

#### **6.5. SUGJERIME – FINANCIMI NË FAZËN E DYTË (AFATGJATË):**

**6.5.1.** Në këtë fazë nxitet shndërrimi i IAL-ve drejt një statusi të ri, që garanton autonomi/pavarësi të theksuar institucionale.

**6.5.2.** Në këtë fazë, fondet për mësimdhënie nga buxheti i shtetit jepen vetëm për IAL-të me status të njëjtë. Këtu i referohemi gjykimit që, në këtë fazë, është parë e arsyeshme krijimi i një modeli të ri: IAL PUBLIK I SË ARDHMES, ku mund të futen IAL-të publike, por lihet e hapur rruga që dhe IAL-të jopublike t'i bashkëngjiten këtij grupimi. Që IAL-të të mund t'i bashkëngjiten këtij grupimi duhet të zbatojnë të njëjtat rregulla në funksionimin dhe organizimin e brendshëm të tyre dhe për menaxhimin si ente publike. Në rastet kur një IAL jopublike kërkon të marrë statusin e ri, pronar-i/-ët heqin dorë nga pronësia dhe fitimi, por ruajnë statusin e themeluesit, sikurse ndodh me shtetin, në rastin e shndërrimit të IAL-ve publike nga statusi i sotëm në atë të ri. Gjithashtu, rregullat që zbatohen nga IAL-të me statusin e ri, janë të njëjta, pavarësisht nëse themeluesi i tyre ka qenë shtetëror ose privat.

**6.5.3.** IAL-të jopublike që dëshërojnë të mbeten si të tilla, mund ta ruajnë këtë status edhe në të ardhmen.

**6.5.4.** Në këtë fazë, koncepti bazë apo platforma kryesore për reformën synohet të jetë kalimi në një sistem të arsimit të lartë, i cili sot është i ndarë në dy pjesë: a) sistem shtetëror i financuar pothuajse krejtësisht nga shteti dhe b) sistem privat i financuar 100% nga pagesat e studentëve, drejt një sistemi të ri ku arsimit të lartë konsiderohet si “sektor dhe shërbim publik” dhe financohet në mënyrë të

përbashkët nga shteti/buxheti, studentët, pushteti lokal, biznesi, donacione të ndryshme, të ardhura të tjera nga shërbimet e universiteteve, projekte kombëtare e ndërkombëtare, etj.<sup>5</sup>

**6.5.5.** Edhe në këtë fazë, parimet kryesore të financimit nuk do të ndryshojnë si dhe në fazën e parë:

**6.5.5.1.** Skema e re duhet të parashikojë përfshirjen e skemës së kredive për studentin. Sugjerohet që të gjithë studentëve të regjistruar në sistemin Bachelor, pavarësisht në cilin IAL, duhet t'u jepet e drejta për të aplikuar për kredi studentore.

**6.5.5.2.** Për të zbatuar parimet e “mundësive të barabarta për të gjithë” dhe të “meritokracisë”, vëmendje e veçantë u duhet kushtuar studentëve që vijnë nga situata të vështira ekonomike, në mënyrë që t'u jepet mundësia për të vazhduar arsimin e lartë.

**6.5.5.3.** Vëmendje të veçantë u duhet kushtuar edhe rasteve të ekselencës. IAL-ve, gjithashtu, u duhen dhënë hapësira që të promovojnë dhe të nxitin studentët e tyre më të mirë.


**6.5.6.** IAL-ve (publike të reja) u duhet dhënë mundësia që të marrin kredi për zhvillimin e tyre institucional, duke plotësuar kushte të qarta, transparente dhe me miratimin e ministrive përkatëse.

<sup>5</sup>Përvojat më të spikatura botërore në lidhje me financimin e universiteteve vënë në dukje faktin se:

- financimet nga buxheti i shtetit variojnë rreth 25-55%, nga pushteti lokal 10-15%, nga sektori privat 8-12%, nga institucionet e treta që kërkojnë e përfitojnë shërbime nga universitetet 15-20%, nga të ardhurat nga studentët, vetëm 5-8%.
- financimet që shteti u jep universiteteve publike amerikane përfaqësojnë tashmë vetëm 15-20% të buxhetit të tyre funksional.
- është detyrë e çdo universiteti që të organizohet për të financuar pjesën tjetër.

Figura 6.1. Skema e financimit të arsimit të lartë në fazën e parë

## KONCEPTI I SKEMES SE FINANCIMIT PUBLIK DHE PRIVAT





### 7.1 CILËSIA E MËSIMDHËNIES

Pas vitit 2000, me fillimin e procesit të riorganizimit të programeve të studimit në përputhje me kërkesat e Procesit të Bolonjës, sistemi i vlerësimit të tyre u përshtat me këtë sfidë si në formë, ashtu edhe në përmbajtjen e kurrikulave universitare.

Vitet 2000-2003 shtruan platformën për këtë proces, ndërkohë në vitet në vijim të gjitha kurrikulat e programet iu nënshtruan këtij procesi.

Vlerësimi i programeve të reja të studimit për herë të parë filloi të bëhej mbi bazën e kriterëve të strukturës dhe të përmbajtjes, shoqëruar edhe me organizimin e kurrikulave sipas moduleve e lëndëve me aktivitete formuese të disa niveleve (të përgjithshme, bazë, profesionale dhe me zgjedhje), si dhe me vlerësimin e ngarkesës së studentit me kredite ECTS. Çdo program i ri studimi, i konsideruar si i tillë edhe kur ishte riorganizim i një ekzistuesi, kaloi në këtë proces. Kjo ishte e vërtetë veçanërisht për IAL-të publike, ndërkohë që deri në atë kohë pak programe të IAL-ve jopublike ishin aktive jashtë kuadrit të Bolonjës.

Kështu, të gjitha programet e reja që ofrohen sot, janë në përputhje, të paktën në formë, në strukturë dhe në organizimin e përgjithshëm, me strukturën dhe ciklet e Bolonjës.

Në procesin e vlerësimit paraprak përfshiheshin Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, si dhe Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë. Gjatë këtij procesi ka pasur shpesh mbivendosje të kompetencave institucionale, madje dhe në linjën formale administrative, duke u lënë për vlerësim institucioneve të sigurimit të cilësisë pothuajse vetëm përmbajtjen e programeve. Si pasojë e një ndarjeje jo të qartë të përgjegjësisë midis institucioneve dhe të mungesës së koordinimit midis tyre, procesi i vlerësimit paraprak ka qenë i copëzuar.

Mungesa e kriterëve dhe e standardeve të qarta, lehtësisht të matshme, edhe për fushat kryesore akademike, ka bërë që procesi të rezultojë shpesh i paharmonizuar, madje edhe brenda së njëjtës fushë. Edhe përpjekja për përafrimin e programeve të studimit për formimin e mësuesve rezultoi e

pasuksesshme, për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme të këtyre programeve pas akreditimit, bazuar në lirinë që kanë senatet akademike për ndryshimin e kurrikulave.

Vlen të theksohet se akreditimi nuk është shoqëruar me mbikëqyrje të procesit në vazhdimësi e, për pasojë, programet e studimit, pas akreditimit të tyre, kanë pësuar ndryshime të rëndësishme në përmbajtje, në personelin akademik, në format e mësimdhënies, madje edhe në vetë emërtimin e diplomës. Në këto rrethana, një nga detyrat kryesore të menjëhershme është zhvillimi i një sistemi funksional të vazhdueshëm mbikëqyrjeje për të garantuar respektimin e cilësisë.

Cilësia e mësimdhënies duhet të vendoset në qendër të kësaj reforme. Deri më sot, cilësia e mësimdhënies është vlerësuar vetëm përmes treguesve formalë, që kanë lidhje me disiplinën, me respektimin e orareve mësimore, por pothuajse aspak me cilësinë e njohurive që përcillen te studentit, pra, me procesin e mësimnxënies.

Përmirësimi i sistemit të sigurimit të cilësisë në të ardhmen duhet të përfshijë si vlerësimin e jashtëm, ashtu edhe atë të brendshëm.

Pjesa më e madhe e IAL-ve publike nuk i janë nënshtruar asnjëherë procesit të akreditimit të programeve të studimit, pas licensimit dhe përpara lëshimit të diplomave, duke bërë që shpesh të kemi ndryshime tërësore të kurrikulave të këtyre IAL-ve, si në nivelin e objektivave, kompetencave profesionale, apo edhe të vlefshmërisë reale të diplomave në treg. Mungesa e zbatimit të standardeve të njëjta në vlerësim dhe në akreditim ka sjellë në këtë proces dallime në trajtimin midis IAL-ve publike dhe atyre jopublike.

Ndërkohë që akreditimi i programeve në IAL-të jopublike, me pak përjashtime (në disa, që ofrojnë programe serioze, madje edhe të dyfishta apo të përbashkëta zyrtarisht me IAL-të jashtë vendit), është kryer në mjaft raste jo në mënyrë konsistente dhe koherente, me praktika përzgjedhëse edhe shpesh klienteliste. Problem i madh është jo vetëm akreditimi i programeve, por dhe zbatimi i tyre.

Madje, në këtë proces ka pasur shkelje të procedurave të vlerësimit e të akreditimit, angazhimit të ekspertëve joprofesionalë e pa ndonjë lidhje me fushën, cilësi të dobët të vlerësimit dhe raste të inkohencës midis rezultateve të vlerësimit dhe vendimit të akreditimit. Këtyre u shtohet paqartësia, interpretimi i dyzuar i ligjeve dhe akteve nënligjore, i standardeve vështirësisht të lexueshme dhe të zbatueshme, edhe pse në vitet e fundit në procesin e vlerësimit dhe të akreditimit janë përfshirë edhe ekspertë të huaj.

Për sa i përket akreditimit, vetëm rreth 50% e programeve të studimit të IAL-ve jopublike janë të akredituara. Një pjesë e mirë e tyre janë në proces, për shkak se ende nuk kanë arritur në vitin e fundit të studimeve. Thujse të gjitha kërkesat e paraqitura deri tani për akreditim të programeve nga IAL-të jopublike kanë marrë vendim akreditimi pozitiv, me përjashtim të pak rasteve, kur janë vendosur kushte për akreditim.

## 7.2 CIKLET E STUDIMIT

Meqenëse Shqipëria ka hyrë në Procesin e Bolonjës, strukturimi i kurrikulave të IAL-ve sipas ligjit ekzistues është ndërtuar në tri cikle: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë.

Cikli i parë i studimeve përfundon me diplomën Bachelor (me kohëzgjatje normale 3 vite/180 kredite). Cikli i dytë i studimeve përfundon me diplomë Master i Shkencave (me kohëzgjatje normale 2 vite/120 kredite) ose diplomë Master Profesional (1,5 vite/ 60-90 kredite). Në ciklin e dytë të studimeve futen edhe programet e integruara të ciklit të dytë (me kohëzgjatje normale 5-6 vjet/300-360 kredite). Cikli i tretë i studimeve ku bëjnë pjesë: Doktorata, me kohëzgjatje të paktën 3 vite akademike dhe 180 kredite, nga të cilat 60 kredite janë për studime të organizuara teorike; Specializimet afatgjata, që zgjasin jo më pak se 2 vite akademike dhe 120 kredite. Në fushën e mjekësisë, programet e studimeve të doktoratës mund të ofrohen të integruara me studimet specializuese afatgjata, sipas planit dhe programit mësimor, të miratuar nga IAL-të.

IAL-të kanë të drejtën të ofrojnë programe të studimeve jouniversitare, profesionale, pas arsimit të mesëm me jo më pak se 120 kredite dhe kohëzgjatje jo më pak se 2 vite akademike. Kreditet e grumbulluara mund të transferohen në studimet universitare të ciklit të parë, në përputhje me kriteret e IAL-së.

## 7.3 PROGRAMET E STUDIMIT

Aktualisht, sot në Shqipëri ka 59 IAL, nga të cilat 15 publike dhe 44 jopublike. Në këto institucione ofrohen gjithsej 1560 programe studimi, nga të cilat 725 ofrohen nga IAL-të publike dhe 835 nga ato jopublike. Nga këto, vetëm 13 janë diploma dyvjeçare jouniversitare (9 në IAL-të publike dhe 4 në ato jopublike).

Në ciklin e parë ofrohen 582 nga 1560 programe studimi (nga të cilat 271 në IAL-të publike dhe 311 në IAL-të jopublike); 850 programe në ciklin e dytë (463 në IAL-të publike dhe 387 në IAL-të jopublike) dhe 128 programe në ciklin e tretë (nga të cilat 101 në IAL-të publike dhe 27 në IAL-të jopublike (këto të fundit janë mundësuar vetëm në tri vitet e fundit). Në programet e ciklit të dytë vërehet se programet “Master i Shkencave” mbizotërojnë në numër në krahasim me programet “Master Profesional”, si në sektorin publik ashtu dhe në atë jopublik.

Të ndara sipas fushave, mbizotërojnë programet që ofrojnë studime në fushën e ekonomisë (304). Shpërndarja e programeve në fushat e tjera paraqitet: Mësuesia dhe Shkencat Mjekësore (172 secila), Shkencat Sociale (161), Drejtësia (141), Gjuhësia dhe Matematika-Informatika (93 secila), Inxhinieri-teknologjia (97), Arti dhe Dizajni (65), Shkencat Bujqësore (60), Shkencat Natyrore (43), Arkitekturë-Planifikimi Urban (31), Gjeografia-Gjeologjia (35), Shkencat Humane (40), Shkencat e Komunikimit (30) dhe të tjera, ku përfshihen dhe programet dyvjeçare (23).

Referuar treguesve të arsimit të lartë në Shqipëri për vitin akademik 2012-2013, të dhënat kryesore paraqiten në tabelën 7.3.

**Tabela 7.3.** Tregues të arsimit të lartë në Shqipëri në 2014-ën.

Tregues	Gjithsej	IAL-publike	IAL-jopublike
Numri i IAL-ve	59	15	44
Numri i programeve të studimit	1560	835	725
Nr. Prog. C1	582	271	311
Nr. Prog. C2	850	463	387
Nr. Prog. C3	128	101	27
Nr. i studentëve	174.421	141.295	33.126
Me kohë të plotë	138.935	106.152	32.783
Me kohë të pjesëshme	31.264	30.921	343

Të tjera	4.453	4.356	97
Stafi akademik	10.844	6596	4248
Me kohë të plotë	4781	3143	1638
Me kohë të pjesshme	6063	3453	2610

## 7.4 PROBLEMATIKA

**7.4.1.** Rritja e ndjeshme e numrit të studentëve (po t'u referohemi statistikave zyrtare, numri i pranimeve në programet Bachelor është dyfishuar, nga 16 588 studentë në vitin akademik 2004-2005 në 34 874 në vitin akademik 2011-2012), përgjatë këtyre viteve është shoqëruar me shkelje të standardeve të numrit të studentëve për pedagog dhe raportit student/sipërfaqe në IAL-të publike. Ndërsa në IAL-të jopublike, në shumë raste, nuk ka pasur asnjë lloj pengese si në hyrje, ashtu edhe në dalje. Pra, masivizimi i arsimit të lartë (gjithsej numri i studentëve është rritur nga 63 257 në vitin akademik 2004-2005 në 174 421 në vitin akademik 2012-2013), ndonëse ishte një zhvillim i mirëpritur dhe i nevojshëm, ka çuar në uljen e ndjeshme të cilësisë dhe të vlerave të arsimit të lartë në Shqipëri.

**7.4.2.** Kjo rritje e numrit të studentëve, pa vizion dhe studim të tregut, nevojave dhe mundësive, nuk u mbështet mjaftueshëm nga shteti për përmirësimin e infrastrukturës pritëse të IAL-ve publike, bazës materiale të tyre, si edhe rritjen e kapaciteteve njerëzore. Tashmë shtrohet domosdoshmëria që të bëhet një verifikim i kushteve të licencimit, përfshirë kushtet e punësimit në të gjitha IAL-të publike dhe jopublike.

**7.4.3.** Në IAL janë pranuar mjaft studentë me mesatare shumë të ulët. Ky zgjerim pa kritere është karakterizuar nga një kërkesë shumë e ulët ndaj cilësisë, si edhe nga një kulturë minimale e dëshirës dhe e motivimit për të mësuar, që ka ndikuar në rënien e nivelit si të mësimdhënies, ashtu edhe në atë të vlerësimit.

**7.4.4.** Lëshimi i diplomave 3-vjeçare "Bachelor" nuk pati efektin e duhur për t'i drejtuar të diplomuarit drejt tregut të punës dhe për të shërbyer si një valvul që shkarkon arsimin e lartë nga ata studentë, të cilët nuk plotësojnë kushtet për të vazhduar studimet e ciklit të dytë.

**7.4.5.** Negativisht ka ndikuar edhe mungesa e një kornize kombëtare punësimi me përcaktimet për profesionet dhe fushat ku mund të punojnë të diplomuarit e ciklit të parë të studimeve. Në këto rrethana, trysnia e të diplomuarve të ciklit të

parë për të vazhduar shkollimin, edhe kur nuk e meritonin, ka qenë shumë e madh. Nga ana tjetër, edhe IAL-të, ose nuk ishin konsekuente në zbatimin e kriterëve të vendosura për pranimin në ciklin e dytë (kryesisht ato publike), ose nuk zbatuan kritere përzgjedhëse pranimi (kryesisht ato jopublike).

**7.4.6.** Rritja progresive e numrit të studentëve në programet Bachelor, politikat shtetërore që të gjithë ata që mbarojnë studimet e ciklit të parë duhet të vazhdojnë pa kritere studimet e ciklit të dytë, bëri që jo vetëm të rritej në mënyrë artificiale numri i studentëve në ciklin e dytë, jashtë mundësive që ofronte infrastruktura dhe kapaciteti i Institucioneve të Arsimit të Lartë, por dhe të binte mundësia për zhvillimin dhe përfshirjen e punës kërkimore shkencore në studimet e ciklit të dytë.

**7.4.7.** Një tjetër aspekt i rëndësishëm është sistemi me kohë të pjesshme. Ky sistem, ligjërisht, u jep studentëve të njëjtën diplomë me sistemin me kohë të plotë, pa asnjë dallim në standardet e përdorura në procesin e vlerësimit dhe të akreditimit. Studentët mund të hyjnë në të lehtësisht pa kritere përzgjedhëse, pa iu nënshtruar sistemit të maturës shtetërore, pa kuota të studiuara në raport me nevojat e tregut dhe të vendit. Mësimi zhvillohet vetëm në 2 ditë në javë nga 5 ditë në të cilat shtrihet po i njëjti program studimesh për sistemin me kohë të plotë. Pjesa më e madhe e këtyre studentëve, pasi diplomohen në ciklin e parë me kohë të pjesshme, i drejtohen ciklit të dytë të studimit me kohë të plotë. Në vitin 2004-2005, numri i studentëve me kohë të pjesshme ka qenë 19 616, në vitin akademik 2011-2012, të diplomuarit e sistemit me kohë të pjesshme përfaqësonin 1/10 e numrit të përgjithshëm të studentëve, ndërsa këtë vit, 2013-2014, numri i tyre është pothuajse sa 1/6 e numrit të përgjithshëm të studentëve (31 264 studentë/174 121 studentë).

**7.4.8.** Kurrikulat nuk u janë përshtatur me shpejtësi ndryshimeve socialekonomike dhe zhvillimeve të tregut. Për pasojë, ato nuk kanë qenë gjithmonë të suksesshme. IAL-të, duke mos ndjekur një politikë të zhvillimit kurrikular të orientuar nga tregu, kanë përsëritur në pjesën më të madhe njëra-tjetrën, duke ndikuar në një rritje të panevojshme të konkurrencës në tregun e punës, midis të diplomuarve të së njëjtës fushë. Për ta konkretizuar vetëm në 4 fusha të studimit (biznes-menaxhim, drejtësi, mësuesi, infermieri), në IAL-të publike ofrohen 354 nga 835 programe studimi gjithsej, ndërsa IAL-të jopublike përfaqësojnë 435 programe studimi ndër 725 programe studimi gjithsej.

**7.4.9.** Mungesa e një politike të zhvillimit të kurrikulave me synimin për t'i orientuar të rinjtë sa më mirë drejt tregut të punës ka bërë që struktura e kurrikulave në IAL-të publike të mbizotërohet nga ato të shkencave humane (479), përkundrajt atyre të shkencave teknike dhe të zbatuara (333). Ky raport është edhe më i thellë midis këtyre drejtimeve në IAL-të jopublike (497/228).

**7.4.10.** Rritja e numrit të pranimeve ka prekur edhe ciklin e tretë të studimeve. Numri i doktorantëve të regjistruar në një vit akademik është rritur me shpejtësi të madhe në këto vitet e fundit, rreth 2.6 herë në vitin akademik 2011-2012, krahasuar me vitin 2009-2010. Kryerja e studimeve të doktoratës u pa si një mundësi karriere në sektorin publik të punësimit dhe jo si një karrierë akademike në punën kërkimore-shkencore.

**7.4.11.** Në kushtet e mungesës së infrastrukturës kërkimore, rritja e madhe dhe e menjëhershme e numrit të doktorantëve, e pashoqëruar me zhvillimin e infrastrukturës kërkimore të nevojshme, ka ndikuar negativisht në cilësinë e doktoratave, duke bërë që një pjesë e madhe e tyre të jenë më shumë teorike.

**7.4.12.** Punësimi i shumëfishtë i stafit akademik të IAL-ve publike dhe i atyre jopublike, të cilat shpesh kishin mungesë të kapaciteteve për ngritjen e kurrikulave dhe zhvillimin e tyre, shpërndau përkushtimin, vëmendjen dhe kohën për zhvillimin e punës shkencore, duke ulur cilësinë dhe duke i shndërruar IAL-të, në mjaft raste, në shkolla teorike ku zhvillohet mësim, ndërsa koha për kërkim shkencor, fatkeqësisht, është e kufizuar.

**7.4.13.** Transferimet në vite të ndërmjetme nga universitetet jopublike në ato publike kanë shmangur zbatimin e mekanizmit meritë-preferencë të Maturës Shtetërore, duke krijuar një rrugë alternative për të përfituar hyrje të pamerituar në programe të caktuara studimi pranë IAL-ve publike.

**7.4.14.** Baza materiale dhe infrastruktura kërkimore mbeten një nga pikat e dobëta të IAL-ve publike. U bë kohë shumë e gjatë që universitetet publike nuk marrin mbështetje për bazën materiale mësimore-shkencore nga ana e shtetit. Ndërkohë, edhe procedurat e blerjes së mjeteve bazë të punës dhe të bazës materiale për zhvillimin e mësimin dhe të kërkimit, janë shumë burokratike, të zgjata, të vështira dhe, në përgjithësi, kjo situatë ka ndikuar drejtpërdrejt në dëmtimin e rëndë të cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Rregullimi i këtij procesi kërkon përmirësimin e legjislacionit

financiar të buxhetit dhe të prokurimeve, për t'i trajtuar IAL-të me një status të veçantë.

## **7.5 SUGJERIME - RISHIKIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

**7.5.1.** Mbështetur mbi Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe atë Sektoriale të Kualifikimeve të përgatitet dhe të publikohet një tablo e qartë e programeve të studimit të ofruara nga të gjitha IAL-të. Kjo do të shërbejë edhe për të nxjerrë përfundime mbi politikën e zhvillimit dhe të financimit të diferencuar të tyre.

**7.5.2.** Numri i studentëve për çdo program studimi dhe IAL të përcaktohet mbi bazën e kapaciteteve akademike e infrastrukture, si edhe të rikonceptimit të ngarkesës së personelit akademik. Është e rëndësishme që në këtë kuadër të zbatohen standardet ndërkombëtare.

**7.5.3.** Për çdo cikël studimi të IAL-ve publike të përcaktohen programet e studimit që do të financohen nga buxheti i shtetit si parësore dhe të domosdoshme për zhvillimin strategjik të vendit, si edhe kufijtë e kuotave përkatëse të studentëve, që do të financohen për këto programe.

**7.5.4.** IAL-të publike, mbi bazën e kapaciteteve akademike dhe infrastrukture, mund të ofrojnë programe të tjera studimi, mbështetur në studimin e tregut të punës dhe në vendosjen e tarifave të shkollimit brenda vlerave dysheme dhe tavan të përcaktuara nga shteti. Nëse për hapjen e këtyre programeve kërkohet financim shtetëror, atëherë këto programe duhet të miratohen, përpos MAS-it, edhe nga Agjencia Kombëtare e Financimit.

**7.5.5.** Ofertës formuese të ciklit të tretë të studimeve i shtohet Masteri i Ciklit të Tretë (Master Ekzekutiv). Kjo dallon kualifikimin e kryer pas programeve të ciklit të dytë. Ky master ka kohëzgjatje 1 ose 2 vite akademike, me 60 deri 120 kredite ECTS. Hapja e këtij masteri do të përmirësojë ofertën formuese universitare e, në mënyrë të veçantë, atë të ciklit të tretë.

**7.5.6.** Kohëzgjatja e Masterit Profesional është 1 vit akademik dhe organizohet me 60 kredite ECTS, për t'u dalluar qartë nga Masteri i Shkencave.

**7.5.7.** Programet e ciklit të 2të dhe të 3të, me përjashtim të masterave profesionalë dhe ekzekutivë, duhet të kenë përbërës kërkimore-shkencorë dhe të mbështeten me infrastrukturën e nevojshme, si kusht për hapjen e këtyre

programeve. Pjesë integrale e këtyre programeve janë edhe tezat e masterit e të disertacionit sipas fushave përkatëse.

**7.5.8.** Programet e studimit të ciklit të 2të dhe të 3të të financuara nga shteti si parësore për politikat zhvillimore dhe strategjike, duhet të zbatohen dhe të mbikëqyren rreptësisht.

**7.5.9.** Të reformohet sistemi i studimeve “part-time”, duke e orientuar vetëm në formimet profesionale të nivelit diplomë profesionale 1-2 vjeçare, Master profesional dhe Master ekzekutiv. Sistemi “part-time” nënkupton shtrirjen në kohë të procesit të mësimdhënies të sistemit me kohë të plotë, por jo më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes së këtij të fundit, duke garantuar të njëjtën cilësi formimi. Gjithashtu, ai parashikon gjatë kësaj periudhe kohore edhe kryerjen e së njëjtës ngarkesë mësimore, si edhe të sistemit me kohë të plotë.

**7.5.10.** Të futet kodifikimi i programeve në të gjithë sistemin e arsimit të lartë. Për këtë të bëhet grupimi dhe organizimi i programeve të studimit bazuar në kode, që identifikojnë fusha të ngjashme. Kjo shërben për shumë shërbime dhe veprimtari akademike (p.sh., për kalimet në Master pas fitimit të një diplome Bachelor, ose për zgjedhjet e lëndëve dhe degëve të ndryshme, e të tjera). Kalimi mund të bëhet brenda fushës kryesore dhe të jetë i përcaktuar saktësisht në kurrikulën e programin përkatës të Masterit (shkencor, profesional). Në mënyrë të ngjashme mund të veprohet edhe për ciklin e tretë të studimeve.

**7.5.11.** Të krijohet dhe të publikohet e përditësuar baza e të dhënave për temat e mbrojtura në programet e studimit të ciklit të 2të dhe të 3të. Për temat e ciklit të dytë duhet të pasqyrohet edhe një përmbledhje e shkurtër në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian (anglishte, frëngjishte, gjermanishte, spanjishte, italishte). Po ashtu, autoreferati i tezës së doktoratës duhet të jetë i përkthyer në një nga gjuhët e mësipërme.

**7.5.12.** Të hiqet detyrimi ligjor i mbrojtjes vetëm të gjuhës angleze si kusht për fitimin e Diplomës Master i Shkencave. Për fillimin e studimeve të ciklit të dytë në formimin Master i Shkencave me dy cikle ose me cikël të integruar apo për fillimin e studimeve të ciklit të tretë, studentët duhet të kenë mbrojtur, në përputhje me standardet ndërkombëtare, një nga pesë gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian me zgjedhjen e tyre të lirë (anglishte, frëngjishte, gjermanishte, spanjishte,

ose italishte). Standardet ndërkombëtare janë të unifikuara në plan kombëtar dhe përcaktohen nga MAS në bashkëpunim me institucionet zyrtare të vendeve përkatëse.

**7.5.13.** Të hiqet provimi pasuniversitar i gjuhës së huaj, që mbrohet pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të UT-së (sistem, i cili ka lindur në vitet '80, si kusht i mbrojtjes së Doktoratës), por tu jepet IAL-ve mundësia e krijimit të sistemit të certifikimit dhe njohjes së gjuhës së huaj.

**7.5.14.** IAL-të duhet të ruajnë në mënyrë të përhershme dokumentacionin origjinal të procesit mësimor (regjistrin themeltar, listat zyrtare të notave të provimeve, të diplomimit, të diplomave të lëshuara, kopje të diplomave të lëshuara, fotokopje të noterizuar të dëftesës së shkollës së mesme të studentëve, që janë diplomuar).

**7.5.15.** Procesi i akreditimit të programeve duhet të shoqërohet me një sistem mbikëqyrës të vazhdueshëm të veprimtarisë akademike të IAL-ve.

**7.5.16.** IAL-të duhet të nxiten që të krijojnë programe të përbashkëta (joint degrees) dhe të dyfishta (double degrees) me vendet e Bashkimit Evropian dhe më tej, në kuadër të ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë. Në të tilla raste nuk mund të zbatohen standardet akademike të vendosura në Republikën e Shqipërisë, por kërkohet një miratim nga MAS-i.

## **7.6 SUGJERIME - RISHIKIMI I STANDARDEVE**

**7.6.1.** Kurrikulat e programeve të studimit duhet të standardizohen në nivel kombëtar.

**7.6.2.** Programet e së njëjtës emërtesë/profil dhe cikël/nivel studimi duhet të kenë përmbajtje të njëjtë në kredite ECTS, të paktën deri në masën 70%, e domosdoshme kjo për të ruajtur të njëjtin standard formimi në nivel kombëtar.

**7.6.3.** Standardet e cilësisë për programet e studimit në të tri ciklet e studimit duhet të jenë të matshme dhe të kontrollueshme. Duhet forcuar kontrolli i zbatimit të standardeve aktuale të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë.

**7.6.5.** Programet e studimit të ciklit të parë, Bachelor, duhet të përfundojnë si rregull me provime, por, me vendim të departamenteve, grupe studentësh me rezultate të larta (mesatare mbi 8), sipas mundësisë dhe zgjedhjes, mund të përmbyllin

studimet e këtij cikli me temë diplome, që mund të jetë teorike ose eksperimentale (sipas fushës së studimit).

**7.6.6.** Studimet e ciklit të dytë duhet të përmbillen me realizimin e një teze diplome, që mund të jetë teorike apo eksperimentale, në varësi të llojit të programit të studimit. Temës së diplomës i përkasin një numër kreditesh, në varësi të llojit të programit të studimit. Për studimet e ciklit të dytë "Master profesional", përmbyllja e studimeve mund të jetë me tezë teorike, me detyrë kursi ose me projekt. Në programet e studimit "Master i Shkencave", përzgjedhja e temës eksperimentale duhet të jetë e lirë nga studenti, mbështetur në temat e vendosura në dispozicion nga IAL-ja, në përputhje me politikat e saj të kërkimit shkencor.

**7.6.7.** Për doktoratën, në vitin e parë hiqen studimet e organizuara teorike dhe zhvillohen plotësime të formimit teorik dhe metodologjik rast pas rasti, si edhe puna kërkimore e parashikuar në kuadrin e temës. Pas këtij viti bëhet një vlerësim i brendshëm formal përzgjedhës i ecurisë së doktorantit. Doktorata zhvillohet me kohë të plotë, pranë departamentit të paktën për 3 vite. Programi i doktoratës nuk zgjat më shumë se 5 vite. Projekti kërkimor i doktoratës përcaktohet në bashkëpunim midis studentit dhe departamentit (drejtuesit shkencor) në varësi të programit/objektivave të përcaktuara për kërkimin shkencor, si dhe projektet në zhvillim. Studentët e doktoratës aplikojnë për projektet e shpallura nga IAL-të. Për çdo projekt të shpallur përcaktohet dhe drejtuesi shkencor apo drejtuesit shkencorë në varësi të numrit të vendeve në dispozicion për doktorantë. Drejtuesi shkencor nuk mund të udhëheqë më shumë se një numër kufi doktorantësh, në varësi nga titulli i tij akademik. Ata duhet të kenë të paktën titullin Profesor i Asociuar.

**7.6.8.** Praktikat profesionale dhe programet që përgatisin profesionistë në profesione të rregulluara, të parashikohen në përputhje me direktivën e BE-së për profesionet e rregulluara.

**7.6.9.** Të përcaktohen kodet kombëtare të programeve ekzistuese të studimit dhe çdo program i ri që shtohet, merr një kod sipas fushës përkatëse dhe klasifikimeve të njohura ndërkombëtarisht.

**7.6.10.** Të përcaktohen edhe programe të tjera me cikël të integruar 5-vjeçar veç atyre aktuale, për shembull, drejtësia, arkitektura, etj., në përputhje me përvojat më të mira evropiane.

**7.6.11.** Ndryshimet në programet e studimit pas licensimit të tyre duhet t'u bëhen të njohura strukturave kompetente miratuese të MAS-it. Nëse programi ka në përbërjen e tij lëndë me zgjedhje, këto duhet të jenë të miratuara në çastin e miratimit të programit dhe më pas mund të aktivizohen ose jo. Studentët duhet të kenë të drejtë që të zgjedhin me vullnetin e tyre midis lëndëve me zgjedhje, që ofrohen nga lëndët e miratuara për vitin në vazhdim.

**7.6.12.** Në IAL-të publike duhet të përcaktohet numri minimal i studentëve për zhvillimin e një lënde me zgjedhje.

**7.6.13.** Kurrikulat e programeve të studimit duhet të ndërtohen në bazë të parimit të varësisë ndërlëndore.

**7.6.14.** Të përcaktohet një nivel minimal për frekuentimin e detyruar të lëndës sipas zërave, veçanërisht për ciklin e parë.

**7.6.15.** Mangësitë e ndeshura në formimin bazë të studentëve që hyjnë në arsimin e lartë, shtrojnë nevojën e rishikimit të shpejtë të strukturës dhe të përmbajtjes së kurrikulave të Arsimit të Mesëm (AM).

**7.6.16.** Reformimi i sistemit arsimor parauniversitar nga 4 + 4 + 4 në atë 9 + 3 shkurtoi me një vit periudhën e formimit në AM, duke ia kaluar atë arsimit 8-vjeçar. Për pasojë u reduktua me një vit edhe ngarkesa formuese e nxënësve, pikërisht në periudhën e arritjes së pjekurisë së tyre, kur kapaciteti nxënës dhe analitik janë në fazën rritëse.

**7.6.17.** Në këto kushte rekomandojmë plotësimin e strukturës së Arsimit të Mesëm me një vit, duke e rikthyer kohëzgjatjen e tij të paktën në 4 vjet. Arkitektura e re e sistemit parauniversitar mund të strukturohet në 2 variante:

**7.6.17.1.** me kohëzgjatje 12 vjet dhe strukturë 4 + 4 + 4 (sistemi i vjetër, por mjaft i konsoliduar dhe rezultativ, i kishte bërë maturantët shqiptarë konkurrues edhe jashtë Shqipërisë);

**7.6.17.2.** me kohëzgjatje 13 vjet dhe me 2 zgjedhje strukture: 9 + 4 ose 8 + 5. Sigurisht që ky variant është më i miri, pasi krijon më shumë hapësirë për formimin e maturantëve. Ai zbatohet në disa vende evropiane dhe është plotësisht i përligjur për vendin tonë.

**7.6.18.** Çdo IAL duhet të ketë të miratuar Kodin Etik Institucional.

## 7.7. SUGJERIME - RISHIKIMI I AKSESIT NË ARSIMIN E LARTË

7.7.1. Të ndalohet ndjekja e njëkohshme dhe regjistrimi i çdo studenti në më shumë se një program studimi, duke iu referuar të gjitha cikleve dhe sistemeve të studimit, përmes akteve normative dhe sistemit të matrikullimit.

7.7.2. Të vendoset një notë mesatare dysheme, (fillimisht 6. Ky kriter mund të rishikohet me kalimin e kohës gjatë zbatimit të reformës, me qëllim rritjen e këtij pragu brenda 3 viteve pasardhëse, në 7), si kriter kombëtar për hyrjen në testim në programet Bachelor. Ky kriter është shumë i lidhur me reformimin e arsimit të mesëm dhe vlerësimin e ardhshëm të nxënësve në arsimin e mesëm.

7.7.3. IAL-të duhet të bëjnë transparente listën e studentëve të pranuar dhe ta depozitojnë këtë informacion pranë AKAU-t, në afatin e caktuar.

7.7.4. Hyrja në ciklin e tretë të shoqërohet me testin ose dokumentin që vërteton njohjen në nivel universitar të një gjuhe të huaj (një nga 5 gjuhët kryesore të BE-së).

7.7.5. IAL-të mund të vendosin kritere shtesë për pranimet në ciklet e studimit, krahas atyre të vendosura nga MAS-i. Kriteret duhet të shpallen paraprakisht, të paktën një vit përpara datës së testimit, dhe në çastin e publikimit të tyre, të vihen në dijeni edhe strukturat përkatëse të MAS-it.

7.7.6. Për transferimet e studimeve brenda të njëjtit cikël studimi, çdo i interesuar ka të drejtën të transferojë kreditet e përftuara nga programi i mëparshëm i të njëjtit cikël, vetëm nëse shpallet fitues për programin e studimit në fjalë, pas një vlerësimi të kryer nga departamenti përkatës.

7.7.8. Transferimet lejohen vetëm në vitet e ndërmjetme, brenda të njëjtit cikël dhe fushe studimi, të njëjtë ose të përafërt, gjithmonë midis institucioneve të të njëjtit profil, kur kane kritere të përafërta në hyrje. Në përgjithësi, kjo nuk duhet të nxitet.

7.7.9. Modalitetet dhe procedurat e transferimeve brenda IAL-ve përcaktohen nga IAL-ja përkatëse në rregulloret e tyre.

7.7.10. Kohëzgjatja e regjistrimit në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes sipas planit mësimor të atij programi.

7.7.11. Studentët përsëritës në IAL-të publike, për vitet jashtë planit mësimor, të paguajnë për çdo vit shtesë një tarifë të barabartë me 1/2 e tarifës vjetore të studimit.

## 7.8. SUGJERIME- RISHIKIMI I NGARKESËS MËSIMORE

7.8.1. Duhet rishikuar, sipas përvojave ndërkombëtare, norma e punës së pedagogëve për mësimdhënien (në vlerë dhe në strukturë) në favor të krijimit të mundësive për kërkim shkencor, udhëheqje të studentëve në tema diplome apo në ndihmë të studentëve që kanë nevojë.

7.8.2. Në emërtesat e stafit akademik të futen kategoritë:

- i. Personel akademik me orientim mësimor;
- ii. Personel akademik me orientim kërkimor-shkencor;
- iii. Personel akademik me kontratë jo të përhershme, që mund të jetë një nga dy kategoritë e sipërme.

## 7.9. SUGJERIME - RISHIKIMI I PROGRAMEVE TË MËSUESISË

7.9.1. Programet e mësuesisë duhet të organizohen në dy cikle studimi. Cikli i parë (diplomë Bachelor) me 3 vite dhe 180 kredite, i ndjekur nga studimet e ciklit të dytë me 1-2 vite, me 60-120 kredite (Master Profesional; Master i Shkencave).

7.9.2. Mësuesit e arsimit parashkollor dhe të atij fillor duhet të formohen nga studime Bachelor 3-vjeçare me 180 kredite, me kurrikula të ndërtuara për këtë cikël. Pas këtyre studimeve, studentët mund të kalojnë në tregun e punës si mësues ndihmës, pasi kanë marrë të drejtën e ushtrimit të profesionit (pas provimit të licensimit).

7.9.3. Programi i ciklit të dytë të studimeve Master Profesional 1-vjeçar, me 60 kredite, duhet të dallohet në MP që përgatit mësues për arsimin parashkollor, ose në MP për arsimin fillor. Pas fitimit të diplomës së ciklit të dytë, të diplomuarit, sipas titullit përkatës të diplomës, mund të kalojnë në tregun e punës si mësues, pasi kanë marrë të drejtën e ushtrimit të profesionit (pas provimit të licensimit).

7.9.4. Mësuesit e arsimit të mesëm duhet të përgatiten duke ndjekur këtë rrugë:

- i. Diplomim në fushën përkatëse të shkencës (cikli i parë: diplomë Bachelor 3-vjeçare, 180 kredite).

- ii.** Studime të ciklit të dytë, Master i Shkencave 2-vjeçar 120 kredite, i cili përgatit mësues për arsimin e mesëm të ulët dhe atë të lartë. Kurrikulat e programeve të studimit të ciklit të dytë për përgatitjen e mësuesve duhet të ruajnë një ngjashmëri në nivel kombëtar sipas fushës së shkencës përkatëse në masën 80%.
- iii.** Kurrikulat e programeve të ciklit të dytë të studimeve për formimin e mësuesve duhet të kenë përbërës të rëndësishëm të formimit pedagogjik dhe psikologjik, si edhe të formimit praktik pranë institucioneve të arsimit të mesëm.
- iv.** Kjo reformë propozon që viti i praktikës në shkollë, pas diplomimit të studentëve me diplomën e ciklit të dytë, pranë Institucioneve të Arsimit të Mesëm, të bëhet me ½ e rrogës së mësuesit (sikundër ndodh edhe me stazhierët e mjekësisë).
- v.** Formimi i mësuesve duhet të jetë i vazhduar. IAL-të duhet të krijojnë kushte për trajnimin dhe formimin e vazhduar të mësuesve në bashkëpunim me Institucionet e Arsimit të Mesëm.

## **7.10. SUGJERIME - STRUKTURA PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT NË IAL**

**7.10.1.** Programet e studimeve të ciklit të parë zgjasin 3 vite/180 kredite (Bachelor); programet e studimeve të ciklit të dytë zgjasin 1 vit/60 kredite (Master Profesional), 2 vite/120 kredite (Master i Shkencave) ose të integruara 5 ose 6 vite/300 ose 360 kredite (Master i Shkencave) i integruar. Programet e studimeve të ciklit të tretë zgjasin 1 ose 2 vite/60 ose 120 kredite (Master Ekzekutiv), 3-5 vite (programet e doktoratës), ose së paku 2 vite/120 kredite (specializime afatgjata).

**7.10.2.** Në kuadrin e rishikimit të kurrikulave do të vlerësohet me përparësi mundësia e përfshirjes në programet e studimit të IAL-ve, të kurrikulave të shkurtra profesionale, mbështetur në nevojat e zhvillimit social-ekonomik të rajonit, si dhe në përvojën e zhvillimit të arsimit profesional në vend dhe në rajon. Pas Maturës Shtetërore, në kuadrin e kësaj reforme, IAL-të mund të propozojnë cikle të formimit profesional me kohëzgjatje 1 ose 2 vite (60 ose 120 kredite), pas të cilave studentët pajisen me diploma profesionale dhe dalin në tregun e punës.

**7.10.3.** Studentët, që pajisen me diplomë Bachelor të ciklit të parë të studimeve, kanë tri mundësi:

- i.** Të dalin në tregun e punës (për këtë, detyra e IAL-së është që të bashkëpunojnë me strukturat e Ministrisë së Punës për përshkrimin e vendeve të punës së këtyre diplomave).
- ii.** Të ndjekin programet Master Profesional 1-vjeçar me 60 kredite.
- iii.** Të ndjekin programet Master i Shkencave 2-vjeçar me 120 kredite.


**7.10.4.** Studentët, që pajisen me diplomë të ciklit të dytë të studimeve, Master i Shkencave, kanë këto mundësi:

- i.** Të dalin në tregun e punës.
- ii.** Të ndjekin programet Master Ekzekutiv 1 ose 2-vjeçar me 60 ose 120 kredite.
- iii.** Të ndjekin studimet e doktoratës.
- iv.** Të ndjekin specializimet universitare afatgjata sipas profileve.

**7.10.5.** Studentët, që pajisen me diplomë të ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional, dalin drejtpërdrejt në tregun e punës.



Figura 7.1. Struktura e propozuar për organizimin e programeve të studimit në IAL



## KREU 8 KËRKIMI SHKENCOR ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI DHE FINANÇIMI

### 8.1. NIVELI DHE CILËSIA E PUNËS KËRKIMORE -SHKENCORE

Gjendja dhe rezultatet aktuale të kërkimit shkencor lënë për të dëshiruar. Në vitet e fundit nuk janë shënuar zhvillime pozitive në këtë drejtim, me gjithë dëshirën dhe ndërhyrjet e bëra në sistem. Midis të tjerave, një ndër treguesit kryesorë të mungesës së progresit është numri mjaft i ulët i përfshirjes së institucioneve kërkimore shqiptare në programet ndërkombëtare të kërkimit shkencor dhe përfitimi prej tyre, gjë që flet për kapacitete institucionale dhe njerëzore të një niveli jo të kënaqshëm, si edhe për një produkt të pakrahasueshëm në nivel ndërkombëtar.

Në ndryshimet e kryera në vitet e tranzicionit në arsimin e lartë, në mënyrë të njëanshme, i është kushtuar më shumë rëndësi mësimdhënies sesa kërkimit shkencor. Një tregues i kësaj gjendjeje është fakti se janë ngritur me dhjetëra institucione të arsimit të lartë jopublik, që ofrojnë vetëm mësimdhënie, ndërsa ato institucione që punojnë në të dy drejtimet, janë të pakta.

Një tregues tjetër i kësaj gjendjeje jooptimiste të nivelit të kërkimit shkencor është edhe mbingarkesa në mësimdhënie e pedagogëve në IAL, mbi normën e përcaktuar me ligj. Fatkeqësisht, kjo përvojë është përcjellë edhe te brezi i ri, i punësuar rishtazi në këto institucione të arsimit të lartë. Rritja e papërligjur e numrit të kandidatëve të pranuar në studimet e doktoratës nuk duket se ka prodhuar ndonjë zhvillim pozitiv në kërkimin shkencor, pasi, në pjesën më të madhe të rasteve, dëshmon një rendje për fitimin e gradës shkencore “Doktor”, me qëllim punësimi në administratë dhe jo për karrierë akademike.

### 8.2. PROBLEMATIKA

**8.2.1.** Një nga arsytet e nivelit të ulët të punës kërkimore shkencore është mungesa e vëmendjes së duhur, në radhë të parë nga vetë sistemi, për të investuar në infrastrukturën kërkimore.

**8.2.2.** Para pak vitesh u krijua një agjenci shtetërore, AKTI (Agjencia Kombëtare e Teknologjisë dhe Inovacionit), e cila ka për detyrë

ndihmesën dhe financimin e punës kërkimore shkencore, duke marrë funksionet që më parë i mbulonte Drejtorja e Kërkimit Shkencor, në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës. AKTI-ja ka fonde të kufizuara për mbështetjen e kërkimit në nivel kombëtar. Lënia e saj jashtë MASH-it, ndërkohë që riorganizimi i rrjetit të institucioneve të kërkimit shkencor e përqendroi kërkimin shkencor në universitete, ishte lëvizje kontraditore dhe nuk solli rezultatet e pritura. Tregues i moszhvillimit të sistemit të kërkimit shkencor është edhe mungesa e fondacioneve financuese të specializuara në këtë sektor, të cilat i gjejmë në shumë vende më të zhvilluara. Aq më tepër nuk bëhet fjalë të gjenden institucione financimi apo mekanizma të specializuar për shkencë të caktuara.

**8.2.3.** Riorganizimi institucional i kërkimit shkencor, i ndërmarrë në vitet e fundit, bëri që institucionet e këtij sektori, të trashëguara nga periudha para 1990-ës, t'i bashkëngjiten IAL-ve, që kishin statusin e universitetit. Megjithëse lëvizja kishte qëllimin e mirë për të integruar kërkimin shkencor me mësimdhënien, si në shumë vende që prodhojnë standard në këtë fushë, nuk solli ndonjë nxitje të dukshme apo risi në veprimtaritë kërkimore dhe nuk u shoqërua nga ndonjë evoluim cilësor i kërkim-zhvillimit në nivel kombëtar.

**8.2.4.** Kërkimi shkencor merret pak parasysh në procesin e akreditimit institucional të IAL-ve. Ndryshe ndodh në vendet e zhvilluara të Evropës dhe të rajonit, ku preferenca për kryerjen e studimeve apo zhvillimin e karrierës akademike në një institucion të arsimit të lartë përcaktohet, ndër të tjera, edhe nga cilësia e kërkimit shkencor të prodhuar nga personeli akademik. Në Shqipëri, ky kriter përzgjedhjeje nuk ekziston. Mbi të gjitha, niveli shkencor në rang institucioni apo departamenti është, përgjithësisht, i pamatshëm dhe vlerësimi i tij kryhet vetëm për efekte të karrierës individuale akademike.

**8.2.5.** Gjithashtu, llogaridhënia institucionale për punën kërkimore-shkencore është minimale ose në disa raste nuk ekziston.

**8.2.6.** Problematika në nivelin e institucioneve të arsimit të lartë është edhe më e madhe. Së pari,

ka një mungesë të infrastrukturës kërkimore dhe, së dyti, mungojnë mekanizmat e mbështetjes në veprimtarinë kërkimore individuale të pedagogut.

**8.2.7.** Për shkak të mbingarkesës në veprimtarinë pedagogjike, mungon baraspesha midis punës kërkimore-shkencore dhe mësimdhënies. Kjo ka bërë që të mos arrihet kristalizimi i profilit të kërkuesit, krahas atij të mësimdhënësit.

**8.2.8.** Aktualisht, në IAL mungojnë mekanizmat e nxitjes të pedagogut, që ai të kryejë punë kërkimore. Karriera e një pedagogu nuk ndiqet në mënyrë të rreptë dhe kjo bën që veprimtaria kërkimore të mos përbëjë ndonjë nxitje, përveç përparimit të individit në karrierën e tij akademike. Në IAL nuk ekziston portofoli i pedagogut, ku të përfshihet çdo gjë që ai ka bërë për t'u zhvilluar profesionalisht dhe, gjithashtu, nuk ka vlerësim vjetor apo disavjeçar të punës së tij.

**8.2.9.** Ekziston, por nuk zbatohet si duhet, koncepti i vitit sabatik. Një pjesë e madhe e pedagogëve nuk e kanë shfrytëzuar atë dhe, madje, ka prej tyre që nuk janë në dijeni të tij.

**8.2.10.** Produkti kërkimor nuk konceptohet drejt; në shumë raste, ai përligjet me botime tekstesh mësimore, duke mos u përqendruar në punën origjinale dhe eksperimentale për të sjellë diçka të re në shkencë. Rastet e plagjiaturës janë të shpeshta.

**8.2.11.** Niveli i ulët i kërkimit shkencor shprehet edhe te bashkëpunimi i paktë me institucionet e huaja në projekte të përbashkëta kërkimore, si me institucionet perëndimore, ashtu edhe me ato të vendeve fqinjë.

**8.2.12.** Ka një mungesë të veprimtarive të rregullta shkencore, të organizuara nga IAL-të në nivel fakulteti dhe departamenti.

### **8.3. SUGJERIMET - ORGANIZIMI**

**8.3.1.** Në plan kombëtar propozohet organizimi i punës kërkimore-shkencore në një strukturë organizative të re, siç paraqitet në skemën 9.1.

**8.3.2.** Në analogji me organizimin e kërkimit shkencor në mjaft vende të BE-së, institucione të kërkimit shkencor (IKSh) do të jenë:

1. Institucionet e Arsimit të Lartë që zhvillojnë ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve (universitetet, akademitë, kolegjet universitare);
2. Institutet dhe Qendrat Kërkimore

Ndëruniversitare, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit;

3. Institutet dhe Qendrat e Kërkimit të Zbatuar, në varësi të ministrive të tjera.

**8.3.3.** Për të rritur e konsoliduar rolin ekzekutiv të AKTI-së në kërkimin shkencor dhe sidomos në sistemin e arsimit të lartë, propozohet kalimi i saj në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit, me emërtesën Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor (AKKSh), duke ruajtur funksionet e mëparshme, por duke forcuar përbërësin e asistencës për programet ndërkombëtare.

**8.3.4.** AKKSh-ja do të menaxhojë dhe do të bëjë publike një bazë të dhënash për të gjitha projektet e financuara në kuadrin e Programeve Kombëtare të Kërkim-Zhvillimit (PKKZh), në të cilat do të vazhdojnë të kenë akses institucionet publike e jopublike në varësi të misionit të tyre. AKKSh-ja do të vazhdojë të administrojë fondet e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim-zhvillimit, si edhe donacione të mundshme në rrafsh kombëtar apo ndërkombëtar.

**8.3.5.** Për sa i përket rrjetit institucional, konsiderohet i padobishëm rëndimi aktual i strukturës së universiteteve me institucione dhe qendra të kërkimit të zbatuar me rëndësi dhe përgjegjësi kombëtare, të cilat mbulojnë shërbime të rëndësishme për shtetin. Nisur nga ky këndvështrim, sugjerohet transferimi i tyre nga universitetet pranë ministrive, që mbulojnë këto fusha të veprimtarisë institucionale në planin kombëtar. Institutet dhe qendrat do të kenë një strukturë dhe organizim mbështetur në funksionin parësor që ato kanë (shërbim dhe/ose kërkim-zhvillim). Është e rëndësishme të përmendet se këto qendra kanë përgjegjësi institucionale ndaj shtetit për fushat specifike që mbulojnë, si edhe për veprimtaritë dhe produktin që ofrojnë. Ato duhet të financohen nga ministritë përkatëse.

**8.3.6.** Institutet dhe qendrat e kërkimit të zbatuar mund të vazhdojnë bashkëpunimin me IAL-të duke kontribuar në realizimin e programeve të ciklit të dytë dhe të tretë (tezat e doktoratës dhe mikrotezat e masterit shkencor, mësimdhënie për lëndë të specialitetit, praktika mësimore). Personeli i tyre mund të vazhdojë të zhvillojë një ngarkesë të kufizuar mësimore në IAL-të e fushave përkatëse. Këto marrëdhënie do të rregullohen me akte nënligjore apo normative të veçanta.

**8.3.7.** Në analogji me IAL-të jopublike, mund të krijohen, të licensohen dhe të funksionojnë edhe

institucione jopublike të kërkimit shkencor. Hapja, funksionimi dhe akreditimi i tyre rregullohen me akte nënligjore të veçanta, gjithnjë duke respektuar të njëjtat standarde si për institucionet publike.

## 8.4. SUGJERIMET - FUNKSIONIMI

**8.4.1.** Institucionet e Kërkimit Shkencor të pikave 2 dhe 3 (8.3.2) do të funksionojnë të organizuara në departamente dhe do të zhvillojnë misionin e tyre, duke bashkëpunuar me IAL-të sipas hapësirave të nevojshme.

**8.4.2.** Siç u përmend më sipër, një nga problemet e hasura në kërkimin shkencor është dhe raporti mësim/kërkim. Duke iu referuar këtij raporti parashikohen dy tipa personeli akademik:

- tipi i parë, ku përfshihet personeli akademik i departamenteve të IAL-ve të pikës 1, ngarkesa akademike e të cilëve do të jetë një baraspeshim midis mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore, me një peshë specifike më të lartë në mësimdhënie.
- tipi i dytë, ku përfshihet personeli akademik i departamenteve të IAL-ve të pikës 1, por edhe i Qendrave R&D, ngarkesa akademike e të cilëve do të jetë kryesisht kërkimore.

**8.4.3.** Për sa i përket përmirësimit të përmbajtjes së kërkimit shkencor, nevojitet të rishikohen përparësitë kombëtare të zhvillimit, nën optikën e përparësive aktuale të zhvillimit të vendit.

**8.4.4.** Gjithashtu, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet vlerësimit të cilësisë së kërkimit shkencor, mbi bazën e rezultateve të së cilës do të akordohen financimet strukturore dhe ato programore nga Agjencia Kombëtare e Financimit (siç tregohet në kreun 4). Ato do të përdoren edhe si tregues për akreditimin e programeve të IAL-së të ciklit të 2të dhe të 3të.

**8.4.5.** Për përmirësimin e cilësisë së publikimeve dhe të produktit shkencor të financuar nga shteti, do të përdoret sistemi i "peer review" me ekspertë të huaj.

**8.4.6.** Përgatitja e punimeve shkencore në gjuhë të huaj, krahas gjuhës shqipe, do të mundësojë shfrytëzimin e botimeve shkencore edhe nga studiuesit e huaj, duke bërë që ajo të jetë e citueshme, gjë që do të sjellë një vlerësim më objektiv të veprimtarive shkencore të institucioneve dhe kërkuesve të veçantë.

**8.4.7.** Një hap i rëndësishëm do të jetë krijimi dhe përditësimi i vazhdueshëm nga MAS-i, nëpërmjet agjencive apo institucioneve të saj varësisë, i një bazë të dhënash të Kërkimit Shkencor Kombëtar, ku do të përfshihen:

- Të gjitha tezat e doktoratës dhe mikrotezat e masterit të mbrojtura apo që do të mbrohen në vijim. Për shmangien e plagjiaturave, për çdo doktoratë do të publikohet në gjuhë të huaj (në një nga 5 gjuhët kryesore të BE-së të studiuara në Shqipëri: anglishte, frëngjishte, gjermanishte, italishte, spanjishte) titulli dhe një përmbledhje (autoreferat). Sugjerohet që tezat e doktoraturës të bëhen publike përpara mbrojtjes. Po kështu, MAS-i ose strukturat e saj do të publikojnë në një nga gjuhët e huaja të sipërpërmendura, titujt dhe një përmbledhje të mikrotezave të mbrojtura në kuadrin e programeve të ciklit të dytë.
- Kontributi shkencor i të gjithë personelit akademik e kërkimor të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor.
- Vendet aktuale të punës dhe ato të reja në të gjitha institucionet e kërkimit shkencor.

**8.4.8.** Për rritjen e pjesëmarrjes së Institucioneve të Kërkimit Shkencor në programet e BE-së dhe në programe të tjera ndërkombëtare, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet trajnimit të personelit teknik të tyre për hartimin dhe menaxhimin e projekteve. Kjo do të realizohet nëpërmjet forcimit të kapaciteteve teknike të AKKSh-së në këtë drejtim, por edhe të IAL-ve.

**8.4.9.** IAL-të dhe institucionet kërkimore duhet të garantojnë komunikimin e informacionit për projekte dhe fonde kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare tek i gjithë personeli i tyre. Sigurimi i këtij procesi duhet të mbështetet dhe të garantohet edhe nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH) në nivel kombëtar për IAL-të publike, jopublike dhe institucionet kërkimore.

## 8.5. SUGJERIMET - FINANCIMI

**8.5.1.** Financimi i kërkimit shkencor nga shteti do të jetë strukturor dhe programor.

**8.5.2.** Për IAL-të publike të pikës 1 (universitetet, akademitë, kolegjet universitare) financimi strukturor do të jetë nga një grant i veçantë, që do të jepet nga Agjencia Kombëtare për Financim për kërkimin shkencor, i cili do të shpërndahet në nivel departamenti dhe pastaj në nivel pedagogu.

8.5.3. Në shpërndarjen e tij në nivel institucioni të arsimit të lartë do të mbahen parasysh një sërë treguesish, si:

- cilësia e produktit shkencor të prodhuar e të publikuar nga departamentet e këtyre institucioneve në një periudhë të caktuar (sugjerohet 3 deri në 4-vjeçare në kushtet aktuale), duke marrë parasysh edhe numrin e personelit akademik. Këto botime janë baza e renditjes institucionale të këtyre IAL-ve;
- tipologjia e fushës së kërkimit shkencor ku vepron departamenti. Për fakultete/institute/qendra dhe departamente të shkencave teknike, mjekësore, bujqësore e natyrore, masa e financimit strukturor do të jetë më e madhe sesa e atyre që veprojnë në fushën e shkencave humane;
- projektet kërkimore ndërkombëtare e kombëtare ku merr pjesë departamenti apo pedagogu.

8.5.4. Ky financim do të menaxhohet në mënyrë transparente nga vetë departamenti. Ndarja e këtij financimi brenda departamentit midis grupeve kërkimore apo individëve do të bëhet me vendim të Asamblesë së Personelit të Departamentit, duke u

mbështetur mbi parimin e meritokracisë, në varësi të cilësisë dhe të vëllimit të kërkimit që ata kryejnë, pra, nuk do të shpërndahet në mënyrë të barabartë për të gjithë anëtarët e departamentit pa dallim.


8.5.5. Një financim i veçantë strukturor do të jepet nga AKF-ja për institutet dhe qendrat ndëruniversitare, ndërsa financimi i institucioneve të kërkimit të zbatuar do të bëhet nga ministritë përkatëse.

8.5.6. Financimi programor do të jetë 2 llojesh:

- i pari, për Programet Kombëtare të Kërkim-Zhvillimit, i ofruar nga AKKSh-ja dhe që do të jetë i hapur për të gjitha institucionet publike e jopublike të kërkimit shkencor;
- i dyti, për programet e kërkimit universitar, i ofruar nga AKF-ja për IAL-të publike dhe jopublike që zhvillojnë kërkim shkencor (kategoritë e përfshira në pikën 1).

8.5.7. Këto financime do të jepen gjithmonë mbi bazë aplikimesh dhe do të jenë të pavarura.

Figura 8.1. Organizimi strukturor institucional i kërkimit shkencor.



## KREU 9

# IAL ME STATUS TË VEÇANTË, ME PROGRAME STUDIMI ME NATYRË TË VEÇANTË DHE ME PËRPARËSI KOMBËTARE

### 9.1. PËRSHKRIMI

9.1.1. Ky grup i IAL-ve ndahet në tri nëngrupe që janë:

9.1.1.1. IAL me status të veçantë në bazë të specifikave të pranimit të studentëve, specifikave të procesit të mësimdhënies, punës kërkimore, financimit apo edhe vetë organizimit, si: UART, UMT, UST, Akademia Ushtarake, Akademia e Policisë, etj.

9.1.1.2. IAL që kanë programe studimi me natyrë të veçantë që zhvillohen brenda vetë IAL-së dhe që kanë specifika të ndryshme nga programet e tjera, si: Veterinaria në UBT, Arkitektura në UPT, sporti në Universitetin e Elbasanit dhe në Universitetin e Shkodrës.

9.1.1.3. IAL me programe studimi me përparësi kombëtare, bazuar në politikat shtetërore për përgatitjen e specialiteteve të ndryshme, si: në fushën e bujqësisë, të mësuesisë, të gjeologji-minierave, të mjedisit, të energjisë etj.

9.1.4. Këto IAL, pavarësisht nga specifikat e fushës së tyre të studimeve, funksionojnë brenda sistemit universitar. Ato janë kryesisht IAL publike dhe funksionojnë sipas Ligjit të Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë.

9.1.5. Organet drejtuese e kolegjinale në këto IAL i nënshtrohen procesit të zgjedhjeve si në të gjitha IAL-të.

9.1.6. Struktura e organizimit të procesit mësimor realizohet sipas Procesit të Bolonjës.

9.1.7. Kuotat e pranimit të studentëve në këto IAL ose programe studimi përcaktohen nga MAS-i. Pranimi i studentëve realizohet në dy mënyra. Mënyra e parë është pranimi i studentëve me konkurs. Ky model pranimi është ndërthurja e rezultateve akademike të shkollës së mesme me rezultatet e arritura në konkursin për fushën specifike të studimit. Mënyra e dytë është pranimi thjesht në bazë të rezultateve të maturës shtetërore, sipas preferencave të zgjedhura nga vetë aplikantët.

9.1.8. Procesi i mësimdhënies në disa nga këto IAL realizohet në kushte specifike. Ky proces kushtëzohet nga natyra e veçantë, ku mësimdhënia mund të zhvillohet edhe në formë individuale ose me grupe prej disa studentësh.

9.1.9. Financimi i këtij grupi të IAL-ve publike bazohet te skema e financimit që është e njëjtë për të gjitha universitetet publike në Shqipëri. Financimi i tyre realizohet nga granti i pakushtëzuar që financohet nga MAS-i.

9.1.10. Në këtë kapitull jepen vetëm dispozitat e përgjithshme për këto IAL. Specifikat e tyre janë detajuar në ANEKSIN I të këtij raporti.

### 9.2. SUGJERIME PËR IAL ME STATUS TË VEÇANTË - ORGANIZIMI

9.2.1 Veprimtaria mësimore e shkencore e i IAL-ve me status të veçantë është dhe duhet të mbetet në varësinë e MAS-it, institucion që ka të gjitha mekanizmat e kontrollit të cilësisë dhe që është përgjegjës për arsimin e lartë në Shqipëri.

9.2.2. Komisioni sugjeron që statusi që përfaqësojnë këto institucione në arsimin e lartë shqiptar, të mbetet i njëjtë me atë që ato kanë në stadin aktual.

9.2.3. Për disa IAL me status të veçantë, si UMT apo UART, që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me ministritë përkatëse, sugjerohet që NJË nga anëtarët e Bordit të Administrimit ta ketë nga këto ministri dhe jo nga Ministria e Arsimit dhe e Sporteve.

9.2.4. Disa IAL me status të veçantë, si UMT, ofrojnë, nga pikëpamja organizative dhe strukturore, një specifikë të rëndësishme, për shkak të lidhjes së domosdoshme organike me veprimtarinë e QSUT-së. Elementet kyçe që i japin UMT-së këtë status specifik, janë shërbimet dhe njësitë përbërëse të departamenteve, të cilat e realizojnë veprimtarinë e tyre praktike në universitet dhe në QSUT. Drejtimi i këtyre shërbimeve është i një rëndësie shumë të madhe dhe përzgjedhja e drejtueseve duhet të pasqyrojë këtë specifikë në krahasim me universitetet e tjera jo të veçanta.

### 9.3. SUGJERIME PËR IAL-TË ME STATUS TË VEÇANTË – PRANIMI I STUDENTËVE

9.3.1. Pranimi i studentëve në IAL-të me status të veçantë duhet të konsiderohet investim kombëtar me ndikim në jetën e shoqërisë shqiptare dhe, si i tillë, pavarësisht nga zhvillimet e tregut të punës, programet e studimit në programet e IAL-ve me status të veçantë duhet të kenë vazhdimësi.

9.3.2. Pranimi i studentëve në IAL-të me status të veçantë duhet të realizohet me konkurs sipas specifikave të fushës.

9.3.3. Nota mesatare për pranimin e studentëve në disa IAL me status të veçantë mund të jetë e ndryshme nga nota mesatare që mund të vihet si kriter për të fituar të drejtën e aplikimit për të ndjekur studimet në programet e tjera.

9.3.4. AKAU duhet të peshojë çdo element të procedurës së konkursit të pranimit në disa IAL me status të veçantë. Pesha e çdo elementi të konkurrimit në këto IAL duhet të propozohet nga vetë IAL-të me status të veçantë, sepse janë më të specializuara për ta bërë këtë.

9.3.5. Përcaktimi i kuotave të studentëve fitues duhet të jetë kompetencë e vetë IAL-së me status të veçantë.

### 9.4. SUGJERIME PËR IAL-TË ME STATUS TË VEÇANTË – MËSIMDHËNIA

9.4.1. IAL-të me status të veçantë duhet të kenë të drejtë që të rregullojnë vetë procesin e mësimdhënies. Ato duhet të kenë të drejtë që të rregullojnë veprimtarinë e departamenteve në lidhje me përcaktimin e numrit të stafit, ngarkesën mësimore të stafit, llogaritjen e normës mësimore, rekrutimin e stafit, kontrollimin e praktikave profesionale, punën kërkimore e shkencore, hartimin e programeve të studimit, programet lëndore, analizën e mësimdhënies etj.

9.4.2. Format e organizimit të procesit të mësimdhënies në IAL-të me status të veçantë të përcaktohen nga specifikat që shpreh secili profil brenda IAL-së në procesin e realizimit të mësimdhënies me studentët.

### 9.5. SUGJERIME PËR IAL-TË ME STATUS TË VEÇANTË – KËRKIMI SHKENCOR/VEPRIMTARITË PROFESIONALE

9.5.2. Të hartohen instrumente që do të bëjnë të mundur që veprimtaritë specifike profesionale që zhvillohen nga stafi akademik i IAL-së me status të veçantë, të konvertohen në parametra mbi kërkimin shkencor.

9.5.3. Veprimtaritë profesionale apo krijimet artistike që realizohen nga personeli akademik i IAL-ve me status të veçantë të konvertohen në prodhimtari shkencore dhe të shërbejnë për të vlerësuar performancën e tyre në këto fusha.

### 9.6. SUGJERIME PËR IAL-TË ME STATUS TË VEÇANTË – FINANCIMI

9.6.1. IAL-të me status të veçantë duhet të kenë të drejtë të bëjnë një shpërndarje më fleksibël të fondeve në dispozicion. Departamentet duhet të kenë mekanizmat që të jenë hallka kryesore për planifikimin, administrimin dhe vënien në jetë të buxhetit financiar.

9.6.2. IAL-të me status të veçantë kanë një numër të vogël studentësh dhe kosto të lartë të përgatitjes për student, prandaj për këtë duhet të vendosin tarifa të diferencuara mbi pagesat e shkollimit të studentëve.

9.6.3. Tarifat e shkollimit të studentëve në IAL-të me status të veçantë, duke qenë më të larta se tarifat në degë të tjera, të rimbursohen pjesërisht edhe nga shteti për të ulur barrën ekonomike të studentëve.

9.6.4. Financimi i IAL-ve me status të veçantë duhet të marrë parasysh numrin e vogët të studentëve në këto institucione, si dhe koston e lartë për student. Për këtë arsye, koeficientët e financimit për student për IAL-të me status të veçantë duhet të jenë më të larta se koeficientët për student në degë të tjera.

9.6.5. IAL-të me status të veçantë duhet të përfitojnë edhe nga granti për mbulimin e shpenzimeve që duhen për sigurimin dhe rinovimin e bazës materiale dhe teknologjike në ndihmë të mësimdhënies e kërkimit shkencor. Ky grant financimi mund të planifikohet nga granti për zhvillim.

**9.6.6.** Komisioni sugjeron një financim të dyfishtë buxhetor për IAL-të me status të veçantë, si nga MAS-i, edhe nga ministritë përkatëse. Kjo bëhet me marrëveshje midis vetë IAL-së dhe ministrisë përkatëse.

**9.6.7.** Hartimi i një pakete ligjore për të rregulluar administrimin e të ardhurave nga vetë IAL-të për një “produkt tregtar” që mund të krijojë IAL-të me status të veçantë.

## **9.7. IAL-TË DHE ZHVILLIMI RAJONAL**

**9.7.1** IAL-ve, të cilat kanë programe studimi që orientojnë drejt zhvillimit rajonal, u krijohet mundësia të përdorin fonde specifike që jepen nga qeveria në këtë sferë. Këto IAL inkurajohen që, përtej profilit të tyre të përgjithshëm, të zhvillojnë edhe oferta akademike të lidhura me zhvillimin ekonomik-social të rajonit.

**9.7.2** Shteti duhet ta shohë me përparësi zhvillimin universitar rajonal, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm kombëtar. Shteti financon ato degë që i konsideron strategjike për zhvillimin rajonal dhe kombëtar.

**9.7.3** IAL-të, pavarësisht nga vendndodhja e tyre, kanë krijuar traditë në programe studimi, të cilat jo detyrimisht janë të lidhura me zhvillimin rajonal, por që jo vetëm duhen ruajtur, por edhe duhen zhvilluar.



### 10.1 RËNDËSIA E VËNIES NË JETË

**10.1.1** Çështja më e rëndësishme e çdo reforme është vënia në jetë e saj. Në kushtet e një reforme të thellë, kjo çështje merr një rëndësi edhe më të veçantë. Të gjitha reformat e thella kanë një element që i dallon: atë të zbatimit të rreptë të vendimeve, apo ligjeve që dalin prej tyre.

**10.1.2.** Sugjerohet që mbikëqyrja e zbatimit të Reformës në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, i propozuar nga ky Komision, duhet të jetë, si edhe hartimi i tij, i pavarur dhe rigoroz.

**10.1.3.** Detajet e vënies në jetë të reformës për arsimin e lartë në Shqipëri do të paraqiten në një dokument të tretë, të prodhuar nga komisioni – Raporti i Detajuar i Zbatimit të Reformës.

### 10.2. FAZAT E VËNIES NË JETË

**10.2.1.** Faza hartuese e dokumentit strategjik dhe ligjit  
Kjo reformë që nisi në janar të 2014, ka kaluar tashmë fazën përgatitore, atë të hartimit të dokumentit strategjik për parimet dhe drejtimit kryesore të reformës.

**10.2.1.2.** Pas hartimit të Raportit të Parë (Green Paper) nga komisioni, raporti u diskutua me grupet e interesit dhe me faktorët e arsimit të lartë në Shqipëri. Kjo është faza e parë, ajo e hartimit të raportit (Shiko figurën 10.1). Propozimet e marra, pasi u analizuan, u përfshinë në këtë Raport Përfundimtar (White Paper), që është edhe dokumenti kryesor për realizimin e politikës dhe të hartimit të Ligjit për Arsimin e Lartë në Shqipëri.

**10.2.1.3.** Kjo fazë ndiqet nga ndryshimet ligjore përkatëse dhe kalon në strukturat ekzekutive dhe legjislativë që parashikon ligji.

**10.2.1.4.** Me miratimin e ligjit, mbyllet faza e hartimit dhe fillon faza tjetër, ajo e zbatimit afatmesëm të Reformës në Arsimin e Lartë në Shqipëri. Kjo fazë do të zgjasë së paku tre vjet. Në fillim të kësaj faze, komisioni përfundon edhe të ashtuquajturin Raport të Detajuar të Zbatimit të Reformës, që i vlen çdo

IAL-je në vend, si edhe vetë MAS-it për hapat e duhur gjatë zbatimit të reformës.

**10.2.2.** Faza e parë afatmesme. Kjo fazë ndahet të paktën në tri vite dhe ka si qëllim vënien në jetë të ligjit të arsimit të lartë dhe përgatitjen e IAL-ve për krijimin e sistemit të njësuar të arsimit të lartë në Shqipëri.

**10.2.2.1.** Viti i parë i kësaj faze (2014-2015) është ai i përgatitor për IAL-të në vend për transformimin e tyre në strukturat pe reja – përgatitja për ndryshim. Në këtë vit duhet të realizohen:

- riorganizimi i IAL-ve sipas parimeve të reformës
- riorganizimi strukturor i arsimit të lartë shqiptar (agjensitë kombëtare pranë MAS-it dhe Qeverisë)
- krijimi i sistemit të aplikimit të studentëve hyrës në IAL sipas parimeve të reformës (Krijimi i AKAU-t)
- mbikëqyrja e ndryshimeve organizative brenda IAL-ve
- mbikëqyrja e ndryshimeve në nivel makro: qeveria dhe institucionet e reja
- shpërndarja e informacionit për studentët, prindërit, mësuesit e shkollave të mesme dhe pedagogët
- krijimi i mekanizmave të kontrollit, brenda IAL-ve dhe jashtë tyre
- shpjegimi i ndryshimeve ligjore
- përgatitja e akteve nënligjore
- trajnimi i stafit drejtues të çdo IAL-je për ndryshim, si dhe të vetë agjencive kombëtare
- krijimi i një komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të reformës.

**10.2.2.2.** Viti i dytë i kësaj faze (2015-2016) - Viti i vënies në jetë përqendrohet në zbatimin dhe mbikëqyrjen e ndryshimeve. Gjatë kësaj faze duhet të kryhen:

- krijimi i një organi të asistencës për ndryshime në IAL (pranë ministrisë) për të dhënë ndihmë dhe asistencë teknike
- zbatimi i skemës së re të financimit të arsimit të lartë
- zbatimi i reformës për kërkimin shkencor
- renditja e IAL-ve (dhe çdo departamenti) në vend mbi bazën e punës shkencore të çdo pedagogu

- ringritja e sistemeve të brendshme të mbikëqyrjes dhe të vlerësimit të cilësisë
- anëtarësimi i plotë i ASKAL-it në ENQAR.

**10.2.2.3.** Viti i fundit i kësaj faze është (2016-2017) - Viti i vlerësimit. Gjatë kësaj periudhe ëshë shumë e rëndësishme mbikëqyrja e çdo ndryshimi dhe tjetërsimi institucional. Në këtë fazë kryhen:

- krijimi i treguesve të matjes së cilësisë dhe vënies në jetë
- mbikëqyrja e këtyre treguesve
- përgatitja dhe emërtimi i raporteve të brendshme për vlerësimin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor
- përgatitja për akreditim e hapësirës shqiptare të arsimit të lartë
- akreditimi i IAL-ve në hapësirën shqiptare të arsimit të lartë.

**10.2.3.** Faza e dytë afatgjatë – Faza e standardizimit të hapësirës shqiptare të arsimit të lartë dhe të integritit në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

**10.2.3.1.** Gjatë vitit të parë të kësaj faze (2017-2018) - Viti i ridimensionimit të arsimit të lartë do të kryhen:

- një analizë e hollësishme mbi shëndetin financiar, organizativ dhe administrativ të IAL-ve në fazën e parë. Në këtë fazë kemi një ridimensionim të arsimit të lartë në Shqipëri. IAL-të përgatiten të ndryshojnë statusin, në qoftë se janë gati

- përgatitja e ndryshimeve ligjore. Duhet të jenë gati ndryshimet ligjore që nevojiten për këtë ndryshim statusi
- krijimi i mekanizmave të përhershëm të mbikëqyrjes së cilësisë dhe të standardeve
- ridimensionimi i IAL-ve në përputhje me rezultatet e akreditimit dhe kornizën ligjore në fuqi
- analiza dhe vlerësimi i efektivitetit të reformës nga komisioni teknik i reformës
- propozimi për masat korrektuese, përmirësuese dhe plotësuese.

**10.2.3.2.** Viti i dytë i kësaj faze - Viti i njësimt të hapësirës shqiptare të arsimit të lartë (2018-2019). Gjatë këtij viti do të kryhen:


- zbatimi i masave të propozuara nga Komisioni Teknik i Reformës
- njësimi i sistemit të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë
- njësimi i hapësirës shqipfolëse të arsimit të lartë, në qoftë se janë krijuar kushtet e domosdoshme.

**10.2.3.3.** Kjo është dhe faza e fundit e reformës, 2019-2022 – Faza e integritit të arsimit të lartë shqiptar në hapësirat evropiane. Gjatë kësaj faze do të kryhet:

- identifikimi i diferencave të mbetura ndërmjet hapësirës shqiptare dhe asaj evropiane të arsimit të lartë
- hartimi dhe zbatimi i masave korrektuese për eliminimin e diferencave
- integrimi në hapësirën evropiane

Figura 10.1. Fazat e zbatimit të Reformës së Arsimit të Lartë

## FAZAT E ZBATIMIT TE REFORMES SE ARSIMIT TE LARTE



## KREU 11

### E ardhmja e sistemit të arsimit të lartë të standardizuar në Shqipëri

**11.1.** Arsimi i lartë në Shqipëri është shërbim publik dhe, si i tillë, shteti duhet t'i kushtojë vëmendje të posaçme, të rrisë ndjeshëm kontributin e tij financiar dhe të ofrojë lehtësi të tjera të karakterit ligjor dhe fiskal, për të mundësuar që IAL-të të arrijnë objektivat afatgjatë të reformimit.

**11.2.** Mbështetur në përvojat më të mira ndërkombëtare, ndërsa përqasja e shtetit në arsimin e lartë të ndryshojë, njëherazi duhet të ndryshojë edhe autonomia e plotë institucionale e IAL-ve në Shqipëri. Kjo autonomi nuk mund të arrihet plotësisht, në qoftë se nuk do të ketë edhe ndryshim në statutet e IAL-ve publike, ku të garantohet me ligj kjo autonomi.

**11.3.** Institucionet publike të arsimit të lartë nuk kanë autonominë kushtetuese, neni 57/7, që duhej të ishte garantuar sipas legjislacionit aktual në fuqi. Ky nen nuk garanton zhdërvjelltësi, mekanizma efektivë të administrimit të suksesshëm dhe nuk është motivues për të ofruar një arsim cilësor në kushtet aktuale të zhvillimit të shoqërisë. Nga ana tjetër, edhe arsimi i lartë jopublik nuk solli pritshmëri lidhur me përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë, edhe pse ndikoi në rritjen e numrit të studentëve në Shqipëri. Ky nen nuk garanton autonominë e IAL-ve në katër aspektet e rëndësishme të autonomisë: autonomia organizative, autonomia financiare, autonomia e personelit dhe ajo akademike.

**11.4.** Në të njëjtën kohë, bazuar në përvojat më të mira ndërkombëtare, por edhe në përvojat më të mira vendëse, organizimi i IAL-ve të tipit fondacion është i preferuar, për shkak se ato kanë zhdërvjelltësi dhe liri organizimi e përdorimi efektiv të fondeve dhe se ofrojnë shërbim publik pa qëllim fitimi. Por, nga ana tjetër, institucionet e arsimit të lartë nuk mund të kthehen të gjitha në fondacione, bazuar në ligjin dhe Kushtetutën e RSH-së.

**11.5.** Një tjetër arsye për të ndryshuar statusin afatgjatë të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri është edhe fakti se fuqia blerëse e familjeve shqiptare nuk është e tillë për të përballuar një sistem të fortë jopublik, ku të ketë tarifa konkurruese, që të garantojnë një nga parimet kryesore, atë të konkurrencës së barabartë.

**11.6.** Një tjetër argument për të shkuar drejt njehsimit të stutuseve të arsimit të lartë në Shqipëri, është edhe fakti që tregu në Shqipëri është i vogël dhe, si i tillë, parimi i konkurrencës së mirëfilltë nuk mund të zbatohet duke pasur një numër të madh të institucioneve me stutuse të ndryshme. Mekanizmat rregullues të institucioneve me stutuse të ndryshme, bëhen shumë të ndërlikuar (siç tregoi edhe përvoja 15-vjeçare në Shqipëri) dhe kështu krijojnë mundësinë për abuzime në sistem.

**11.7.** Bazuar në sa përmendëm më lart, komisioni vlerëson që, në fazën afatgjatë të zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri, IAL-të të lëvizin drejt “qendrës”, pra, drejt një statusi të ri të të qenit IAL I SË ARDHMES, një organizatë jofitimprurëse, por që edhe mund të krijojë veprimtari ekonomike fitimprurëse për produktet akademike që prodhon dhe që duhet t'i përdorë në funksion të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Në këtë lloj organizimi garantohet autonomia e plotë e IAL-ve në vend.

**11.8.** Kjo nuk do të thotë se nuk duhet apo nuk do të ekzistojnë institucione me status tjetër në sistem, me status publik dhe jopublik, fitimprurës dhe jofitimprurës. Edhe në vende si Britania e Madhe, ku zbatohet ky sistem, nuk ndalohej krijimi apo edhe funksionimi i IAL-ve me status tjetër nga ai i lartpërmendur. Kjo për shkak të lejimit të larmisë dhe zgjerimit të tregut për arsimin dhe kërkim shkencor.

**11.9.** Komisioni sugjeron tiparet e mëposhtme të zhvillimit afatgjatë universitar në Shqipëri:

1. Autonomi: a) e plotë akademike b) financiare e audituar c) organizative dhe d) personeli
2. Një status të ndryshëm kushtetues ku garantohet autonomia
3. Një organizim të qartë institucional të pavarur dhe efektiv, ku ndarja midis anës akademike dhe asaj financiare të jetë e qartë.
4. Një mundësi për trajtim jodiskriminues financiar, bazuar mbi parime të njëjta
5. Garantimin e një cilësie dhe standardi në mësimdhënie dhe kërkim shkencor konkurrues me ato të vendeve të zhvilluara evropiane
6. Transformimin e orientimit të tyre për të realizuar

më shumë kërkim shkencor, krahas rritjes së nivelit dhe cilësisë së mësimdhënies

**7.** Forcimin dhe garantimin e financimit të tyre për të përballuar sfidat e një zhvillimi afatgjatë dhe strategjik të arsimit të lartë konkurrues në Shqipëri.

Kjo do të bëhet duke rritur financimin shtetëror, por duke diversifikuar edhe financimin e çdo IAL-je

**8.** Zvogëlimin e barrierave burokratike të funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë, për të rritur eficiencën dhe funksionimin në përmbushje të misioneve të tyre.

**9.** Krijimin e një hapësire rajonale, mbarëkombëtare të institucioneve të arsimit të lartë, të afta që të tërheqin studentë dhe veprimtari kërkimore-shkencore me interes për rajonin, duke ndikuar në tregun universitar rajonal.

**10.** Institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri duhet të ofrojnë mësimdhënie jo vetëm në gjuhën shqipe, por të paktën edhe në atë angleze, me qëllim hapjen e programeve të studimit me interes për studiues dhe kërkues nga vendet e tjera të zhvilluara, si dhe për të krijuar mundësi reale për bashkëpunim institucional dhe partneritet me simotrat evropiane e më gjerë.

**11.10.** Ndërsa në fazën e parë afatmesme të zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri është menduar të përqendrohemi drejt përmirësimit të

cilësisë së arsimit të lartë, në fazën e dytë afatgjatë duhet të kemi mundësi për zgjedhje më efektive të statuseve të IAL-ve me orientim vetadministrim dhe autonominë e tyre.

**11.11.** Sot arsimit të lartë është publik dhe jopublik, ku ky i fundit ka karakter fitimprurës dhe jo fitimprurës. Komisioni vlerëson se në terma afatgjatë, duke lejuar njëkohësisht larminë dhe zgjedhjen e institucioneve të arsimit të lartë, të shkohet drejt strukturave universitare efektive dhe konkurruese. Në vlerësimin e komisionit, organizimi si fondacione apo struktura të ngjashme që lejojnë zhërvjellësi në orientimin drejt zhvillimit, si për institucionet publike ashtu edhe për ato jopublike, është e ardhmja që do konsolidojë suksesin e reformimit afatgjatë të sistemit arsimor.

**11.12.** Për këtë kërkohen ndryshime të mëtejshme ligjore dhe, pa dyshim, edhe ndryshime në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të paktën për sa i përket përcaktimit të tyre si institucione publike dhe jopublike, si dhe ndryshimit të statusit nga institucione autonome në institucione të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre. Në arsimin e lartë nuk duhet të mbizotërojë koncepti i institucionit publik, por ai i shërbimit publik.

### A.1.1. UNIVERSITETI I ARTEVE (UART)

**A.1.1.1.** Universiteti i Arteve është universitet publik me karakter akademik, artistik dhe shkencor. UART funksionon përmes Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. UART funksionon mbi bazën e tri fakulteteve: Fakulteti i Arteve të Bukura; Fakulteti i Artit Skenik dhe Fakulteti i Muzikës.

**A.1.1.2.** Forma e studimit në UART është me kohë të plotë. Pranimi i studentëve në UART realizohet me konkurs. Kuotat e pranimit caktohen nga MAS-i. Modeli i përzgjedhjes së studentëve është një ndërthurje e rezultateve akademike të shkollës së mesme me rezultatet e arritura në konkursin në një fushë specifike të artit.

**A.1.1.3.** Procesi i mësimdhënies realizohet në kushte specifike. Ai kushtëzohet nga natyra e punës mësimore në shkollën e artit, ku mësimdhënia realizohet kryesisht në formë individuale ose me grupe prej 3 – 4 studentësh.

**A.1.1.4.** Veprimtaria shkencore e UART-së bazohet në kërkimin artistik për hulumtimin e problemeve teorike e praktike në fushat e artit dhe në kontributin për realizimin e veprimtarive artistike e krijuese brenda e jashtë vendit.

**A.1.1.5.** Financimi i UART-së bazohet tek e njëjta skemë, me të cilën funksionojnë IAL-të publike në Shqipëri.

#### Sugjerime – Specifike

**A.1.1.6.** Pranimi i studentëve në UART duhet të realizohet me konkurs përpara një jurie profesionistësh të fushës.

**A.1.1.7.** Pranimi i studentëve në UART duhet t'i nënshtrohet uljes së barrierës së notës mesatare.

**A.1.1.8.** Procedura e realizimit të konkursit të pranimit të studentëve dhe i numrit të studentëve fitues në UART duhet të jetë kompetencë e vetë IAL-së.

**A.1.1.9.** Departamentet e ndryshme të UART-së, duke marrë parasysh specifikat që shpreh procesi i mësimdhënies në fushat e tyre të studimit, të përcaktojnë vetë raportin pedagog/student.

**A.1.1.10.** Financimi nga shteti i UART-së me grante për mësimdhënien e kërkimin shkencor duhet të marrë parasysh numrin e vogël të studentëve në këtë institucion. Koeficientët e përdorur për shpërndarjen e granteve, për studentët e UART-së duhet të jenë më të mëdha se koeficientët për IAL-të e tjera.

**A.1.1.11.** Financimi i UART-së me grant për mbulimin e shpenzimeve për sigurimin e logjistikës dhe teknologjisë në shërbim të procesit mësimor dhe krijues, duhet të ofrohet prej grantit të zhvillimit nga MAS-i, por dhe prej Ministrisë së Kulturës.

**A.1.1.12.** UART duhet të lejohet të vendosë tarifa të diferencuara mbi pagesat e shkollimit të studentëve, të ndryshme nga tarifat e tjera të shkollimit të studentëve në IAL-të publike shqiptare.

**A.1.1.13.** UART-së, duke vendosur tarifa të diferencuara për shkollimin e studentëve, t'i krijohet mundësia që shteti të rimbursojë pjesërisht tarifat e shkollimit të studentëve.

### A.1.2. UNIVERSITETI I SPORTEVE (UST)

**A.1.2.1.** Universiteti i Sporteve është IAL publik me karakter akademik, sportiv dhe shkencor. UST ka tri njësi themelore: Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, Fakulteti i Veprimtarive Fizike dhe Rekreacionit dhe Institutin e Kërkimeve Shkencore të Sportit, i krijuar mbi bazën e Qendrës Kërkimore Shkencore të Sportit.

**A.1.2.2.** UST ka ndërmarrë një proces të thellë ristrukturimi e riformatimi të drejtuar dhe të koordinuar nga konsorciumi kryesor i Rrjetit EU të Universiteteve të Sportit, ku përfshihen: Universiteti i Sportit Romë, Universiteti i Vjenës, Universiteti i Danimarkës së Jugut, Odense e të tjera.

**A.1.2.3.** Universiteti i Sportit, si institucion unik i fushës së veprimtarisë fizike dhe sportit, ofron programe studimi për të tri ciklet, në kuadër të

dy fakulteteve. Diplomat janë të orientuara sipas kërkesave të tregut dhe standardeve të Rrjetit Evropian të Universiteteve të Sportit.

**A.1.2.4.** Pranimi i studentëve në UST realizohet me anë të testeve sportive, që përbëjnë 50% të pikëve dhe pjesa tjetër (50%) është nota mesatare. Për programe të ndryshme aplikohen teste të ndryshme. Në ciklin e dytë të studimeve pranohen vetëm studentët që kanë rezultate 80% e lart.

**A.1.2.5.** Kërkimi i zbatuar është zhvilluar në fushën e shkencave sportive dhe së fundmi janë ngritur tre laboratorë të rinj në funksion të kërkimit dhe mësimdhënies.

### **Sugjerime – Specifike**

**A.1.2.6.** UST sugjeron që programet e studimit të fushës së edukimit fizik dhe të sportit që zhvillohen nga IAL-të e tjera në vendin tone, të përqendrohen në prodhimin e diplomave të integruara në fushat e edukimit, si p.sh: mësues i edukimit fizik dhe historisë, gjeografisë, edukimit shëndetësor etj.

**A.1.2.7.** Pranimi i studentëve në UST duhet të realizohet me konkurs përpara specialistëve të fushës.

**A.1.2.8.** Nota mesatare e aplikimit për të studiuar në UST duhet të jetë më e ulët se në IAL-të e tjera dhe të marrë parasysh edhe arritjet sportive të kandidatëve.

**A.1.2.9** Procedura e realizimit të konkursit të pranimit të studentëve dhe numrit të atyre fitues të jetë kompetencë e vetë IAL-së.

**A.1.2.10.** Duke marrë parasysh specifikat që shpreh procesi i mësimdhënies në fushat e sportit, departamentet duhet të kenë përgjegjësinë për të përcaktuar raportin pedagog/student në procesin e mësimdhënies.

**A.1.2.11.** Financimi nga shteti në formën e grantit duhet të marrë parasysh numrin e vogël të studentëve në këtë institucion. Granti për mësimdhënien e kërkimit shkencor duhet të mbulojë edhe shpenzimet për sigurimin e logjistikës dhe teknikës didaktike në shërbim të procesit mësimor në këtë institucion.

**A.1.3.** Universiteti i Mjekësisë

**A.1.3.1** Universiteti i Mjekësisë Tiranë është universitet publik me karakter akademik, mjekësor

dhe shkencor. UMT funksionon përmes Ligjit të Arsimit të Lartë, statutit dhe rregullores së UMT-së.

**A.1.3.2.** UMT ka në përbërjen e vet 5 fakultete: Fakulteti i Mjekësisë (FM), Fakulteti i Mjekësisë Dentare (FMD), Fakulteti i Farmacisë (FF), Fakulteti i Shëndetit Publik dhe (FSHP), Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Teknike (FSHMT).

Në Universitetin e Mjekësisë ndjekin studimet rreth 10.000 studentë. Kuotat e pranimit të studentëve caktohen nga MAS-i.

**A.1.3.3.** Format e studimit në këto fakultete janë si më poshtë:

- Fakulteti i Mjekësisë Dentare dhe Fakulteti i Farmacisë - studime të integruara të nivelit të dytë DND dhe me kohë të plotë.
- Fakulteti i Shëndetit Publik është i organizuar sipas sistemit të Bolonjës, Bachelor dhe Master profesional dhe shkencor, me kohë të plotë.
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Teknike është i organizuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme; studime të nivelit të parë sipas sistemit të Bolonjës, Master profesional dhe shkencor. Gjithashtu ka dhe sistem filiali në Sarandë dhe në Kukës.

**A.1.3.4.** Financimi i UMT-së për pagat dhe sigurimet bëhet nga buxheti i shtetit, ndërsa investimet dhe shpenzimet mbulojnë nga të ardhurat dhe tarifat e shkollimit, skemë me të cilën funksionojnë të gjitha universitetet publike në Shqipëri. UMT nuk ka asnjë trajtim të veçantë financiar si rrjedhojë e specifikave që ka.

### **Sugjerime – Specifike**

**A.1.3.5.** Konkursi i Pranimit. Specifika e punës së mjekut me njerëzit dhe me teknologjinë e bën të domosdoshme, si në të gjithë botën, një sistem konkursi me pyetje specifike në interesin e tyre për mjekësinë, si dhe me një intervistë me gojë, pse jo dhe pamore. Natyrisht, ponderimi në pike i këtij konkursi do të përcaktohet nga UMT-ja dhe do të jetë një përqindje e ponderuar e vlerës së pikëve të marra nga matura shtetërore.

**A.1.3.6.** Procesi i mësimdhënies. Në një pjesë të mirë të UMT-së (p.sh. në FM, FMD etj.) ai realizohet në kushte specifike; në universitet, por sidomos në QSUT, në shtratin e të sëmurit, në kabinetet mjekësore, në sallat e operacioneve, në ISHP, në laboratorët e specializuar të qendrave të rëndësishme në vend etj. Normalisht, kjo formë mësimdhënieje duhet të garantojë që studenti,

me të mbaruar studimet universitare, të jetë në gjendje të diagnostikojë dhe të mjekojë pacientin në mënyrë të pavarur. Aktualisht, kjo nuk ndodh për këto arsye: për shkak të mënyrës se si zhvillohet mësimdhënia; për shkak të mungesës së praktikës së mjaftueshme të studentit në shërbimet përkatëse, si dhe për shkak të mospërfshirjes së tij në punën kërkimore - shkencore. 86 | P a g e

**A.1.3.7.** Për këtë arsye, ne sugjerojmë që departamentet, në rast nevojë, mund të aktivizojnë në këtë proces mësimdhënieje edhe klinikistët e Qendrës Spitalore, nëpërmjet detyrimesh kontraktuale, që të përfshihen në procesin mësimor, kryesisht në atë praktik me të sëmuret. Natyrisht që kjo duhet të realizohet sipas disa kriterëve të përcaktuara nga departamenti përkatës, si: nota mesatare, doktoratura apo kompetencat individuale. Ky proces do të kushtëzojë që të gjithë mjekët që do të punësohen në QSUT si ordinatorë, t'u nënshtrohen kriterëve të ngjashme si për një pedagog.

Për më tepër, këtij procesi do t'i shërbejë edhe legalizimi i vullnetarizmit të studentëve të shkëlqyer të dy viteve të fundit në klinikat universitare, i cili ndihmon në identifikimin e elementit potencial për konkurset si pedagog apo ordinator.

**A.1.3.8.** Mbarimi i studimeve universitare nuk përkthehet në të drejtë licensimi të mjekut të ri. Në këto kushte, deri në marrjen e një license përfundimtare që vjen pas një stazhi 2-vjeçar, sugjerojmë dhënien e licensave të përkohshme me afat të kufizuar kohor.

**A.1.3.9.** Veprimtaria shkencore e UMT-së duhet të jetë pjesë integrale e jetës shkencore të klinikave universitare, gjë që do ta bënte studentin tonë të mjekësisë, si kudo në botë, pjesë integrale të studimeve të mirëfillta shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Me përfundimin e studimeve universitare, përvoja e studentit të mjekësisë në lidhje me kërkimin shkencor është e tillë që nuk i lejon të japë një gjykim shkencor mbi një artikull për botim. Kjo është shumë e rëndësishme për ta bërë mjekun tonë të ardhshëm pjesë të debatit shkencor të komunitetit mjekësor kombëtar e ndërkombëtar. Performanca e pedagogut duhet matur edhe në lidhje me përfshirjen e studentit në kërkimin shkencor.

**A.1.3.10.** Nga pikëpamja organizative dhe strukturore, edhe pse në përgjithësi është në harmoni të plotë me IAL-të e tjera të vendit, UMT, në nivel departamenti ofron një specifikë

të rëndësishme, për shkak të lidhjes së domosdoshme organike me veprimtarinë e QSUT-së dhe me Ministrinë e Shëndetësisë, e cila kushtëzon një autonomi me të madhe organizative. Pikërisht në këtë nivel profilizohet statusi specifik i UMT-së. Departamentet dhe sidomos shërbimet, njësitë përbërëse të departamenteve, veprimtarinë e tyre mësimore e realizojnë pjesërisht në universitet dhe kryesisht në QSUT dhe ISHP. Këto njësi janë praktikisht bërthama shumë të rëndësishme, jo vetëm akademike dhe shkencore, por edhe të punës me të sëmuret.

**A.1.3.11.** Sugjerojmë që përzgjedhja e shefave të departamentit të bëhet me votim të të gjithë personelit me kohë të plotë të departamentit, duke respektuar gjithmonë nivelet me të larta akademike, mësimdhënëse dhe profesionale.

Sugjerojmë që kriteret e hyrjes në konkurrim të shefave të departamenteve të jenë sipas renditjes së mëposhme: titulli më i lartë; vjetërsia e titullit; vjetërsia pedagogjike (të paktën 15-vjeçare si pedagog i brendshëm); përvojë e suksesshme në drejtim të njërive arsimore dhe klinike mjekësore; botime jashtë dhe brenda vendit; aftësi organizative; organizim i veprimtarive shkencore; pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare; mosha, e cila një të zgjedhuri të ri duhet t'i lejojë të mbyllë mandatin 4-vjeçar.

**A.1.3.12.** Përzgjedhja e shefave të shërbimeve universitare bëhet me konkurrim me dosje personale të kandidatit.

Kriteret për zgjedhjen e shefave të shërbimit të renditura sipas rëndësisë sugjerohet të jenë: Titulli më i lartë shkencor; përvoja klinike prej të paktën 15 vjetëve në njësinë spitalore universitare; vjetërsia pedagogjike (të paktën 15 vjet si pedagog i brendshëm); botimet jashtë dhe brenda vendit; aftësitë organizative; organizimi i veprimtarive shkencore; pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare; mosha, e cila një të zgjedhuri të ri duhet t'i lejojë të mbyllë mandatin 4-vjeçar. Një shef shërbimi ka të drejtë të konkurrojë edhe për shef departamenti.

Përzgjedhja fillestare e dosjeve (jo më shumë se dy dosje) bëhet mbi kriteret e lartpërmendura nga një komision 'ad-hoc' prej pesë profesorësh të emëruar nga Senati i Universitetit. Përzgjedhja përfundimtare e kandidaturës më të mirë (nga dy kandidatët e sugjeruar nga komisioni) bëhet nga Bordi i QSUT-së. Në vendimin e bordit merret parasysh edhe mendimi i Shefit të Departamentit.



#### A.1.4. AKADEmia USHTARAKE

**A.1.4.1.** Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) është institucioni më i lartë i Arsimit Ushtarak. Aktualisht përbëhet nga Fakulteti i Arsimit të Përgjithshëm (FAP), i cili përgjigjet për organizimin dhe zhvillimin e programeve të studimit të ciklit të parë “Bachelor”, si dhe nga Fakulteti i Sigurisë dhe i Mbrojtjes (FSM), që zhvillon programe studimi për ciklin e dytë dhe të tretë.

**A.1.4.2.** Kandidatët që përzgjidhen në akademitë ushtarake vijnë kryesisht nga arsimiti i mesëm pas disa testeve specifike, karakteristike për natyrën e arsimit ushtarak. Gjithashtu, afrohen edhe kandidatë nga universitetet e tjera, nëpërmjet transferimit të krediteve. Numri i kandidatëve që përzgjidhen për të vazhduar këtë program studimi, varet nga politikat e arsimitit dhe nevojat e Forcave të Armatosura.

**A.1.4.3.** AFA realizon programe studimi “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, në fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes. Këto programe janë hapur dhe zhvillohen në Akademinë e Forcave të Armatosura qysh prej vitit shkollor 2011 – 2012.

**A.1.4.4.** Skema e pranimeve të studentëve në programet e studimit të ciklit të dytë, mban parasysh Standardet Shtetërore të Arsimit të Lartë. Ajo ka ngjashmëri me praktikën e Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik të vendit dhe të disa akademive ushtarake homologe duke pasur parasysh veçoritë për të rekrutuar kontingjente cilësore.

**A.1.4.5.** AFA ka përvojë më shumë se 55-vjeçare në fushën e kualifikimit pasuniversitar. Ajo është qendra e vetme e Forcave të Armatosura, ku realizohet kualifikimi pasuniversitar për mbrojtjen e doktoratave dhe marrjen e gradave. Gjatë gjithë kësaj periudhe të gjatë kohore, kjo veprimtari shkencore ka qenë dhe mbetet pjesë e misionit, detyrave dhe përgjegjësisë të këtij institucioni, duke realizuar me sukses edhe ciklin e tretë të studimeve universitare. Sot, projektet studimore orientohen pothuajse në dy fushat kryesore të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, duke qenë se edhe drejtimet e tjera derivojnë nga fusha bazë e studimit.

#### Sugjerime specifike

**A.1.4.6.** AFA të respektojë angazhimet, parimet dhe përvojat e shkollave më të mira simotra në kuadër të angazhimit në NATO dhe BE, për ta kthyer në një IAL elitare për ngritjen e kapaciteteve të Forcave të Armatosura.

**A.1.4.7.** AFA është dhe duhet të jetë i vetmi institucion për ekspertizë në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes në interes të vendimmarrjes politike.

**A.1.4.8.** Konsolidimi i plotë i strukturës akademike të AFA-s me të gjitha nivelet e saj të studimit.

**A.1.4.9.** Përfshirjen në Ligjin e Arsimit të Lartë Shqiptar të institucionit të Akademisë së Forcave të Armatosura si një institucion i arsimit të lartë dhe krijimin e hapësirave ligjore për funksionimin e tij sipas këtij ligji.

**A.1.4.10.** Krijimin e hapësirave ligjore për dhënien e mundësive për bashkëpunimin e këtij institucioni me institucionet e tjera të larta arsimore në vend dhe jashtë vendit.

**A.1.4.11.** Krijimin e mundësive për njohjen dhe transferimin e krediteve të këtij institucioni, në institucione të tjera të larta arsimore në vend dhe njohjen apo njësimin e moduleve dhe të lëndëve mësimore.

**A.1.4.12.** Krijimin e hapësirave ligjore për kualifikimin dhe specializimin e vazhdueshëm të punonjësve të AFA-s dhe agjencive të tjera ushtarake, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

**A.1.4.13.** Realizimin në AFA të të tria cikleve të studimit universitar, sikurse modelet aktuale të akademive në vendet anëtare të NATO-s.

**A.1.4.14.** Krijimin e mundësive ligjore për ndjekjen pas përfundimit të programit Bachelor në arsimin ushtarak, të studimeve Master në profile të tjera si brenda institucionit, ashtu dhe jashtë institucionit. Kjo do të mundësojë orientimin e ushtarakut në tregun e punës pas lirim të tij nga forcat e armatosura ose krijimin e mundësive që, pas ciklit të parë të studimeve ushtarak, të hyjë në tregun e punës.

#### A.1.5. AKADEmia E POLICISË

**A.1.5.1.** Shkolla e Lartë e Ministrisë së Punëve të Brendshme u krijua në vitin 1971 dhe kaloi si institucion i arsimit të lartë (jouniversitar) në vitin 1972. Diploma titullohej “Oficer policie”. Në vitin 1980 emërtohet “Shkolla e Lartë e Ministrisë së Brendshme”, dhe njësohet me shkollat e larta të sistemit universitar, si në drejtim të planeve dhe programeve mësimore, ashtu edhe të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Në vitin 1992, riemërohet me emrin “Akademia e Rendit Publik”. Në vitin 2000 krijohet Akademia e Policisë, duke u ndërmarrë një

sërë ndryshimesh si në programet mësimore, ashtu dhe në organizimet strukturore. Diploma titullohej “Specialist i Lartë Policie” Në vitin 2003 u hartuan programet e para dhe filloi funksionimi i “Qendrës Pasuniversitare” me diplomën “Master në Fushën e Sigurisë”..

**A.1.5.2.** Në vitin 2005, Akademia e Policisë “akreditohet me kusht” nga Qendra e Akreditimit, por jetëgjatësia e këtij akreditimi ishte e shkurtër për shkak të ndërthurjes së një sistemi arsimor policor të afruar nga misioni policor ICITAP (konsulentë për strukturat e policisë - SHBA). Pas një procesi organizimi, insitucioni emërohet “Qendra e Formimit Policor”, në vitin 2009.

**A.1.5.3.** Qendra e Formimit Policor, aktualisht, përgatit punonjës të nivelit zbatues, kryesisht punonjës policie, patrulle etj., nëpërmjet zhvillimit të programit mësimor të balancuar mes kohëzgjatjes teorike dhe asaj praktike. 89 | P a g e

**A.1.5.4.** Qendra e Formimit Policor funksionon si një institucion arsimor që formon dhe përgatit oficerët e policisë për nivele dhe grada të ndryshme në zbatim të kërkesave të ligjit për policinë e shtetit.

**A.1.5.5.** Qendra e Formimit Policor është e përbërë nga 7 sektorë, të ndarë në 15 seksione, të cilat mbulojnë planifikimin e trajnimeve, si dhe hartimin e programeve mësimore për realizimin e shkollimit në nivelin bazë policor, si dhe shkollimin e trajnimit në nivele të mesme dhe të larta policore.

### **Sugjerime specifike**

**A.1.5.6.** Akademia e Policisë duhet të respektojë angazhimet, parimet dhe përvojat e shkollave më të mira simotra në kuadër të angazhimit në NATO dhe BE, për t’u kthyer në një IAL elitare në ngritjen e kapaciteteve të formimit policor.

**A.1.5.7.** Sistemit të arsimit policor, në kushte gjithnjë e në rritje të kërkesave që ka komuniteti për një polici profesionale dhe korrekte në shërbim të tyre, duhet t’i krijohen kushte ligjore për dhënien e një statusi institucional më të lartë.

**A.1.5.8.** Përfshirjen në ligjin e arsimit të lartë shqiptar të institucionit arsimor për Policinë e Shtetit dhe krijimin e hapësirave ligjore për funksionimin e tij sipas këtij ligji.

**A.1.5.9.** Krijimin e hapësirave ligjore për dhënien e mundësive për bashkëpunim si me institucionet e tjera të larta arsimore në vend dhe me ato jashtë vendit.

**A.1.5.10.** Krijimin e mundësive për njohjen dhe transferimin e krediteve në institucione të tjera të larta arsimore dhe njohjen apo njësimin e moduleve apo lëndëve mësimore.

**A.1.5.11.** Krijimin e hapësirave ligjore për kualifikimin dhe specializimin e vazhdueshëm të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të agjencive të tjera të sigurisë publike, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

**A.1.5.12.** Koha, kushtet, problematikat profesionale, kualifikimi dhe ecuria në karrierë e punonjësit të policisë, kërkon bashkë me zhvillimin arsimor edhe ringritjen e një institucioni me parametra të një institucioni të arsimit të lartë, i cili mund të emërtohet: “Akademia e Sigurisë Publike”.

### **A.1.6. FAKULTETI I MJEKËSISË VETERINARE (BRENDA UBT-SË)**

**A.1.6.1.** Analiza e kostos së përgatitjes së studentit në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, në UBT, tregon se kostoja është shumë e lartë. Analiza financiare tregon gjithashtu se edhe kostoja e mbajtjes dhe funksionimit të klinikave veterinare, laboratorëve diagnostikë dhe sigurisë ushqimore, riciklimi i mbetjeve laboratorike, dezinfektimi dhe sterilizimi i mjediseve kërkojnë një nivel të lartë të shpenzimeve.

**A.1.6.2.** Kostoja për realizimin e përbërësit të kërkimit shkencor e rendit Fakultetin e Mjekësisë Veterinare si ndër më të vështirët për realizimin e nevojave financiare. Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, duke u futur në grupin e degëve me nevoja të veçanta, mund të funksionojë si një institucion që garanton dhe cilësinë në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor.

**A.1.6.3.** Fakulteti i Mjekësisë Veterinare funksionon brenda UBT-së në Tiranë. Misioni dhe vizioni i tij nuk konsiderohet vetëm shëndeti i kafshëve, por është një fakultet me natyrë të qartë mjekësore në shërbim të shëndetit publik.

**A.1.6.4.** Struktura e organizimit të procesit mësimor realizohet sipas standardeve të EAEVE (EC – Directive 2005/36 dhe EC Regulation 2004/854 ), Organizata e Fakulteteve të Mjekësisë Veterinare të Evropës dhe e vetmja që bën akreditimin ndërkombëtar evropian të këtyre fakulteteve.

**A.1.6.5.** Fakulteti i Mjekësisë Veterinare synon të shndërrohet në një qendër bashkëkohore të edukimit universitar, pasuniversitar, kërkimit

shkencor dhe trajnimit për përgatitjen e specialistëve të fushës së veterinarisë, klinikës dhe shëndetit publik veterinar. Fakulteti i Mjekësisë Veterinare synon të kthehet në një pikë referimi për zhvillimin e mjekësisë veterinarë, mbarështimin e kafshëve, mirëqenien dhe prodhimtarinë e tyre, duke kontribuar drejtpërdrejt në integrimin evropian të vendit.

### **Sugjerime specifike**

**A.1.6.6.** Fakulteti Mjekësisë Veterinare duhet të ketë kuota pranimit të përcaktuara nga vetë fakulteti.

**A.1.6.7.** Pranimi i studentëve në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare të realizohet nëpërmjet ndërthurjes së rezultateve të maturës shtetërore me konkurrimin në fakultet.

**A.1.6.8.** Krijimi i strukturave të plota për trajnimin e studentëve në klinikat bazë veterinarë të financohet me një fond shtesë për inovacionin ose kërkimin shkencor, nga granti i zhvillimit.

**A.1.6.9.** Ndërtimi i infrastrukturës spitalore për kafshët e shoqërimin dhe atyre të fermës. Të realizohet me financim nga ministria përkatëse.

**A.1.6.10.** Duke qenë degë me natyrë të veçantë, vetë departamentet të përcaktojnë numrin e studentëve në grupet mësimore, bazuar në kriteret e edukimit veterinar.

**A.1.6.11.** Sugjerimi për një numër të vogël të studentëve për grup të bazohet në parimin që çdo student duhet të marrë pjesë në mënyrë të pavarur në praktikat laboratorike dhe klinike, bazuar në parimin e edukimit veterinar “Day-one-Skills”.

**A.1.6.12.** Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, si degë me nevoja të veçanta, sugjeron instalimin e një autonomie financiare për përballimin e kërkesave që garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe realizimin e standardeve të kërkimit shkencor.

### **Universiteti Bujqësor i Tiranës**

**A.1.6.13.** Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) është qendra e vetme e formimit universitar, pasuniversitar, kërkimit shkencor dhe trajnimit në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit. Ky IAL u krijua më 1 nëntor 1951, si Instituti i Lartë Bujqësor (ILB) dhe mori statusin e një universiteti në vitin 1991, kur dhe u emërtua Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT). Deri në vitin 1990, universiteti ishte i organizuar në katër fakultete (Agronomi, Ekonomi Agrare,

Inxhinieri Pyjore dhe Veterinari) me rreth 6000 studentë e 480 pedagogë. Në vitin 1992-1994, u krye ristrukturimi akademik i universitetit. Që nga viti akademik 2005-2006, UBT i ka organizuar studimet sipas skemës së re 3+2+3 (Bachelor, Master dhe Doktoraturë).

**A.1.6.14.** UBT zbaton dhe duhet të zbatojë të gjitha rregullat organizative dhe administrative si edhe IAL-të e tjera në vend. Por për arsye të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare, si degë me natyrë të veçantë, për arsye të financimit të dyfishtë, si dhe për arsye të rëndësisë së lartë që kanë disa nga profilet e këtij universiteti për zhvillimin e vendit, ky universitet po trajtohet në mënyrë të veçantë, por jo me status të veçantë.

**A.1.6.15.** Në UBT, kërkimi shkencor konsiderohet si një të përbërës thelbësor i jetës akademike. Kërkimi është realizuar në sajë të një numri të madh projektsh kombëtare dhe ndërkombëtare. UBT është nismëtar i lidhjeve të shkencës me prodhimin. Këto lidhje janë konkretizuar përmes marrëveshjeve të lidhura me biznesin shqiptar.

**A.1.6.16.** UBT-ja, ka në përbërjen e tij pesë fakultete: Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe i Ushqimit, Fakulteti i Shkencave Pyjore, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare.

**A.1.6.17.** UBT-ja është qendra më e madhe e edukimit universitar, pasuniversitar, kërkimit dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të specialistëve të fushës së bujqësisë, ushqimit dhe të mjedisit.

### **Sugjerime**

**A.1.6.18.** Universiteti Bujqësor i Tiranës me degët parësore duhet të jetë promotori i mbështetjes dhe i zhvillimit të politikave kombëtare dhe rajonale, duke ndikuar sidomos në fushat e bujqësisë, blegtorisë dhe fondit gjenetik të farërave.

**A.1.6.19.** UBT-ja duhet të promovojë prirjet e reja të zhvillimit në fushat me rëndësi strategjike parësore për përparimin e vendit.

**A.1.6.20.** UBT-ja duhet të shërbejë si një hallkë lidhëse midis politikave të zhvillimit, ekspertizave të kërkimeve shkencore dhe përgatitjes së kuadrove në shërbim të fushave, që mbulon për të ndikuar në rritjen ekonomike të vendit, si dhe në drejtim të agrobiznesit, agroturizmit, agroindustrisë etj.

**A.1.6.21.** UBT-ja duhet të ndikojë përmes

veprimtarisë së saj në zhvillimin e qendrueshëm në zonat bujqësore e blegtorale, pyjore dhe ato malore.

**A.1.6.22.** Ky institucion duhet të bashkëpunojë intensivisht edhe me IAL të specializuara për zhvillimin e zonave urbane, për një baraspeshë më të mirë në zhvillimin territorial në tërësi, veçanërisht në raportet ruralo-urbane për një shfrytëzim më të mirë të burimeve ekonomike të vendit. 92 | P a g e

**A.1.6.23.** UBT-ja duhet të shërbejë si model i një institucioni të rëndësishëm në fushën e promovimit të teknologjive të reja dhe të studimeve bashkëkohore, si në nivel kombëtar dhe në atë rajonal.

**A.1.6.24.** Të nxitet ngritja dhe riorganizimi i strukturave funksionale që realizojnë bashkëveprimin e të dhënave teorike me zbatimin praktik të tyre.

**A.1.6.25.** Organizimi strukturor i kësaj IAL-je është dhe duhet të jetë i njëjtë me atë të IAL-ve të tjera publike.

**A.1.6.26.** Financimi i këtij institucioni të arsimit të

lartë mbetet i njëjtë si për të gjitha IAL-të e tjera publike. Duhet të theksohet se për degët parësore të zhvillimit, ku nuk ka konkurrencë në treg, shteti duhet të ketë financim të veçantë.

## **Të tjera**

**A.1.6.27.** Kopshti Botanik i Tiranës duhet të shndërrohet në Qendër Kombëtare për studimin dhe ruajtjen e biodiversitetit në Shqipëri, në varësinë e Rektoratit të UT-së, FSHN-së. Ai duhet të shihet e të financohet nga shteti si institucion kombëtar i rëndësisë së veçantë. Në të duhet të përfshihet edhe Herbariti Kombëtar, që aktualisht është pranë Qendrës së Kërkimit të Florës dhe Faunës.

**A.1.6.28.** Muzeu i Shkencave të Natyrës është njësi e rëndësishme shkencore, e specializuar në fushën e biodiversitetit dhe ruajtjes së pasurisë faunistike, për vlerësimin e larmisë, inventarizimin dhe monitorimin e faunës shqiptare. Për misionin që ka, ai duhet shpallur institucion i rëndësisë të veçantë, të kalojë në varësinë e drejtëpërdrejtë të Rektoratit të UT-së, FSHN-së, dhe të financohet drejtëpërdrejt nga shteti.

Autonomia e konceptuar sipas Organizatës Universitare Evropiane (EUA)	Autonomia e pasqyruar në Raportin e Reformës për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor
<b>Autonomia Organizative</b>	
1	Zgjedhja e drejtuesve të IAL-ve Autonomi e plotë. Kjo autonomi ka të bëjë me lirinë që kanë IAL-të e ndryshme në zgjedhjet e drejtuesve të tyre. Kjo autonomi pasqyrohet në raport, në pikat 5.4.1; 5.4.4; 5.4.5; 5.4.16; 5.4.18.
2	Struktura e brendshme akademike Autonomi e pjesshme. Kjo autonomi ka të bëjë me lirinë që kanë IAL-të në vendimmarrjen e tyre për natyrën dhe mënyrën e funksionimit të strukturave të brendshme të IAL-ve. Një pjesë e kësaj strukture vendoset në ligj, dhe një pjesë nga vetë IAL-të, si p.sh. krijimi i komisioneve, departamentëve dhe qendrave e të tjerë. Në raport shprehet në pikat 5.4.5; 5.4.6; 5.4.10; 5.4.13; 5.4.22; 5.4.43.
3	Krijimi i entiteteve ligjore Autonomi e plotë. Kjo autonomi ka të bëjë me mundësinë që kanë IAL-të të krijojnë entitete ligjore për të mbështetur aktivitetin e tyre. Kjo e drejtë u jepet IAL-ve nga ky raport, në lidhje me aktivitetet që përcakton misioni i tyre. Në raport, kjo autonomi shprehet në pikat 5.2; 5.4.25; 6.3.1.2; 11.4; 11.7.
4	Strukturat drejtuese Autonomi e plotë. Ky raport sugjeron dualizimin e strukturave drejtuese të IAL-ve, Senatit dhe Bordit Administrativ, me role të qarta për secilën strukturë dhe me të drejtë zgjedhjeje të këtyre strukturave nga vetë personeli i IAL-ve. Në raport, kjo shprehet në pikat 5.4.18; 5.4.19; 5.4.20; 5.4.21; 5.4.13; 5.4.14; 5.4.15.
<b>Autonomia Financiare</b>	
1	Përdorimi i fondeve publike Autonomi e plotë. Këtu autonomia ka të bëjë me mundësinë e IAL-ve për t'i përdorur paratë publike siç e shohin ato të nevojshme. Ky raport sugjeron që fondet publike të jepen në formë granti të përlogaritur, dhe vetë IAL-të kanë të drejtë ta përdorin atë siç e shohin të nevojshme. Në raport, kjo autonomi pasqyrohet në pikat 6.2.4; 6.3.1.1; 6.3.1.2; 6.3.1.4; 6.4.2.4; 6.5.5.
2	Marrja e kredive bankare Autonomi e pjesshme. Kjo e drejtë rekomandohet nga raporti për fazën e dytë të zhvillimit të arsimit të lartë, atëherë kur IAL-të të kenë një status më të pavarur sesa e kanë tani. Edhe në atë fazë, marrja e kredive duhet të jetë e miratuar dhe e kushtëzuar nga disa parametra të gjendjes financiare. Në raport, kjo pasqyrohet në pikën 6.5.6.
3	Pronësia mbi asetet Autonomi e plotë. Kjo e drejtë ekziston edhe në ligjin aktual, por rekomandohet kryesisht për në fazën e dytë kur IAL-të të ndërrojnë statusin e tyre.

4	Kontributi financiar i studentëve	Autonomi e pjesshme. Kjo autonomi ka të bëjë me sa janë në gjendje IAL-të të vendosin tarifatat e tyre për studentët dhe për çmimin që mendojnë. Raporti sugjeron një autonomi të pjesshme se është shteti që vendos çmimet tavan, veçanërisht për studimet e ciklit të parë. Në raport pasqyrohet në pikat 6.3.1.5; 6.4.2.4; 6.4.2.5.
---	-----------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

#### Autonomia e personelit

1	Rekrutimi i personelit	Autonomi e plotë. Kjo autonomi ka të bëjë me mundësinë që kanë IAL-të të rekrutojnë personelin e tyre sipas nevojave. Në raport sugjerohet që kjo është e drejtë ekskluzive e vetë IAL-ve. Në raport kjo pasqyrohet në pikat 5.4.28; 5.4.29.
2	Rrogat e personelit	Autonomi e plotë. Në raport sugjerohet që kjo e drejtë t'u jepet IAL-ve dhe të mos ketë kufizime nga qeveria qendrore. Kjo do të rrisë edhe konkurrencën dhe përgjegjshmërinë e personeleve akademike. Në raport shprehet në pikën 6.4.2.4.
3	Pezullimi nga puna i personelit	Autonomi e plotë. Kjo është një e drejtë që e kanë edhe sot IAL-të.
4	Promovimi i personelit dhe dhënia e titujve	Autonomi e plotë. Kjo është një e drejtë që ky raport ia njeh IAL-ve për herë të parë. Në raport shprehet në pikat 5.4.36; 5.4.37; 5.4.41; 5.4.42.

#### Autonomia Akademike

1	Përcaktimi i numrit të studentëve	Autonomi e pjesshme. Modeli që rekomandohet në kushtet e Shqipërisë është ai i tipit të "kooperativës" ku negociohet midis shtetit dhe IAL-ve. Sidoqoftë, IAL-të mund të vendosim numrin e tyre të pranimeve për degët që nuk presin financim nga shteti. Autonomia është e plotë për studimet e ciklit të dytë. Në raport kjo shprehet në pikat 5.4.7; 6.2.5.2.1;
2	Mekanizmat e pranimit	Autonomi e plotë. Kjo autonomi ka të bëjë me të drejtën që kanë IAL-të për rekrutimin e studentëve. Ndërsa ky raport sugjeron krijimin e një agjencie për organizimin e aplikimit, e drejta dhe kriteret specifike të pranimit mbeten në çdo IAL, më saktë në çdo departament. Në raport shprehet në pikat 4.3.28; 5.4.7; 5.4.9.
3	Mekanizmat e sigurimit të cilësisë	Autonomi e kufizuar. Kjo autonomi ka të bëjë me sa është në gjendje një IAL të zgjedhë mekanizmat e vlerësimit të cilësisë, si dhe agjencitë e akreditimit. Raporti sugjeron ngritjen e mekanizmave të brendshëm për kontrollin e cilësisë, por ia lë peshën kryesore Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe Bordit të Akreditimit. Në raport, kjo shprehet në pikat 4.3.16.... deri në ... 4.3.24.
4	Hartimi i programeve	Autonomi e pjesshme. Kjo autonomi ka të bëjë me të drejtën që kanë IAL-të të hartojnë dhe të zhvillojnë programet e tyre. Raporti ua jep këtë të drejtë IAL-ve, më saktë departamenteve, por ka një mekanizëm kontrolli nga MAS-i për programet që financohen nga shteti si parësore. Në raport, kjo pasqyrohet në pikat 5.4.7 dhe 7.5.4.

# ANEKSI III

## MATRICA E VËREJTJEVE DHE E SUGJERIMEVE TË PASQYRUARA NË RAPORT

Vërejtje dhe sugjerime nga diskutimi me grupet e interesit	Vërejtjet dhe sugjerimet e pasqyruara në raport
Autonomia Universitare	
1. Rekomandimet e bëra nga kjo reformë çënojnë autonominë universitare.	Ky raport argumenton të kundërtën që kjo reformë e rrit autonominë universitare në të katër aspektet e kësaj autonomie, organizative, financiare, të personelit dhe akademike. Për ta pasqyruar këtë çështje më qartë, një matricë e veçantë dhe e detajuar e autonomisë është paraqitur në Aneksin II.
Aspekte të Financimit të IAL-ve	
1. Reforma synon të financojë si universitetet publike dhe ato jopublike.	Kjo vërejtje nuk është e saktë. Së pari, reforma synon të rrisë financimin e universiteteve publike, qoftë nëpërmjet rritjes së investimit shtetëror, qoftë edhe nëpërmjet autonomisë financiare dhënë IAL-ve publike për të zgjeruar llojshmërinë e burimeve të financimit. Kjo pasqyrohet qartë në kreun 6, pika 6.2; 6.24 dhe 6.2; 6.41
2. Autonomia financiare dhe rritja e vetëfinancimit do ta vërë arsimin e lartë nën trysni.	Si nga ana teorike, edhe nga ajo praktike, kjo reformë synon të kundërtën. Autonomia financiare nga njëra anë rrit përgjegjësitë e IAL-ve, por nga ana tjetër i forcon bazat e tyre financiare. Së dyti, reforma kërkon rritjen e investimit shtetëror, por edhe zgjerimin e llojshmërisë së burimeve financiare. Kjo, në një periudhë të shkurtër, i bën më të shëndetshme financiarisht IAL-të. Kjo pasqyrohet si në matricën e autonomisë, ashtu edhe në kreun 6, seksioni 6.3; 6.1.1; 6.1.2.
3. Reforma ka një kosto të lartë dhe e gjithë barra e financimit do të bjerë mbi studentët	Kjo vërejtje është pjesërisht e vërtetë dhe jemi përpjekur ta pasqyrojmë. Reforma do të ketë një kosto të lartë për shtetin në fazën e parë, sepse i kërkohet shtetit të rrisë investimin e tij në nivelet bashkëkohore. Në të njëjtën kohë i jep pavarësi IAL-ve të zgjerojnë burimet e financimit, midis të tjerave edhe liberalizimin e tarifave të studimit (në mënyrë të kontrollueshme). Por, po kështu, reforma sugjeron dhënien e disa lloje bursash për studentët në nevojë, degët parësore dhe studentët e ekselencës. Për ata studentë që nuk përfitojnë bursa, parashikohet dhënia e kredive studentore me kushte lehtësuese. Kjo shprehet në raport në pikat 6.2; 6.2.5.2.2; 6.3; 6.4.4
4. Kërkesa për ndryshimin e tarifave nuk pasqyron realitetin Shqiptar.	Kjo është e vërtetë për familjet që jetojnë nën nivelin mesatar të të ardhurave, dhe ne sugjerojmë që, në më të shumtën e rasteve, këto familje të përfitojnë nga bursat për studentët në nevojë. Të gjitha studimet, si analizat tona dhe studimet kombëtare dhe ndërkombëtare, tregojnë krijimin e një klase të mesme që mund të përballojë pjesërisht një pjesë të shkollimit të tyre. Rritja e numrit të studentëve në sistemin jopublik ku tarifat janë shumë herë më të larta, e tregon vetë këtë fakt.

- |    |                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 5. | Qeveria duhet të rrisë financimin e saj për arsimin e lartë.                              | Kjo është e vërtetë dhe në raport pasqyrohet qartë që financimi në Shqipëri është shumë i ulët dhe reforma nuk mund të ketë sukses, në qoftë se vetë shteti, si financues kryesor, nuk rrit investimin e tij. Shiko 6.1.1; 6.4.1; paragrafi i parë i Kreut 6.                                                                                                                                                                                                                                      |
| 6. | Pse duhet t'u krijohej mundësia IAL-ve jopublike për fonde publike për kërkimin shkencor? | Dy janë arsyet që komisioni mendon se për punën kërkimore shkencore (jo anën logjistike të kërkimit shkencor, por projektet e kërkimit shkencor), fondet publike duhet të jenë të hapura për të gjithë akademikët pavarësisht se ku punojnë. E para, nga puna kërkimore shkencore e këtyre akademikëve përfiton i gjithë vendi dhe jo një pjesë. E dyta, fondet për kërkim shkencor jepen për ekselencë në projekte dhe jo se "të takojnë" me ligj. Kjo ekselencë mund të jetë në çdo IAL në vend. |

---

Aspekte të Drejtimit të IAL-ve – Raportet akademike / menaxheriale

---

- |    |                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. | Autonomia e IAL-ve publike çënohet nga pushteti "absolut" që i jepet Bordit të Administrimit. Kush do ta kontrollojë BA-në, ku do japë ai llogari për vendimet e marra që drejtojnë jetën financiare? Kush e shkarkon atë? | Ky është një shqetësim i drejtë, por i pasqyruar në raport. Në këtë raport përfundimtar, komisioni i ka sqaruar me hollësi këto çështje. Bordi nuk ka pushtet absolut, sepse, së pari, e zgjedh Senati; së dyti, publikon raportet vjetore të punës dhe të financave të IAL-së; së treti, është organ mbikqyrës; së katërti, shkarkimin e bën përsëri Senati. Shiko Kreun 5, pika 5.4.12; 5.4.13; 5.4.14.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| 2. | Të përcaktohet qartësisht raporti i lejuar i anëtarëve të Bordit Administrativ nga jashtë dhe brenda IAL-ve.                                                                                                               | Kjo është një vërejtje e drejtë që komisioni e ka pasqyruar dhe e ka qartësuar në formulën e krijimit të Bordit Administrativ. Shiko Kreun 5, pika 5.4.12.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 3. | Si do të rregullohet marrëdhënia midis Senatit/Rektorit dhe Bordit/Administratorit.                                                                                                                                        | Kjo është një vërejtje e rëndësishme dhe që në raport pasqyrohet dhe përcaktohet qartë. Rolet e tyre janë të ndryshme dhe varësia midis tyre është qartësuar. Kështu, në raportin senat/bord, i pari zgjedh të dytin, por i dyti miraton zhvillimin afatgjatë të IAL-së, të hartuar nga ky i fundit. Rektori është figura institucionale e një IAL-je dhe administratori është atje për të ndihmuar rektorin në anën menaxheriale dhe financiare të IAL-së. Shiko Kreun 5, pikat: 5.4.12; 5.4.13; 5.4.14; 5.4.15; 5.4.16; 5.4.17.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| 4. | Menaxherët mbivlerësohen në nivel departamenti. Ata nuk duhet të kenë personel administrativ nën vete. Menaxherët rrisin në mënyrë artificiale kostot.                                                                     | Ky është një shqetësim deri diku i përligjur se menaxheri/administratori nuk ka ekzistuar si koncept dhe si pozicion në IAL-të në Shqipëri. Komisioni, duke pasur parasysh që departamenti merr më shumë funksione nga kjo reformë, që nga ato financiare, menaxheriale, mësimdhënieje dhe të punës kërkimore, mendon që shefi i departamentit ka nevojë për një ndihmë administrative të domosdoshme. Pra, menaxherët/administratorët janë pozicione që ndihmojnë shefin e departamentit në mbarvajtjen e këtij të fundit, dhe nuk marrin asnjëherë vendime rreth anës financiare, menaxheriale apo akademike të departamentit. Ata lehtësojnë këto vendime. Emërimi i tyre u lihet në dorë vetë IAL-ve sipas madhësisë së departamenteve. Emërimi i tyre nuk rrit kostot, por ul kostot e departamentit si rezultat i mirëmenaxhimit me efikasitet të departamenteve. Shiko Kreun 5, seksionin e departamentit, pikat 5.45. deri në 5.4.11. |



5. Vizioni akademik duhet të mbizotërojë mbi atë menaxherial dhe kjo duhet të dalë qartë. Ky sugjerim është shumë i drejtë dhe trajtohet shumë qartë në raport, në Kreun 5, pikat: 5.4.12; 5.4.13; 5.4.16; 5.4.17.

#### Aspekte të Licensimit, Akreditimit dhe Renditjes së IAL-ve

- |    |                                                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. | Procesi i reformave nuk mund të fillojë pa përfundimin e akreditimit profesional të IAL-ve, bazuar në standardet ndërkombëtare. | Kjo është një vërejtje e drejtë që komisioni ia ka kaluar MAS-it. Nuk është në dorë të komisionit të kryejë këtë vlerësim apo edhe të sugjerojë mënyrat e kryerjes së tij. Sidoqoftë, komisioni ka kërkuar kryerjen e plotë të akreditimit/licensimit brenda vitit të parë akademik të reformës, 2014-2015.              |
| 2. | Procesi i renditjes së IAL-ve dhe departamenteve duhet të jetë një proces transparent dhe të bëhet sa më shpejt.                | Komisioni e sugjeron këtë proces si për procesin e mësimdhënies, ashtu edhe për atë të kërkimit shkencor. Komisioni sugjeron që ky proces të kryhet brenda tri viteve të para dhe rezultatet e tij të shërbejnë si tregues për financimin e IAL-ve publike. Shiko Kreun 4: pikat 4.3.12; 4.3.20; 4.3.21; 4.3.23; 4.3.24. |

#### Përfaqësimi Studentor

- |    |                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. | Zgjedhjet për organet drejtuese duhet të organizohen me votim të drejtpërdrejtë dhe në to duhet të marrin pjesë edhe personeli joakademik dhe studentët. | Komisioni është i mendimit që në zgjedhjet për drejtuesit akademikë të IAL-ve duhet të marrë pjesë vetëm personeli akademik që ka njohuri të drejtpërdrejtë mbi individët dhe njohuri të drejtpërdrejtë të procesit akademik. Kjo i bën zgjedhjet më përfaqësuese dhe eliminon disa probleme abuzive të hasura në organizimin e disa zgjedhjeve. Shiko Kreun 5: 5.3.2; 5.4.4;                                                                                                                                                                     |
| 2. | Të rritet përfaqësimi studentor dhe zëri i studentëve në mbarëvajtjen e përditshme të IAL-ve.                                                            | Kjo është një vërejtje me vend që komisioni i ka kushtuar një seksion të plotë në Kreun 5. Raporti sugjeron jo vetëm rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në mbarëvajtjen e IAL-ve, por edhe marrjen pjesë të tyre në komisione ekzekutive që merren drejtpërdrejt me problemet e studentëve. Një risi e këtij raporti është që komisioni e cilëson si detyrë të drejtpërdrejtë të IAL-ve mbështetjen financiare dhe logjistike të organizimit studentor. Shiko Kreun 5, seksioni "Organizimi Studentor": 5.4.31; 5.4.32; 5.4.33; 5.4.34; 5.4.35. |

#### Aspektet e Punësimit dhe Promovimit

- |    |                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. | Të mos ndalohet dypunësimi dhe të lejohet mobiliteti i pedagogëve brenda sistemit, se bie ndesh me procesin e Bolonjës. | Ndërsa komisioni e shikon si të drejtën e çdo pedagogu lëvizjen nga një IAL në tjetrin, ai, gjithashtu, vë në dukje se shumëpunësimi ka qenë një problem i madh që ka ndikuar në cilësinë si të mësimdhënies ashtu dhe të kërkimit shkencor. Komisioni, gjithashtu, e kupton faktin që ky shumëpunësim ka krijuar mundësi financiare më të mira për pedagogët. Për këtë, komisioni është i mendimit që shumëpunësimi të kontrollohet me ligj dhe të jetë në jo më shumë se një institucion tjetër, dhe në marreveshje me institucionin përkatës. Komisioni sugjeron edhe një numër mënyrash për të rritur të ardhurat e pedagogëve në IAL-të në vend. Këto pasqyrohen në Kreun 5: 5.3.5; 5.4.24; 5.4.25; 5.4.26; 5.4.27; 5.4.30. Kreu 7: 7.8. |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

- |    |                                                                                                                                                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 2. | Për rekrutimin e personelit akademik, departamenti duhet të ketë shumicën e komisioneve “ad-hoc”.                                                                                                                            | Ky sugjerim është i drejtë, dhe komisioni mendon që kjo e drejtë i jepet departamentit në dy drejtime: e para se në komision ka 3 nga 5 anëtarë nga departamenti, dhe pjesë e vlerësimit të kandidatëve është edhe vlerësimi me shkrim i departamentit për kandidatët pas paraqitjeve. Ky është përcaktues kur komisioni ka kundërshti në zgjedhje. Formula e zbatuar për krijimin e këtyre komisioneve është marrë nga përvojat më të mira ndërkombëtare për të ruajtur standardet dhe përjasjen e të gjitha enteve të IAL-së. Këto shprehen në Kreun 5: 5.4.6; 5.4.28; 5.4.29. |
| 3. | Reforma duhet të adresojë rregulla të qarta të procedurave për përzgjedhjen e personelit akademik.                                                                                                                           | Ky është një propozim me vend që mungonte në raportin e parë dhe është pasqyruar në këtë raport në Kreun 5, pika 5.28.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| 4. | Promovimi i personelit akademik duhet të jetë më rigoroz, transparent dhe në varësi të vetë IAL-ve, dhe jo si deri më sot nga një organizëm ministror, që nuk ka lidhje me profilin dhe përvojën e individëve që promovohen. | Ky është një sugjerim me vend që ne jo vetëm e theksojmë, por edhe e kemi përpunuar më shumë në këtë raport, duke i kushtuar një seksion më vete në Kreun 5: “Titujt dhe gradat shkencore”. Për më shumë, shiko pikat: 5.4.36; 5.4.38; 5.4.39; 5.4.40; 5.4.41; 4.4.42                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |

---

#### Aspekte të Mësimdhënies dhe të Punës Shkencore

---

- |    |                                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. | Të rishihet pozicioni i reformës ndaj sistemit part-time.                                                    | Komisioni e sheh si të drejtë të domosdoshme studimin part-time për ata që punojnë dhe që kanë detyrime të përdishme që nuk ua mundësojnë studimet me kohë të plotë (full-time). Për këtë arsye, në këtë raport është lejuar sistemi part-time, por me kushte të qarta se çfarë përfaqëson ai, në mënyrë që të eliminohen abuzimet me të. E para, ky sistem studimi duhet të ketë të njëjtën përmbajtje lëndore si edhe sistemi full-time. Ai nënkupton shtrirjen e kushtëzuar në kohë, dhe numri i studentëve të pranuar duhet të jetë i kushtëzuar. Pranimi duhet të bëhet mbi bazën e evidencës së punësimit ose arsyeve objektive për këtë lloj studimi. Ai lejohet vetëm për disa lloje programesh. Kjo pasqyrohet në Kreun 7, pika 7.5.9. |
| 2. | Mësuesia duhet të trajtohet si degë me përparësi kombëtar.                                                   | Degët me përparësi kombëtar i përcaktojnë qeveritë e ndryshme, por, sidoqoftë, komisioni i jep rëndësi të veçantë mësuesisë duke i kushtuar një seksion të plotë. Shiko Kreun 7, seksionin 7.9.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| 3. | Të sanksionohet përfshirja e standardeve të kërkimit shkencor.                                               | Kjo ka qenë një risi e kësaj reforme, që i përfshin këto standarde që nga vlerësimi dhe promovimi individual i personelit akademik, te vlerësimi i departamenteve dhe IAL-ve e deri tek financimi i tyre. Vetë krijimi i AKKSH-së është një risi. Shiko Kreun 4, pika 4.3.12; Kreun 5, pikat 5.4.5; 5.4.6; 5.4.34; Kreun 6 pika 6.2.6 dhe gjithë Kreun 8.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| 4. | Të përcaktohet qartë sa herë në sa vjet bëhet vlerësimi i performancës së mësimdhënies dhe si realizohet ai. | Kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe ky raport sjell disa risi. E para, ky vlerësim si brenda IAL-së edhe nga agjencia përkatëse (ASCAL) bëhet i përvitshëm. Mekanizmat e këtij vlerësimi janë të qarta. Shiko Kreun 4; 7.3.17; 4.3.19; 4.3.20; 4.3.22; 4.3.23; 4.3.24.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| 5. | Duhet përcaktuar qartë se si ndahet puna e mësimdhënies nga ajo kërkimore shkencore                          | Komisioni është i mendimit që kjo është detyrë/kompetencë e çdo IAL-je/departamenti. Kjo nuk mund të futet në ligj, por komisioni do të përfshijë rastet e përvojës më të mirë në materialin e zbatimit të reformës që do të përgatitet më vonë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |

6. Njësimi në masën deri 70% i programeve të së njëjtës emërtesë jo vetëm do të cënonte lirinë akademike, por do të rrezikonte edhe larminë e kurrikulave.	Komisioni ka një mendim ndryshe nga ky i shprehur. E para, kjo bëhet për të njëjshuar në rang kombëtar cilësinë dhe standardizimin. E dyta, njësimi i kurrikulave në masën 70% nuk nënkupton mënyra të njëjta mësimdhënieje dhe domosdoshmërisht tekste/referenca të njëjta. E treta, larmia mund të shprehet në masën 30% të mbetur.
------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

---

Statusi i Universitetit të Ri Publik

---

1. Pse duhet të kthehen universitetet shtetërore në institucione të tipit fondacion?	Ka disa arsye pse kjo formë sugjerohet dhe është e rëndësishme. E para, dhënia e autonomisë së plotë universiteteve publike, përfshi edhe atë financiare, synon që këto institucione të menaxhohen si “fondacione”, pra të kenë pavarësi të plotë në fondet e tyre dhe në mënyrën se si administrohen. Kjo formë organizimi është provuar se është më efektive në disa eksperiencia ndërkombëtare, si në Angli, Portugali e të tjera. Por edhe përvojat më të mira në vend e mbështesin këtë. Kjo formë krijon një treg të njëjshuar dhe aplikimi i konkurrencës është më efektiv.
2. Pse duhet të kthehen universitetet jopublike në publike, jofitimprurëse?	Jo domosdoshmërisht universitetet jopublike duhet të kthehen në jofitimprurëse. Por, që të kemi një sistem efektiv dhe të njëjshuar, ku të zbatohet konkurrenca e lirë midis këtyre institucioneve, është e rekomandueshme që edhe këtyre institucioneve t’u krijohet mundësia për tu shndërruar në status të njëjtë.

## ANEKSI IV - MATRICA E REFLEKTIMI NË RAPORT TË SUGJERIMEVE TË EKSPERTIZËS SË BE-SË PËR LIGJIN 9741 TË 2007.

Rekomandimet për ndryshimet ligjore		Rekomandimet e pasqyruara në reformë
Problemet Konceptuale		
1	Ligji ishte konceptuar sipas modelit të kontrollit shtetëror ndaj institucioneve të arsimit të lartë.	Raporti sugjeron të kundërtën e ligjit të kaluar. Një autonomi të theksuar të IAL-ve në të katër fushat e autonomisë, ku roli i shtetit është si financues kryesor dhe garantues i arsimit të lartë si shërbim publik. Kjo çështje trajtohet gjërësisht në Kreun 2 (parimet); në Kreun 4 dhe në Kreun 5.
2	Ligji mbivlerëson rolin e qeverisë dhe nuk respekton parimin e delegimit të kompetencave drejt IAL-ve.	Një pjesë të madhe të kompetencave që në ligjin e kaluar i kishte Ministria e Arsimit, ky raport sugjeron t'ua kalojë IAL-ve, si për shembull, përcaktimin e kuotave dhe të programeve të studimit; një pjesë të organizimit të brendshëm të IAL-ve; promovimin e personelit dhe dhënien e titujve, e të tjera. Këto trajtohen me hollësi në Kreun 4; në Kreun 5; në Kreun 7 dhe 11.
3	Ligji nuk pasqyron në mënyrë të qartë parimet e autonomisë, lirisë akademike, përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë.	Në mënyrë të veçantë, një nga qëllimet e kësaj reforme ishte thellimi i autonomisë së IAL-ve. Kjo është detajuar në Matricën e Autonomisë, në Aneksin III. Gjithashtu, reforma sugjeron masa për t'i bërë IAL-të më të përgjegjshme, si për shembull, rritja e përgjegjësisë së Bordit Akademik dhe Senatit; kalimi i vendimmarrjes në Asamblenë e Personelit dhe në Departamente, që, gjithashtu, do të shtojë edhe përgjegjshmërinë. Këto gjenden të detajuara në Kreun 5.
Mosrespektimi i Parimeve Universale		
1	Parimi i autonomisë financiare nuk është pasqyruar në ligj.	Raporti sugjeron një autonomi të theksuar financiare, të pasqyruar me hollësi në Kreun 6 dhe 11. Kjo mishërohet në lejimin e burimeve të ndryshme të financimit, në lejimin e veprimtarive të tjera ekonomike për të krijuar të ardhura, si dhe në lirinë që ta përdorin grantin e qeverisë sipas nevojave të IAL-së.
2	Parimi i gjithë pjesëmarrjes në qeverisjen e IAL-ve nuk është pasqyruar.	Qeverisja e IAL-ve u kalon plotësisht IAL-ve. Midis të tjerave, kjo pasqyrohet në faktin që Bordi Administrativ votohet nga Senati, që departamenti dhe asambleja e personelit akademik merr vendime më shumë se në ligjin e kaluar. Një risi në këtë raport është krijimi i komisioneve të ndryshme, që rrit pjesëmarrjen e personelit akademik dhe të studentëve në punën e përditshme të IAL-së. Kjo pasqyrohet veçanërisht në Kreun 5.
3	Parimi i ndarjes së qeverisjes dhe menaxhimit të IAL-ve nuk është pasqyruar.	Është parashikuar ndarje mes qeverisjes nga pikëpamja akademike e IAL-së dhe menaxhimit të IAL-së nga ana financiare. Shprehet qartë në Kreun 5.
4	Parimi i transparencës nuk është i plotë	Transparenca e punës së IAL-ve dhe e vetë MAS-it është detajuar në këtë raport, në Krerët 4, 5 dhe 7. Veprimtaria e çdo IAL-je do të pasqyrohet në raportet vjetore të detyrueshme për t'u bërë publike. Renditjet dhe vlerësimet e çdo IAL-je apo departamenti do të bëhen publike, në mënyrë që studenti të ketë informacionin e duhur. Po kështu, edhe puna e agjencive kombëtare do të bëhet publike me anën e raporteve vjetore që do të botohen prej tyre.

5	Ligji nuk i parashikon standardet e projektimit profesional, të lidhjes së diplomës me tregun e punës.	Raporti sugjeron jo vetëm krijimin e një baze të dhënash për diplomat e prodhuara, por edhe krijimin e treguesve të punësimit mbi këto diploma. Gjithashtu, raporti sugjeron edhe orientimin e IAL-ve sipas nevojave të zhvillimit të vendit dhe të rajonit. Këto janë pasqyruar në Krerët 7 dhe 9.
6	Parimi i subsidiaritetit nuk është paraqitur. Pushteti që duhet të ishte i shpërndarë midis subjekteve universitare, është përqendruar në duart e Këshillit të Ministrave dhe të Ministrisë.	Edhe në këtë aspekt, reforma sugjeron shpërndarjen e pushtetit dhe jo përqëndrimin e tij. Për këtë arsye, një pjesë e madhe e përgjegjësive të MAS-it u kalohen agjencive të reja që kanë autonomi të theksuar në vendimarrje. Siç u përmend edhe më sipër (pika 2), vetë IAL-të janë përgjegjëse për një numër të madh vendimesh që më parë i kishte MAS-i. Këto janë pasqyruar në Krerët 4 dhe 5, si dhe në Aneksin III, në matricën e autonomisë.
7	Parimi i autonomisë institucionale është paraqitur gabimisht.	Kjo është detajuar në raport dhe veçanërisht në Matricën e Autonomisë.

#### Përfundime

1	Nuk ka garanci për pavarësinë e procesit të akreditimit.	Kjo reformë sugjeron që Bordi i Akreditimit të jetë jashtë MAS-it dhe në varësi të Këshillit të Ministrave. Është sugjeruar që ai të përbëhet nga akademikë të huaj dhe procedurat e akreditimit të jenë transparente. Shiko Kreun 4.
2	Ligji përmban standarde të dyfishta që e çënojnë haptazi parimin e autonomisë universitare dhe lirisë akademike.	Të gjitha këto janë eliminuar dhe pasqyrohen qartë në Krerët 5, 7 dhe 11, si edhe në Matricën e autonomisë në Aneksin III.
3	Ligji çënon parimin e kolegjalitetit, mbi të cilin duhet të funksionojnë institucionet e arsimit të lartë.	Ky parim pasqyrohet në shumë aspekte në këtë reformë. Do të veçonim këtu sidomos kalimin e shumë kompetencave të Këshillit të Profesorëve dhe Këshillit të Fakultetit drejt Asamblesë së Personelit Akademik. Gjithashtu, departamenti kthetet në institucionin bazë kolegjal të vendimarrjes në çdo IAL. Shiko Kreun 5 për këto çështje.

#### Rekomandime

1	Është domosdoshmëri hartimi i një ligji të ri në një të ardhme të afërt në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë, legjisllacionin evropian mbi arsimin e lartë dhe modelin efektiv perëndimor.	Ky raport është komisionuar për të përgatitur bazën ligjore të ligjit të ri për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Mbi të gjitha, raporti është mbështetur në përvojat më të mira ndërkombëtare dhe dokumentacionin evropian për zhvillimin e arsimit të lartë.
2	Kompetenca për të vendosur kriteret dhe kuotat e pranimit nuk duhet të lihen vetëm në duart e Ministrisë së Arsimit	Kjo është pasqyruar me hollësi në Krerët 5 dhe 7. Departamenti brenda IAL-së merr përgjegjësinë për kriteret e pranimit në programet që organizon, por edhe përcakton kuotat për këto degë. Këto janë detajuar edhe në Matricën e Autonomisë.
3	Agjencia e Akreditimit duhet të jetë e pavarur jo vetëm nga institucionet, por edhe nga Ministria.	Është sugjeruar që kjo agjenci të jetë jashtë MAS-it dhe në varësi të Këshillit të Ministrave. Në përbërje të saj duhet të jenë akademikë të huaj dhe vendës.
4	Krijimi i baraspeshës së fuqisë mes Senatit, Rektoratit dhe Këshillit të Administrimit.	Edhe parimi i balancës dhe përgjegjësive të pushteteve është trajtuar me hollësi në Kreun 5, ku përcaktohen qartë rolet dhe detyrimet e Senatit dhe të Bordit të Administrimit.

